

Redaksia e revistës "Letrari i ri", i përgjigjet nxënësit Ismail Kadare pse nuk mund t'ia botojnë poezitë që i ka nisur me postë nga Gjirokastra.

VJERSHAT TUAJA JANË SHKRUAJTUR ME NJË GJUHË QË AS NË PROZË NUK PËRDORET

Nga Andreas Dushi

Nga Deutsche Akademie für Sprache und Dichtung
LIBRI I LULJETA LLESHANAKUT NË GJERMANISHT SHPALLET NË DHJETË LIBRAT E REKOMANDUAR ME POEZI

SHËNIME MBI LIBRAT

Romani i Ridvan Dibrës

"GRUAJA QË DESHE" OSE "ROMANI QË DESHE"

nga Adela Radovani (fq. 9)

"Krim e ndëshkim", 1866 dhe "Vëllezërit Karamazov", 1880

Liria si një fakt homocentrik në dy vepra të Dostojevskit

nga Skënder Karriqi (fq. 6)

Poezi për artistët në vëllimin "Love" të autorit

Skënder Sherifi

nga Dr. Gëzim Puka (fq. 8)

Batakçillëku me toponimet Vetëmbrojtja e shqipes

nga Rexhep Zllatku (fq. 10)



A NDRYSHOI MENDIMI TEORIK-LETRAR I STRUKTURALISTIT CVETAN TODOROV?

(fq. 20)

Nga Floresha Dado

Prespa nderoi shkrimtarin Sterjo Spasse, me ngritjen e muzeut në shtëpinë e tij të vjetër, në fshatin Gollomboc, ku ai lindi në vitin 1914

Muzeu që më zgjoi kujtimet e viteve studentore

Nga Xhafer Korro (fq. 12)

ANN SMITH

Strumbullari i diellit je ti

Përktheu nga suedishtja Qerim Raqi



(fq. 18)

BIBLIOTEKË

Arbër Selmani (fq. 13)

Nënës i vdiqën dy fëmijët e parë

Esmeralda Shpata (fq. 14)

Katrenë tregimesh

Qazim Shehu (fq. 16)

Tre tregime

Pajtim Statovci (fq. 15)

Vajza dhe Krijesa

Delvina Kërluku (fq. 17)

Shqiponjë në qiellin tonë

Arben Velo (fq. 19)

Variant për ditë të verbër

MIRA MEKSI, PËRKTHYESJA E MARKESIT

Nga Feride Pappleka

DAVIDI i Michelangelo

Buonarroti-t

Dr. Bledar Kurti

(fq. 10)

Redaksia e revistës "Letrari i ri", i përgjigjet nxënësit Ismail Kadare pse nuk mund t'ia botojnë poezitë që i ka nisur me postë nga Gjirokastra.

VJERSHAT TUAJA JANË SHKRUAJTUR ME NJË GJUHË QË AS NË PROZË NUK PËRDORET

Nga Andreas Dushi

Sikurse çdo ditë, bashkë me botuesin, Kadareja po pi kafën te "Juvenilja". E dija që atë drojen e mëpërparshme s'do ta kisha, ndaj rrugës me biçikletë nga Biblioteka Kombëtare deri aty, nuk stërmendova ndonjë gjë. Por sinqerisht, nuk ma mori mendja se biseda me Të do të ishte e atillë që pas dhjetë minutash ta shkrinte gjithë akullin e të shkritohej në një natyrshmëri të veçantë. Pyetjeve të mia, fillimisht tepër të zakonshme, që vinin e orientoheshin nga tema që më interesonte, u përgjigjej thjeshtë e lehtë, pa harruar detajet e rëndësishme sipas Tij.

Një herë, kohë më parë kur sapo kisha ardhur në Tiranë, te "Rogner" zhvillohej një takim me Helena Kadarenë. Isha me Rita Petron dhe në fund, vajtëm ta përshëndesnim. Rita më prazantoi, por znj. Kadare nuk e la të mbaronte: "Po, e njoh." i tha, dhe u kthye nga unë "Më ka folur Ismaili për ty." Nuk besoj se po të më kishin dalë krahë e të fluturoja, do të arrija më lart në qiell se në atë çast! Nuk m'u prit, telefonova prindërit e mi, shokët, këdo... Doja ta ndaja me të gjithë atë çka dëgjova: Ismail Kadare kishte folur për mua!

Tani, përballë Tij, dua t'i kërkoj të flasë për vete. Po si ta bëj këtë? Qysh kur e mendova, kushedi sa e sa mënyra kam sjellë në kokë, duke i peshuar, analizuar, sistemuar e kategorizuar në e - përshtatshme; s'është - gjë; do - të - më - përzërë - po - ia - thashë - këtë. Atë çast, lëmsh, s'flas dot, jo pse s'kam çfarë të them, por ngase nuk di ç'të them. Po të mos më nxiste Bujari, patjetër që përtej vështrimit tim me adhurim, kurgjë tjetër s'kish për të zënë vend mes meje dhe Is.. (Is., sikurse Helena e quan në kujtimet e saj... Dua t'i them edhe unë kështu, që Ai të më pyesë "pse" dhe t'i tregoj ndodhinë e përmendur më lart, por heq dorë menjëherë nga kjo, s'ka kuptim, zë pjesë pikërisht në kategorinë do - të - më - përzërë - po - ia - thashë - këtë).

"Andreasi punon në Bibliotekën Kombëtare..."

"Po, aty punoj.", sikur filloj ta marr ngadalë veten, "Dhe, kur po përgatisnim ekspozitën për ditëlindjen Tuaj, pata në dorë gazetën ku gjendet poezia juaj e parë, "Kush punon".

Kadare qesh lehtë. Unë ndaloj, në pritje mos do të thotë diçka, por asgjë. Në rregull Andreas, vazhdo tani, dil aty ku deshe që në fillim. Shpejt, mos e harron...

"Për këtë Ju shkruani në librin 'Koha e shkrimeve', ku tregoni si u mbrujtën këto poezi, si i pritët... Në fund tregoni një episod me babain..." dhe librin, e nxjerrë pak më heret nga çanta, e hap e lexoj.

Për çudinë time, më dëgjoi në të tillë mënyrë që mund të lexohej në dy soje: e para, sikur ishte aq i vëmendshëm sa dikush që po dëgjon për herë të parë diçka e cila i intereson shumë, ndërsa e dyta, sikur po bezdisej në heshtje e po priste të



mbaroja. Nga optimizmi, jam i prirur të besoj të parën, ndonëse e di se, sidomos tani, është e pamundur të lexosh gjësend në sjelljen apo qëndrimin e Tij. Mandej, ra heshtja e allasojtë që asnjëri s'po e griste dot: unë nga droja dhe ekzaltimi se Kadare., më kishte dëgjuar me vëmendje, paçka se kishte dëgjuar tekstin e Tij, ndërsa Kadare, ndoshta, në pritje të asaj çfarë do të thoja unë për të përligjur ato shtatë a tetë minuta kaluar duke lexuar.

"E kujtoni atë moment?" e pyes sa për të thënë diçka.

"Si jo?!" përgjigjet me ton të atillë që, jam i bindur se po të ishte në të tjera rrethana, do të ngjante ironik.

"E çfarë mund të shtoni për të?" por pendohem në vend! Po të qe diçka që do të donte ta shtonte, do ta kishte bërë në tekst. Si ta rregulloj... Si? (Ndër mend kam episodin e një interviste të Tij me një gazetare e cila, e lumturuar se më në fund po i merrte prononcim [kjo ishte fjala e saj] Kadaresë, e pyeti "Çfarë është për ju një libër i ri?", dhe Kadareja u përgjigj duke e parë drejt e në sy "Një libër i ri është një libër i ri.")

"Po çfarë të shtoj," u përgjigj

papritmas, duke më thënë se diçka do të shtonte, "Në gjithë jetën time, kjo ka qenë e vetmja bisedë serioze me tim atë."

Yes! Ky ishte çelësi. Tani e çela s'endukun e fëmijërisë së tij. Nuk kam pse ta pyes "Po punon me diçka?" apo, larg qoftë "Çfarë ju ka frymëzuar për të shkruar këtë apo atë vepër?" për të mos e çuar dëm mundësinë e kësaj bisede!

"Pse, si ka qenë raporti Juaj me babanë?"

As nuk ma kishte marrë mendja se biseda do të futej në këtë hulli. Pyetjet e mia ishin të atilla që ta nxisnin të tregonte për krijimet e hershme, por tanimë, e gjitha m'u duk shumë më interesante.

"Nuk e di... Nuk bisedoja kurrë me babanë!"

"Po shokët çfarë thonin për babain?" ndërhyu Bujari, "E pëlqenin shokët babain tuaj, apo jo?"

"Shokët e pëlqenin babanë tim, u kujtonte deri diku Hitlerin, prandaj," përgjigjet Kadare. Unë qesh, s'e di ngase kjo më ngau të qesh apo nga sikleti, por më bëri përshtypje se Ai, në fakt, e kishte me shumë seriozitet.

"Ndryshe nga rasti i nënës, babain nuk e keni të pranishëm as te kujtimet, as në letërsi... Për shembull, nëna identifikohet me Kukullën...", ndërkohë Kadare pohon gjithë kohës, "Po pse babai ka këtë mungesë?"

"Po pse, e di unë?!"

"Gjendet," më korrigjon Bujari.

"Dakord, po shumë rrallë..."

"Pse, ku e kam?"

"Po ja," vijon Bujari, "Kur thua se ishte hera e parë që e urreje tët atë kur vjen Remzi Kadare dhe i lutet me një qese florinj, ta mbajë në shtëpi, pasi gjithçka e kishte lënë në bixhoz. Dhe babai që i tha: Jo!, e ju kthye: Kurrë s'do të shkelësh këtu!"

"Remziu ishte xhaxhai Juaj?" pyes Kadarenë.

"Jo, kushëriri i tim eti."

"Po kur u zhvendosët në Tiranë e mandej u bëtë i njohur... A ndryshoi

diçka?... A kishte interes ai për letërsinë Tuaj?"

"Jo!"
"A ka lexuar diçka nga Ju?"
"Nuk besoj se i ka lexuar."

"Po mirë, po a fliste ndonjëherë... Nuk e di... Lidhur me letërsinë, me faktin që përmendeshit...?"

"Jo...!"
"Dakord, mirë me Ju, po me vëllain, Shahinin apo motrën, Kakunë, ishte ndryshe raporti i tij?"

"Kakuja ishte më e madhe se unë, kuptonte shumë gjëra..."

"Kishte me babain marrëdhënie më të afërt se ju?"

"Jo, fare!"

Nuk e di pse, vijoj të ngul këmbë në të njëjtën pyetje! Dua që patjetër në një moment Kadareja të më përgjigjet "Po!", kur e pyes, kronologjikisht, nëse në ndonjë çast i ati ndryshoi në raport me të, prandaj, pa lënë asnjë sekond të kalojë, e pyes për periudhën në Rusi:

"Po kur ishit në Rusi student? Shkëmbejit letra me familjen? Veçanërisht babai, kujtoni t'ju ketë shkruar ndonjëherë?"

"Me nënën, vetëm. Më shkruante ajo herë pas here ndonjë letër. Se pse e bënte, nuk e di. Dhe kur e byllite, në vend të FUND shkruante FUT."

Sërish, asgjë! Në rregull, tani do ta pyes fare hapur, s'kam si t'ja bëj ndryshe:

"Në rregull. Po me babain,

personalisht, si mund ta përshkruani marrëdhënien Tuaj?" Drejqin, mos ndoshta e teprova? Nxitoj të shtoj "Si mund ta përshkruani shumë shkurt?"

"Inekzistencë, ku di unë... S'e di!"

Me patjetër, dua ta nxjerr diku babanë! Unë nuk i besoj përqasjeve të studimit të letërsisë sipas Formalizmit Rus, prandaj e pyes, i bindur se pas kësaj s'mbetet më gjë tjetër:

"A mendoni se kjo lloj marrëdhënieje ju ka ndikuar në krijimtari apo...?"

"S'e di, s'e gjej, nuk besoj."

"Po rasti i nënës... Ai është krejt ndryshe! Keni një lidhje jo të afërt, por... Një lidhje të paktën!"

"Të çuditshme! S'e di, nuk e di, s'e gjej gjëkund tim atë."

Epo mirë, mes Tij dhe babait s'kam çfarë të rrëmoj më tej. Por gjithmonë, tema e babait më ka intriguar jo pak. Në çdo rafsh, figura e tij është tepër e veçantë. Qysh në krye, Zoti është një Atë dhe Biri i Tij, kur lind, rritet nga një figurë burrërore,

nga Jozefi për të cilin nuk gjejmë të shkruar thujtë asgjë, më pas për filozofë të ndryshëm, etër të nihilizmit e absurdit, psikologët kanë zbuluar probleme me baballarët që i kanë nxitur të krijonin rryma të atilla... Apo Kafka, shembulli tipik i një marrëdhënieje që artisti, herë pas here ka apo në nënvetëdije kërkon të ketë me babain... Edhe te Kadareja, disi babai duhet të jetë, nuk e di pse s'po e pranoj dot përgjigjen e Tij.

"Po nëna me babain? Kështu ka qenë edhe me të babai, i largët?"


"Nuk e di... Besoj se po... Nuk kujtoj t'i kem parë ndonjëherë të flisnin diku, të veçuar, nën zë, njëri me tjetrin."

Tani mendoj se duhet ta përgjithësoj, duke e shkrirë babain brenda familjes, prandaj pyetja e radhës është:

"Kur zgjodhët të merreni me letërsi, e pyetët apo i kërkuat mendim familjes?"

"Jo, fare!"

"Kur i thatë se morët këtë vendim,



çfarë Ju thanë??"
"S'u thashë kurrë se kam marrë këtë vendim!" Pason një heshtje, e mandej Kadare vazhdon: "Edhe mua më vjen çudi, nuk di si ta kujtoj, çfarë emrash t'i vë..."

"Më bën shumë kureshtar se si reagan kur Ju u bëtë i njohur... Për shembull, pas 'Gjeneralit'..."

"S'e di... Im atë vdiq në '75... Atëherë 'Gjenerali' ishte botuar..."

"Po mirë, as urime nuk ju tha?"

"Jo! Tërësisht indiferent. Vërtetë s'di si ta kujtoj. Dhe nuk e di nëse kjo indiferencë ishte komode për mua apo jo. Nuk doja të ma përmendte..."

Ndonëse e shtjellon te "Kukulla", e pyes për të emën:
"E nëna, si u raportua me faktin që Ju u bëtë i njohur?"
"Po i dinte gabim nëna ime të gjitha gjërat. Motra ime më spijunonte në

familje për çfarë bëja, shkruaja... E ndërkohë, do të shkrihesh gazet, nëna ime më të një moment se kishte frikë mos e ndërroja..."

Nxitoj ta ndëpres, dua t'i them se e di, e kam lexuar te "Kukulla", e ashtu bëj. Po provoj të sfidohem me të? Këtë mendova, jo pa krenari të shoqëruar nga një ndjenjë e fortë faji, turpi...

"Ku di unë," vijon Kadareja, "Familje girokastrite, s'ishte për muhabet!"

Në fund, kur bashkë me Bujarin po e shoqëronim Kadarenë në xhiron e tij pranë parkut të Liqenit, e pyeta nëse mund të më vinte në dispozicion dorëshkrimin e librit të Tij të fundit, "Kur sunduesit grinden", për të përgatitur për botim kritik një pjesë të tij, bazuar në shembullin e përkryer, dhënë nga

Gorki dhe parimi Leninist i frymës së Partisë në Literaturë

Letra e Gorkit me të madhe dhe me të rëndësishme se ç'është mendimi në. Kur ne shikim në planin e faktore të përgjithshme, ne nuk e shohim se jemi në fillim të një procesi historik të ri, se asistojmë në lindjen e një karakteri psikologjik të ri... Po, do të themi ju, po, 'Gjok', 'Kufoma', 'Gjokmaja'! Sa shprehjet që bashkohen këtu! Vërtetë! Vërtetë, Sëdun, Madhen, s'cilin nga këtu ka hapësirë në të njëjtën kohë të madhe me këtu... Nëna mban një vlerë të çmueshme: epy mëdha që model përshkrimtarë që krijohen për të parashitjen të një të vërtetë të gjatë madhështore e saj figurë në jetë të ri, të s'cilin i'ja gjatë mijëna njërës të jetës. Nëna, dhe, si u bëri qortu, s'omni i famshëm i Nikolai Ostrovskit, në do të kishte mundar të shkruante. Në qoftë se Dostojevskit thashë për vëllain e tij dhe për shkruarit e tij realitet të bashkë të tij, që ato këtu, d'atë të gjithë në jetë të Gorkit, shkruarit në jetë të këndshme me të të drapit të afërme të influencës së Nina e Gorkit ka shkruar mbi të.

që u bë i sotë të krijonte një veprë të shkruarit organikisht, për të parën herë, realizimi dhe romanizimi revolucionar. Gorki ishte në dorë të asaj e asaj, një urdë të fuqishme ideologjike të re: ideologjia e literaturës së partisë të formuar nga Lenin.

Vendi në mangun, në këtë artikull për të analizuar influencën vendimtare që ky parim i madh i Lenin-it pati mbi veprën e Gorkit. Le të kujtojmë dhe të shprehim se vepra këtu mbi të cilin Gorki punoi gjatë jetës së tij të fundit, jeta e Klum Sanginit i u bashkua kryesisht demokracisë të ideologjive të Gorkit. Nëna mban një vlerë të çmueshme: epy mëdha që model përshkrimtarë që krijohen për të parashitjen të një të vërtetë të gjatë madhështore e saj figurë në jetë të ri, të s'cilin i'ja gjatë mijëna njërës të jetës. Nëna, dhe, si u bëri qortu, s'omni i famshëm i Nikolai Ostrovskit, në do të kishte mundar të shkruante. Në qoftë se Dostojevskit thashë për vëllain e tij dhe për shkruarit e tij realitet të bashkë të tij, që ato këtu, d'atë të gjithë në jetë të Gorkit, shkruarit në jetë të këndshme me të të drapit të afërme të influencës së Nina e Gorkit ka shkruar mbi të.

prof. Matteo Mandala me "Në studion Kadare" ("Onufri", 2016). Pranoi me përziemëri, për habinë time. (Kujtoj një herë, në një takim të para një viti a më shumë me të, i kërkova një autograf për një mike. "Patjetër!", tha dhe mori librin. Në vend që të shkruante Me përziemëri autori shkroi I përziemërt autori. Pasi e lexoi, qeshi dhe tha: "Çudi si e shkrova kështu! Unë as nuk jam i përziemërt!") Duke punuar tani me të, me shënimet në anë të faqeve, fjalë e shprehje, deri edhe pjesë të tëra që Kadare i ka hequr apo zëvendësuar, pyes veten se si ka mundësi që dikush i cili flet të njëjtën gjuhë me ne dhe përdor tridhjetëgjashhtë shkronja si të gjithë ne ja ka dalë t'i kthejë ato shkronja në konstelacione për t'i dhënë kësaj gjuhe kaq shumë.

Fragment nga "Koha e shkrimeve" ku Kadare tregon përvojën e tij të parë të botimit

Nga Ismail Kadare

Iliri më priste te rrugica.

-Ama ç'ditë, - tha.

Unë s'u përgjigja. Një copë rrugë e bëmë kokulur të dy.

-Sikur të hiqnim dorë nga ato vjershat, - tha Iliri. - Më duket se gjithë kjo prapësi prej tyre po na vjen.

S'dija ç't'i thosha dhe ashtu pa folur u ndamë parë portës së shtëpisë sime. Një copë herë u vërtita nëpër shtëpi pa ditur ç'të bëja. Tek po soditja pullazet nga dritaret e katit të tretë, m'u duk se tyntari i shtëpisë së zotit Jorgaq nxirrte tym më të dendur se zakonisht. Me siguri, ishte duke i treguar së shoqes atë që kishte ndodhur dhe ajo nga zemërimi hidhte dru të lagëta në zjarr.

U largova nga dritarja, por mërzia m'u shtua më tepër kur m'u kujtua ajo puna e vjershave, prej të cilave duhej të hiqja dorë. Shumë vargje dhe strofa të lëna përgjysmë i kisha shkruar me laps andej-këndej nëpër muret e shtëpisë, në vendet prapa dyerve, që të mos binin në sy. Me një ndjesi mallëngjimi, që ma shkaktonte braktisja e tyre, shkova t'i shikoja edhe një herë, duke u përpjekur që t'i lëvizja pa zhurmë flegat e dyerve. Ishin aty, të fshehura pas tyre, shumica të lëna përgjysmë, me ndonjë rimë të rrallë që e kisha gjetur me aq mundim. Mendimi se do të më duhej të hiqja dorë prej tyre bëri që të më hipte një dëshirë e zjarrtë për të plotësuar ndonjë nga ato strofa gjysmake. Nxora lapsin dhe nën rreshtin "Kush punon", që mund të merrej edhe si titull i një vjershe, shkrova vazhdimin: "Rehat shkon". U habita dhe vetë nga lehtësia me të cilën e gjeta vargun bashkë me rimën. Por habia do të bëhej më e madhe, kur pas gjysmë ore mundimi të skëtërrshëm arrita ta plotësoja gjithë strofën:

*Kush punon
Rehat shkon
Detin e kalon
Njeri s'e ndalon.*

I mrekulluar, s'ngopesha së lexuari vargjet, pa u besuar syve se si kisha mundur ta shkruaja atë që më dukej si kulmi i artit poetik.

Pa e zgjatur më, e kopjova strofën dhe, duke i zbritur shkallët nga tri e nga katër, randa si i marrosur nga shtëpia për të thirrur Ilirin. Ai doli tërë hundë e buzë te porta, sikur të thoshte: fillove prapë ti, s'të mjaftoi gjithë ajo lemeri që na panë sytë.

Kështu u duk, por, kur ia lexova strofën, harroi gjithçka, u mrekullua më shumë se unë dhe, duke i rënë ballit me dorë, nisi të thoshte herë me zë të lartë, herë me pëshpërimë: "pupu, ç'kryevepër!".

Zemra m'u bë mal nga ngazëllimi dhe u ktheva prapë në shtëpi për të vazhduar atë që u quajt prej të dyve si "vjersha më e bukur e gjithë poezisë shqipe".

Iliri tregohej më i paduar se unë. Ndërsa unë kafshoja herë gishtat dhe herë lapsin për të shkruar vazhdimin e vjershës, ai erdhi nja pesë a gjashtë herë për të parë si vente puna. Më në fund, aty buzë mbrëmjes çatisa te porta e Ilirit. Na merrej fryma të dyve, mua nga vrapi, atij nga tronditja, dhe ashtu me frymë të marrë lexova strofën tjetër:

*Kush nuk punon
Rehat nuk shkon
Detin s'e kalon
Njeri e ndalon.*

Iliri mbeti një grimë i mekur, pastaj zuri kokën me duar:

-Kulmi, - tha me zë të çuditshëm, një zë i shprishur, që s'ia kisha dëgjuar ndonjëherë. Madhështore, gjeniale. Ia kalove krejt poezisë franceze.

Isha pothuajse i sigurt për një gjë të tillë, megjithatë më erdhi mirë kur e dëgjova nga goja e një tjetri.

-Lexoma dhe një herë, - tha ai dhe, kur unë përsërita leximin, ai u mahnit edhe më tepër.

-Francezen e vure poshtë, - tha. - Të ka mbetur vetëm poezia bullgare, pastaj...

Nuk guxova ta pyesja se ku bazohej për një gjykim të tillë, që nuk ia kisha dëgjuar ndonjëherë.

-Duhet ta nisësh menjëherë për botim, - tha pas pak.

-Po ku?

-As unë s'e di. Të pyesim.

Të nesërmen morëm vesh se në Tiranë kishte një Lidhje të Shkrimtarëve, e cila botonte një gazetë dhe një revistë letrare. Vendosëm ta dërgonim vjershën në të dyja, madje Iliri mendonte ta dërgonim në të gjitha gazetatat e Shqipërisë.

E kopjova prapë disa herë vjershën, i vura nën të emrin tim, emrin e tim eti dhe mbiemrin dhe të dy me Ilirin shkua me vrap në postë. Ishim krejtësisht të sigurtë se vjersha do të botohej në faqet e para të revistës e të gazetës njëkohësisht.

3

Kudo që ndodhesha, në mësim, në lojë, përpara gjumit, ose pas zgjimit, mendja më rrinte te vjersha. Ilirit gjithashtu, madje nganjëherë më dukej se ai që më i ndezur se unë. E sillja ndër mend me ngazëllim, me shpresë, me mallëngjim bukuroshen e vogël, që kishte ikur e vetme larg, atje nëpër redaksira, dhe që do t'i mahniste të gjithë. Kur qëllonte që merrja ndonjë dëshirë ose ndonjë qortim nga mësuesi apo nga im atë, me vete thosha: punë e madhe, le të marr dysha, le të më tërheqin veshin, ajo ndërkaq është atje dhe askush nuk mund ta kthejë mbrapsht. Të dy me Ilirin numëronim ditët, duke u përpjekur të gjenim nëse kishte mbërritur apo jo. Pastaj përfytyronim se si do të shtangeshin redaktorët kur ta lexonin, si do të mblidheshin kokë më kokë, të thërritnin shokët nga zyrat e tjera, madje nga redaksitë e tjera, ta lexonin prapë, t'i binin ballit me dorë, të kërkonin aspirina, ujë etj., etj.

Ndërkaq, duke qenë në pritje, nuk rrinim duarkryq. Iliri kishte lexuar diku parullën "të mos dehemi nga sukseset" dhe çdo ditë vinte me nga një ide të re. Ai vazhdonte të ngulte këmbë se tani që poezinë franceze e kisha vënë përfund, duhej synuar patjetër ajo bullgare. Asnjëherë s'arrita ta kuptoja se nga i vinte kjo, veç ishte kaq i bindur, saqë, kur përfytyronim çmeritjen e redaktorëve atje në Tiranë, aspirinat, ujin etj., Iliri ishte i sigurt se midis klithmave të tyre, e para do të ishte "ah, sikur t'ia kalonte dhe poezisë bullgare!".

Një pasdite, ai erdhi tek unë me një libër të çuditshëm: "Metrika shqipe", që kushedi ku e kishte gjetur dhe që ma bëri mendjen dhallë, kaq i vështirë m'u duk. Një ditë tjetër më tha se e kishte gjetur, më në fund, se ç'duhej të bëja: duhej të shkruaja

gegërisht. S'e mora vesh se si i kishte lindur ky mendim, por nuk u desh të kalonte as gjysmë ore, që të më dukej i vetmi mendim i arsyeshem.

Kuptohej që me kalimin në gegërisht, mundimet e vjershërimit m'u dyfishuan. Gjumin e bëja të turbullt, në mësim mezi mbahesha, ndërsa mbulesat e fletoreve dhe muret pas dyerve po mbusheshin me vargje të një lloji tjetër. "Vrik asht çue partizani", ose "Shka ka thanë n'jai trim i lokes".

Ndërkaq, ditët kalonin. Pas mendjes sonë, vjersha duhej të kishte mbërritur në Tiranë dhe për ne nisën ditët e padurimit. Midis tyre, i lehtë, por këmbëngulës, shfaqej herë-herë tisi i parë i trishtimit.

4

Të dielën në mëngjes isha duke dremitur me kokën mbi detyrat e aritmetikës, kur e çrregullt, marroke, ashtu si dhe çdo gjë tjetër e Ilirit, më zgjoi trokitja e tij. Midis trokitjeve diçka thërriste me zërin e tij, që në këso rastesh i dilte tjetërfarësh: as i hollë, as i trashë, por i përzier, zë koke e gryke njëkohësisht, që nuk mund të të ndilte veç për gjëra të marra.

S'u besoja veshëve, aq e mrekullueshme m'u duk britma e tij: "U botua! U botua!". Me duart që më dridheshin hapa portën dhe atëherë gëzimi m'u përplas në fytyrë në trajtën e një gazete, që Iliri e kishte shpalosur të gjithën, duke e zbardhur gjithë botën. Ishte i ndërkryer i gjithi, merrte frymë me zor dhe u desh një copë herë sa ta gjente vendin ku qe vjersha. Zhgënjimi që nuk e pashë me shkronja të mëdha, që të zinte krejt faqen, por në një kënd, saqë mezi dukej, u davarit në çast, kur afrova sytë dhe, oh, mrekulli, pashë vargjet që i kisha shkruar te muri, prapa derës së mesores, pikërisht ato, jo mbi gëlqere tashmë, por mbi letër, me shkronja të vërteta, dhe sipër tyre emri im, emri i babait dhe mbiemri. Krejt si në libra, Leon Nikollajevič Tolstoj. Foqion Postoli. Shekspiri.

U desh të kalonte ca kohë që të mblidhnim veten dhe të kuptonim se në të vërtetë nuk qe botuar krejt vjersha, por vetëm strofa e parë e saj, madje dhe kjo jo më vete, por në rubrikën e përgjigjeve "Posta e redaksisë", në faqen e katërt.

-Po prit, - thashë unë, - ç'kanë shkruar këtu?

-S'ka fare rëndësi, - tha Iliri dhe i hodhi sytë gjetkë, por unë, ndërkaq, kisha nisur të lexoja rreshtat që më drejtoheshin mua si përgjigje: "Morëm vjershën tuaj 'Kush punon' dhe të themi të drejtën u habitëm pak. Ju shkruani një gjuhë që as në prozë nuk përdoret. Për shembull: Kush punon, rehat shkon, detin e kalon, njeri s'e ndalon. Po të ishte kështu, do të bëheshin të gjithë shkrimtarë dhe poetë. Megjithatë, mos e humbisni kurajën. Vetëm kini parasysh një këshillë: lexoni përpara se të vendosni të shkruani".


Një grimë mbeta si i mpirë, por Iliri ma rrëmbeu gazetën nga duart.

-Ç'më rri ashtu? - tha ai. - Nuk gëzon që të ka dalë emri dhe vjersha është botuar?

I çova sytë prapë te strofa e botuar dhe tek emri i shtypur me shkronja të zeza, për besë, Foqion Postol, Eskil, Aleksandër Dyma (biri), dhe në çast e harrova tekstin e përgjigjes dhe të dy me Ilirin nisëm të hidheshim përpjetë nga gëzimi.

Në drekë babai hyri në shtëpi i vrenjtur. Pa thënë asgjë, m'u afrua, më zuri nga veshi dhe ma tërhoqi një copë herë.

-Ti, more mistrec, ke guxuar të vësh emrin tim në ato shkarravinat e tua, hë? More kastravec, që më bëre të më skuqet faqja sot në kafene. More birbo, që kemi jetuar gjithë jetën me nder dhe erdhe ti të na turpërosh, dhe ku pa, në gazetë... Bëre ç'bëre, të mos të shoh më të merresh me turpëri të tilla, more vesh?



Faksimile nga përgjigja e redaksisë së gazetës "Letrari i ri"

Një ditë prej ditësh, gjatë vjeshtës së kaluar, kur e mendoja të humbur këtë shkrim për Mira Meksin, ose si kam dëshirë ta quaj unë Mira e mirë, nga që nuk e dija edhe se në cilën gazetë e kisha botuar, e hasa në një dosje me artikuj të prerë e të grumbulluar me idenë për të zgjedhur në të ardhmen ndonjë prej tyre për ribotim.

E lexova me kureshtje dhe me çudi portretin që i kisha bërë para tridhjetë vjetësh, me dëshirën për të përjetuar sado pak atë magji që më krijuan episodet e jetës së saj kur mbledhja të dhëna. Me Mirën atë herë punonim bashkë për botimet e kohës para rënies së partisë-shtet dhe kishim një lloj miqësie të bukur, ashtu si di t'i ndërtojë ato Mira, thjesht dhe natyrshëm, shoqëruar me një lloj humori që asnjëherë nuk i ka munguar. Miqësi që vazhdon edhe sot, me gjithë rrënimet e kohës.

Shkrimin po e ribotoj, ashtu si është paraqitur dikur në gazetë, ky është ligji i gazetarisë për raste të tilla, me të vetmin ndryshim se atëherë ai radhitej me shkronja plumbi, tani radhitet në kompjuter me shkronja virtuale e me mundësinë e paçmuar të korigjimit për të shmangur gabimet. Unë e quajta atëherë Mirën në mënyrë hipotetike "Përkthyesja e Markesit", pa e ditur se çfarë mund të ndodhte. Sigurisht, duhet një tjetër shkrim për ta për shkruar rrugën e bukur dhe të mundimshme të përkthimit e të krijimit. Mira sot është autore e disa romaneve e tregimeve si dhe një ndër përkthyeset e rralla të shqipëse.

Para disa muajsh, në kohën e riaftësimit të saj pas një ndërhyrjeje të rëndë kirurgjikale, në një e-mail ajo më përgjigjej se i është futur përkthimit të një veprë tjetër të Markesit, po aq të madhe si të gjitha veprat e tij, por tepër të vështirë. "Unë i kam hyrë detit në këmbë", më shkruante ndër të tjera. Të përkthesh Garcia Marquez-in, i

MIRA MEKSI, PËRKTHYESJA E MARKESIT

Nga Feride Papeleka



cili mbahet "si zbulimi më i madh i gjuhës spanjolle që nga Don Kishoti i Cervantes-it", sipas fjalë vetë Pablo Neruda-s, është një detyrë me përgjegjësi krijuese dhe qytetare. Mua më gëzoi fakti se ajo po shugurohej sërish edhe si "Përkthyesja e Markesit", pavarësisht nga jehona e trishtuar në shpirt që më sjell gjithnjë fjala operacion.

"Përkthyesja e Markesit"

Të sfidosh kohën dhe rutinën e përditshme, do të thotë të fitosh një betejë që nis e nuk mbaron. Koha pastaj sendërtohet e merr vlerë, rutina e përditshme nuk ekziston. Kështu mund të nisë një skicë e portretit të Mira Meksit që me kulturën dhe synimet e saj po i bën vend vetes në radhët e intelektualëve e të krijuesve më të emancipuar të vendit.

Mos e përfytyroni as me syza, as me pamje akademike dhe as me ecje hijerëndë. Me flokë të prera shkurt, rinore në pamje

dhe në ecje, ajo duket sikur është ende studente dhe se pesha e jetës ka mbetur diçka e papërfillshme për të. Por ja që në një ditë të zakonshme ajo ka guxim të matet me Garsia Markesin. Ia del të përkthejë me sukses romanin e tij "Dashuri në kohërat e kolerës". Disi e pabesueshme edhe për vetë shkrimtarin, qendër sa ndodhet përballë Mirës në Barcelonë, në një takim si në ëndërr, të realizuar pas një odiseje romantike të përkthyeses shqiptare, pyet sekretaren e vet: "Kjo çupëlina është përkthyesja ime?" Ëmbëlsia dhe dashuria e zërit të Markesit, tashmë e kishte nxjerrë Mirën "nga dallia, akulli dhe dilema". Të dy e vështrajnë njëri-tjetrin: "Njëri me 'sy të trishtuar, por buzagaz', tjetra 'fytërrëngrysur e me kriza të forta emocionesh', që nuk e lënë të qetë gjatë gjithë takimit."

Sigurisht lexuesit mund të mos e dinë se Mira ka mbaruar studimet për gjuhë e letërsi frënge. Kur ishte studente përkthente vargje nga Bodleri, por spanjishtja që si vera e Dionizit. "Letërsia që dua më shumë, është

letërsia hispanike", thotë ajo. Dhe falë këtij pasioni arriti ta zotëronte spanjishten.

Përkthimi i parë i saj është "Mposhtja e shtrigave", novelë nga Migel Bunjuel, pastaj sërish nga Bunjuel, "Djalhti, dallëndyshja dhe maçoku", i cili ka marrë çmimin "Lazarillo", çmimi më i madh që jepet në Spanjë për letërsinë për të rinj dhe fëmijë. Nga J. M. Gisbert ka përkthyer "Arkitekti dhe perandori i Arabisë", libër për të rinj. Gisberti është Krishti te tregimi i saj, botuar vitin e kaluar te gazeta "Tirana". Për Mirën, Gisberti është më shumë se shkrimtar; është magjistar, sepse nga ai ka mësuar të futet në të fshehtat e artit të letrave, si "Liza në botën e çudirave". Pra: Mira i ka hedhur hapat e parë si autore. Një trill apo një kërkesë e brendshme? Një dhunti apo një kërkesë për të dalë nga kornizat e "monotonisë"? Ajo është një grua me temperament, me energji, me vullnet. Një fushë e vetme veprimtare për t'u shprehur, siç është përkthimi, qoftë kjo e pakufishme, nuk i mjafton. Përmbledhja e saj me përralla filozofike "Letra e tri pëllëmbë mjekërkaltërit" është në shtyp, ndërsa ka shkruar dhe romane për të rinj, si "Teotikuahani - vendi i diellit". Disa tregime të Mirës janë botuar në gazetë. Njëri prej tyre është botuar në Spanjë me titull « Gërshtëret e Mirës ».

Kur bisedon, si pa kuptuar ajo e hedh fjalën sa te spanjishtja, sa te frëngjishtja. I duhet të dyzohet ose herë-herë ta lerë mënjane spanjishten, ashtu siç lemë fëmijën e përkëdhelur që na mundon. Ka përkthyer "Opera e hënës", poezi për fëmijë nga Zhak Prever; "Kyçi i botës", roman për të rinj nga Mishel Grimo, "Tre muskëterët", dy vëllime me rreth 1000 faqe. Nga shqipja në frëngjisht ka përkthyer poezi të Ismail Kadaresë në bashkëpunim me Edmond Tupjen dhe Clod Duran për shtëpinë botuese «Fayard» në Francë. Mira përkthen përditë dhe tërë ditën, siç thotë natyrshëm, pa i vënë ndonjë rëndësi këtij fakti, sepse i duket diçka e zakonshme. Nëntë vjet punë ende s'i ka mbushur. Ka edhe një djalë gjashtë vjeç, Marinin, që po i mëson spanjishten. Këtu mbase është vendi që të përmendet edhe i shoqi, Iliri, të cilin e ka shok dhe mik, siç thotë. Në sukseset e saj është e pranishme edhe ndihma e tij. Ajo lexon në drekë kur «pushon», ndërsa kur është frymëzuar, shkruan. Në të ardhmen, thotë, kam ndërmend t'i kushtohem krijimtarisë. Dëshirë apo vendim? Pas pak tregon një sekret: «Po shkruaj një libër me tregime dhe mbresa. Po përkthej Borhesin dhe Moruanë». E dyzuar dhe para një shtegu që mund t'ia ndryshojë rrjedhën e jetës.

Te makina e shkrimit, pranë bibliotekës, Mira merr në duar një kartolinë dhe lexon një përsëritje që i ka ardhur nga larg. "Cili është kujtimi më i bukur i jetës sate?", e pyes. Pak formale kjo pyetje, sepse përgjigjen disi vagëllimthi e marr me mend. "Zbulimi i veprës së Markesit dhe takimi me të", më përgjigjet.

Te makina e shkrimit, pranë bibliotekës, Mira merr në duar një kartolinë dhe lexon një përsëritje që i ka ardhur nga larg. "Cili është kujtimi më i bukur i jetës sate?", e pyes. Pak formale kjo pyetje, sepse përgjigjen disi vagëllimthi e marr me mend. "Zbulimi i veprës së Markesit dhe takimi me të", më përgjigjet.



ZERI I RINISE E shtunë, 10 tetor 1992

Përkthyesja e Markesit

Të sfidosh kohën dhe rutinën e përditshme; do të thotë të fitosh një betejë që nis e nuk mbaron. Koha pastaj sendërtohet e merr vlerë, rutina e përditshme nuk ekziston. Kështu mund të nisë një skicë e portretit të Mira Meksit që me kulturën dhe synimet e saj po i bën vend vetes në radhët e intelektualëve e të krijuesve më të emancipuar të vendit.

Mos e përfytyroni as me syza, as me pamje akademike dhe as me ecje hijerëndë. Me flokë të prera shkurt, rinore në pamje dhe në ecje, ajo duket sikur është ende studente dhe se pesha e jetës ka mbetur diçka e papërfillshme për të. Por ja që në një ditë të zakonshme ajo ka guxim të matet me Garsia Markesin. Ia del të përkthejë me sukses romanin e tij "Dashuria në kohërat e kolerës". Disi e pabesueshme edhe për vetë shkrimtarin; që ndërsa ndodhet përballë Mirës në Barcelonë, në një takim si në ëndërr, të realizuar pas një odiseje romantike të përkthyeses shqiptare, ai pyet sekretaren e vet: "Kjo çupëlina është përkthyesja ime?" Ëmbëlsia dhe dashuria e zërit të Markesit, tashmë e kishte nxjerrë Mirën "nga dallia, akulli dhe dilema". Të dy e vështrajnë njëri-tjetrin: "Njëri me 'sy të trishtuar', por buzagaz, tjetra 'fytërrëngrysur e me kriza të forta emocionesh', që nuk e lënë të qetë gjatë gjithë takimit."

Sigurisht lexuesit mund të mos e dinë se Mira ka mbaruar studimet për gjuhë e letërsi frënge. Kur ishte studente përkthente vargje nga Bodleri, por spanjishtja që si vera e Dionizit. "Letërsia që dua më shumë, është le-

terësisia hispanike", thotë ajo. Dhe falë këtij pasioni arriti ta zotëronte spanjishten.

Përkthimi i parë i saj është "Mposhtja e shtrigave", novelë nga Migel Bunjuel, pastaj sërish nga Bunjuel, "Djalhti, dallëndyshja dhe maçoku"; i cili ka marrë çmimin "Lazarillo", çmimi më i madh që jepet në Spanjë për letërsinë për të rinj dhe fëmijë. Nga J. M. Gisbert ka përkthyer "Arkitekti dhe perandori i Arabisë", libër për të rinj. Gisberti është Krishti te tregimi i saj me të njëjtin titull, i botuar te gazeta "Tirana" vitin e kaluar. Për Mirën, Gisberti është më shumë se shkrimtar; është magjistar; sepse nga ai ka mësuar të futet në të fshehtat e artit të letrave; si Liza në botën e çudirave. Pra: Mira i ka hedhur hapat e parë si autore. Një trill apo një kërkesë e brendshme. Një dhunti apo një përpjekje për të dalë nga kornizat e "monotonisë". Ajo është një grua me temperament; me energji; me vullnet. Një fushë e vetme veprimtare për t'u shprehur; qoftë kjo e pakufishme siç është përkthimi; nuk i mjafton. Përmbledhja e saj me përralla filozofike "Letra e tri pëllëmbë mjekërkaltërit" është në shtyp, ndërsa ka shkruar edhe romane për të rinj, si "Teotikuahani - vendi i diellit". Disa tregime të Mirës janë botuar në gazetë. Njëri prej tyre "Gërshtëret" është botuar në Spanjë me titull "Gërshtëret e Mirës".

Kur bisedon, si pa kuptuar ajo e hedh fjalën sa te spanjishtja; sa te frëngjishtja. I duhet të dyzohet ose herë-herë ta lerë mënjane spanjishten; ashtu siç lemë

fëmijën e përkëdhelur që na mundon. Ka përkthyer "Opera e hënës", poezi për fëmijë nga Zhak Prever; "Kyçi i botës", roman për të rinj nga Mishel Grimo, "Tre muskëterët" dy vëllime; me rreth 1000 faqe. Nga shqipja, në frëngjisht ka përkthyer poezi të Ismail Kadaresë në bashkëpunim me Edmond Tupjen dhe Clod Duran për shtëpinë botuese «Fayard» në Francë.

Mira përkthen përditë dhe tërë ditën, siç thotë natyrshëm, pa i vënë ndonjë rëndësi këtij fakti, sepse i duket diçka e zakonshme. Nëntë vjet punë ende s'i ka mbushur. Ka edhe një djalë gjashtë vjeç, Marinin, që po i mëson spanjishten. Këtu mbase është vendi që të përmendet edhe i shoqi, Iliri, të cilin e ka shok dhe mik, siç thotë. Në sukseset e saj është e pranishme edhe ndihma e tij. Ajo lexon në drekë kur «pushon», ndërsa kur është frymëzuar, shkruan. Në të ardhmen, thotë, kam ndërmend t'i kushtohem krijimtarisë. Dëshirë apo vendim? Pas pak tregon një sekret: «Po shkruaj një libër me tregime dhe mbresa. Po përkthej Borhesin dhe Moruanë». E dyzuar dhe para një shtegu që mund t'ia ndryshojë rrjedhën e jetës.

Te makina e shkrimit, pranë bibliotekës, Mira merr në duar një kartolinë dhe lexon një përsëritje që i ka ardhur nga larg. "Cili është kujtimi më i bukur i jetës sate?", e pyes. Pak formale kjo pyetje, sepse përgjigjen disi vagëllimthi e marr me mend. "Zbulimi i veprës së Markesit dhe takimi me të", më përgjigjet.

FERIDE PAPELEKA

1- Tolstoi, Dostojevski dhe një epigraf bibliik.

Në vitin 1878 Tolstoi botoi një nga kryeveprat e tij: "Ana Karenina", zhvillimit të ngjarjeve të të ciliës i paraprin epigrafi bibliik: "Imja është hakmarrja dhe unë do të hakmerrem/do të shpagoj", (sipas alternativës së përkthimit të Bujar Hudhrit në shkrimin "A janë përkthyer saktë?"), botuar në "ExLibris", dt 07.05.2022. Në pjesën III të "Historia e letërsisë ruse e shek. XIX", cituar po aty, "Epigrafi perceptohet edhe si një kujtesë për shoqërinë, se si asaj nuk i takon e drejta për të gjykuar njeriun". Kjo ide biblike e rimarrë nga Tolstoi në formën e një epigrafi për kryeveprën e tij: "Ana Karenina" (1878), rezulton të ketë qenë shqetësim edhe për Dostojevskin. Ai e kishte filluar shtetimin letrar të saj mirëfilli, që në vitin 1866, kur botoi romanin "Krim e ndëshkim", për ta përfunduar në vitin 1880, kur botoi romanin e fundit të tij: "Vëllezërit Karamazov", 2 vjet pasi Tolstoi e kishte botuar "Ana Karenina" (1878).

Ndryshe nga Tolstoi (ky Car i letërsisë së kohës), i cili çështjen e lirisë dhe të së drejtës për gjykim e sheh në këndvështrimin teocentrik, Dostojevski (ky punëtor i dijes), çështjen e lirisë dhe të së drejtës për gjykim e sheh në këndvështrimin antropocentrik. Përtej vlerësimeve individuale (subjektive) për njërin apo tjetrin kollos të letërsisë ruse dhe më gjerë, botërore, në lidhje me idenë, të tërheq fakti i figurës së letërsisë ruse si një sistem komunikimi ndërvetor (autorial) i ideve universal të lirisë dhe të drejtës për gjykim.

2-Njeriu në antikitet

Kjo është periudha e parë e "studimit" të njeriut, gjë që bëhet nëpërmjet përshkrimit të raporteve të tij me një rend teokratik, i konsideruar ky si objektiv, kundër të cilit njeriu antik është i pafuqishëm të ngrihet. Është ky rend objektiv që determinon gjithë sjelljen njerëzore në mënyrë fatale. Çdo përpjekje e njeriut për ta kundërshtuar atë dënohet rëndë nga vullneti hyjnor, në mënyrë të pakthyesher. Edhe pse dikur kufijtë e kontaktit ndërmjet njerëzve dhe hyjnive liberalizohen, kufijtë ndërmjet qenieve mbeten të pakpërxyshëm. Kjo pakpërxyshmëri në të dy kahët e saj dëshmon inferioritetin e qenies njerëzore në përputhje me rendin hierarkik: njerëzve u ndalohet të pretendojnë statusin hyjnor, nga ana tjetër është turp për perënditë të bien në nivelin e njerëzve. Në këtë aspekt xhelozia e hyjnive është konstante. Në universin mitologjik do të ndihen pafundësisht rënkimet e heronjve kurajozë dhe të pabindur ndaj vullnetit hyjnor.

Në përputhje me kufijtë objektivë ndërmjet qenieve (njerëzve dhe hyjnive) do të ketë heronj që s'do të dalin nga mitologjia dhe në këtë mënyrë nuk do të strukturohen në letërsinë antike, ashtu sikurse do të ketë heronj të mitologjisë që do të dalin prej saj për t'u strukturuar në letërsinë antike me të vetmin mesazh për t'i komunikuar Polisit: pacënueshmërinë e rendit objektiv. Të tillë heronj janë: Prometeu, Sizifi, Tantal, Edipi, etj. Skena të ardhura nga mitologjia në mënyrë të përpunuar në letërsinë antike, si ato të Klitemnestrës, Orestit, Medeas dhe të tjera të ngjashme me to, edhe pse janë pamje nga nëndheu, (iracionalja), shkaktohen nga raporte me hyjnitë, gjë që e përforcon idenë e rendit përcaktues objektiv.

Gjithsesi, sensi i historisë është progresiv dhe në një mënyrë apo në një tjetër ai do të manifestohet nëpërmjet shenjash të sigurta. Njëra prej këtyre shenjave është qëndrimi i njeriut ndaj fatalitetit. Sa më shumë Edipi e kupton se e shkuara e tij ka qenë fatalisht e përcaktuar nga hyjnitë dhe po e tillë është

"Krim e ndëshkim", 1866 dhe "Vëllezërit Karamazov", 1880

LIRIA SI NJË FAKT HOMOCENTRIK NË DY VEPRA TË DOSTOJEVSKIT

Nga Skënder KARRIQI

dhe e ardhmja e tij, aq më tepër ai lufton ndaj këtij fataliteti. Sigurisht ky pasion i luftës së tij ndaj fatalitetit, i cili është një standart i ri, ka mundësuar daljen e tij nga mitologjia, për t'u strukturuar akoma më heroikisht në letërsinë antike dhe shekuj më vonë si arketip i varianteve psikanalitike të njeriut. Shënjtë tjetër është humanizmi i letërsisë antike, në kuptimin e penelatave të para të portretit pozitiv të njeriut, çka duket në vargjet e korit të tragjedisë "Antigona":

*Në natyrë ka shumë fuqi të mrekullueshme,
por nuk ka fuqi më të madhe se njeriu*

Në fazën e fundit të saj drama antike greke, në lidhje me njeriun, është e mbarsur nga doktrina sofiste e cila atakoi dhe hodhi poshtë parimin themelor të etikës së Polisit, sipas së cilës individit interesat e tij ua nënshtronte interesave të Polisit. Në fakt sofistët e shpallën njeriun si kategori sociale të pavarur, i cili i kundërvihet Polisit me norma morale individuale. Ide të tilla do t'i gjejmë më vonë të strukturuara në periudhën e vetafirmimit të njeriut, në Rilindjen Evropiane dhe akoma më vonë, në erën moderne individualiste, që përkon kalendari kisht me gjysmën e dytë të shek XIX dhe përgjatë shekullit XX, ndërsa kulturalisht përkon me konceptimin dhe zbulimin e veprës së Dostojevskit e, për më tej, me referimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë ndaj saj, deri sa arrihet në një sistem idesh filozofike mbi njeriun dhe lirinë e tij, të pagzuar me emrin *Egzistencializëm*, përcjellës i së cilit, në një masë të konsiderueshme ishte edhe vepra letrare artistike.

3- Njeriu gjatë Mesjetës dhe Rilindjes

Në fushën e letërsisë artistike ishte Lukiani ai që asgjësoi përfundimisht në aspektin moral Fenë Olimpikë, por njeriu akoma s'kishte arritur "suksese" të atilla, sa për t'i kënduar kultit të vetvetes në vetafirmim

e sipër. Në këto rrethana Krishterimi do të gjente terren të përshtatshëm për t'u përhapur. Përgjatë Mesjetës ideologjia e krishterë sundonte në mbarë Evropën. Etërit e Kishës do ta përpunonin Doktrinën e Krishterë si në nivele divulgative, ashtu edhe në nivele të sofistikuara teologjike. Kështu në Evropë do të ngjizet ndërgjegjja e kristiane.

Shën Agustini ka një rol të madh në teorizimin e nocionit të lirisë kristiane. Ai i mësonte njerëzit mbi ekzistencën e dy llojeve të lirisë: *libertas minor* dhe *libertas major*. Liria e vogël, sipas tij, është liria e zgjedhjes të së mirës dhe të së keqes, ndërsa liria e madhe është liria për të mirën, për të vërtetën. Shën Agustini predikonte lirinë e madhe, të cilën e shihte të shkëputur nga liria e vogël. Në këtë mënyrë ai e racionalizoi lirinë për të mirën dhe të vërtetën, duke arritur tek doktrina e paracaktimit të saj, çka do të thotë se njerëzit detyroheshin në zgjedhjen e së mirës dhe së vërtetës. Pasojat ishin turrat e inkuizicionit gjatë përndjekjes së heretikëve.

Paracaktimi i së mirës dhe së vërtetës bëhej në emër të shpëtimit të shpirtit në botën tjetër, çka solli në mënyrë të pashmangshme distancimin e njeriut nga bota e brendshme shpirtërore. Paradoksalisht ky distancim bëhet nga sfera kishtarë, duke e çuar shpirtin e njeriut nga brenda tij, jashtë tij, larg, në transhendecë, përtej përvojës shqisore dhe njohëse të njeriut. Në emër të kësaj transhendence, përgjatë jetës së tij njeriu duhet ta ndrydhte shpirtin, të distancohej prej tij në mënyrë të detyruar.

Dante Aligeri në kryeveprën e tij "Komedija Hyjnore" ka dhënë një pasqyrë besnike, të detajuar, të raporteve të njeriut të Mesjetës me një rend objektiv të paracaktuar, sipas të cilit do të përshkohet historia e përsosjes morale të njerëzimit. Ferri, Purgatori, Parajsa, Zoti dhe Djalli janë realitetet jashtë njeriut, të cilat në formën e nje rendi kozmik, rëndojnë mbi njeriun. I lodhur nga pesha e këtij rendi kozmik hierarkik, ku njeriu ishte një qenie




e vogël, dikur, në kushtet e disa "sukseseve" të tij, ai (njeriu) kërkon të vetafirmohet. Kjo është era e humanizmit të Rilindjes, koha kur njeriu ngatërron rrugën, dhe në vend që të zbresë në thellësi të nëndheut të vet, kërkon ta tejkalojë Zotin duke i thurur kult autoportretit të tij pozitiv. Kjo rrugë vetafirmimi, e pagzuar si për ironi me emrin *humanizëm*, ishte rruga e Njeriut-Zot brenda të cilit shkatërrohet si Njeriu, ashtu edhe Zoti. Produkte kulturele, historiko-sociale dhe politike të humanizmit, kuptuar si të tillë, janë mbinjeriu niçean, fashizmi dhe komunizmi. Pikërisht kundër këtij lloji humanizmi pozicionohet Dostojevski duke rivlerësuar Krishterimin, kuptimin mbi njeriun dhe vendin e tij në raport me rendin objektiv.

4- Njeriu në periudhën e Historisë së Re

Për sa i përket kuptimit mbi njeriun, koha mund të ndahet para dhe pas Dostojevskit. Koha pas Dostojevskit është periudha e historisë së re, është koha e apostujve dhe e kampionëve të lirisë, të cilët aq shumë i motivoi Dostojevski me veprën e tij.

Duke u pozicionuar kundër humanizmit që çonte tek kulti i Njeriut-Zot, Dostojevski sjell nëpërmjet letërsisë së tij idenë antropocentrike, sipas së cilës njeriu s'do të ishte protagonisti racionalist i trumbetuar si shpëtimtari i botës, por do të ishte objekti mbi të cilin, sipas natyrës së letërsisë, në mënyrë të vëzhgueshme pra, do të kërkohet, për t'u gjetur dhe bërë i njohur, portreti i vërtetë i tij. Kështu Dostojevski zgjodhi rrugën e mundimeve, por dhe të risisë, pasi për të arritur qëllimin, njohjen dhe portretizimin e vërtetë të njeriut, do t'i duhej të operonte me shenja të reja kuptimore për Lirinë, të Keqen, deri dhe Krishterimin. Ky i fundit rezulton një ideologji dhe praktikë e deformuar, dhe për këtë arsye edhe e gabuar, mbi njeriun dhe njerëzimin, pasi për shkak të selektimit të lirisë së madhe, (liria për të mirën dhe të vërtetën), gjë që çoi në doktrinën e paracaktimit (detyrimit) të së mirës dhe të së vërtetës, degjeneron në teokraci e më pas, nëpërmjet imitimit të modeleve teokratike, në autokraci. Mishërime të këtyre praktikave ishin papët, perandorët, mbretërit, deri dhe udhëheqësit politikë.

Dostojevski e kishte kuptuar se për të zbuluar njeriun, duhet ta shkëputje atë nga rendi objektiv që e shtypte, e ndalonte, e përcaktonte, duke i mohuar esencën hyjnore atij: Lirinë. Në romanet e tij shkëputja nga ky rend objektiv bëhet në formën e refuzimit, rrebelimit, dhe individualizmit të tejskajshëm në emër të lirisë, me të cilën lidhet kuptimi dhe egzistenca e personalitetit. Më tej, për Dostojevskin, njeriu i vetëm me lirinë e tij është një qenie tragjike, sepse liria nuk barazohet me të mirën, nuk është as e mire, as e keqe. Është njeriu që duhet t'i japë kuptim asaj. Ai është përgjegjës për lirinë e vet. Kështu njeriu fiton përmasën e plotë të



personalitetit dhe të dinjitetit. Në të kundërt, në kushtet e mungesës së lirisë, përgjegjësia do të ishte jashtë njeriut, çka nuk pajtohet me logjikën ekzistencialiste fetare dhe aq më pak me logjikën ekzistencialiste ateiste, sipas së cilës, e vetmja qenie përgjegjëse është njeriu.

Për Dostojevskin e keqja e karakterizon njeriun, prandaj ai nuk është ashtu siç lëvdohet nga humanistët. Në kushtet e lirisë që kalon në arbitraritet e keqja e rrezon njeriun, i cili nëpërmjet rrugës së mundimeve mund ta gjejë rrugën e dritës dhe shpëtimit. Kjo është rruga sizifiane e njeriut, rruga e ndëshkimit të pranuar nga vetë ai dhe që i paraprin jetës së re, rruga që ngrihet deri në nivelin kuptimor të një *antropodiceje*, e cila, nëpërmjet veprës së Dostojevskit, vjen tek ne si *autodice*, një shenjë kuptimore ndryshe kjo me humanizmin.

5- Dostojevski për një antropodice (drejtësi njerëzore) si autodice (vetëdrejtësi)

Këndvështrimi i Dostojevskit në lidhje me objektin njeri ishte imanent. Këtu konsiston pika e kthesës që bëri gjeniu rus. Ai pa në thellësi të njeriut të lodhur nga humanizmi racionalist për të bërë pohimin e madh në lidhje me natyrën irracionaliste të tij (njeriut). Racionalja ishte ana e jashtme e njeriut, mbrapa së cilës fshihej edhe liria e dhunuar e tij. Irracionalja ishte nëndheu, shpirti brenda njeriut, jo më në transhendencë, ishte Zoti dhe Dielli. Gjithçka e brendshme ishte liria. Gjithçka e jashtme ishte mungesa e saj. Nga ana tjetër determinimi social i njeriut ishte fakt. Si do të zgjidhej çështja e së drejtës? Mjedisi social ishte sfondi i administruar me rregulla dhe ligje të jashtme për individualitetin, ku drejtësia, si një organizëm juridik shtetëror, merrte përsipër të gjykonte dhe të ndëshkonte nga jashtë, në bazë të së drejtës, individin. Diceja, perëndia e drejtësisë, ishte humanizuar. Ndër të tjera, në botët e trilluara të Dostojevskit, pothuajse në nivelin e një teze të sheshtuar letrarisht, ne vëzhgojmë shembullin se si personazhet, gjegjësisht njerëzit, nuk vëzhgojnë përjetueshmërinë e njeri-tjetrit. Ata mund të orientohen nga shenja të jashtme, të cilave u japin kuptime konvencionale, por informacioni i marrë në këtë rast, nuk ka garancinë absolute të provës. Kur flasim për mungesë të garancisë absolute të provës, kjo është më e pakta, ndërsa shembulli i Raskolnikovit na tregon se prova mund të fshihet dhe të manipulohet deri në asgjësimin e plotë të saj. Kështu, edhe në rastin më të mirë, drejtësisë (Diceja së humanizuar) do t'i mungonte prova, e në mungesë të saj, akordimi i së drejtës është absolutisht i pamundur. Në romanin "Krim e ndëshkim", lexuesi intercepton tezën e drejtësisë së pamundur në kushtet e mungesës apo mundësisë së manipulimit të provave të kimit. Në këto kushte realizimi i së drejtës është pjesë e "nëndheut" të njeriut. Zgjidhja qëndron brenda tij, si pjesë e personalitetit, që zbulohet dhe rritet në kushtet e lirisë, kur në brendësi (thellësi) të qenies, ndeshen e mira me të keqen. Në këtë kuptim ne mund të flasim për një *antropodice*, kuptimi i qartë i së cilës do të ishte imanent. Ndjenja e së drejtës e karakterizon njeriun së brendshmi dhe realizimi i saj s'mund të jetë kurrsesi një çështje jashtë vullnetit të këtij njeriu, që në një çast të ecjes në udhën e lirisë, është në pozitë e atij që gjykohej. Sa më tepër Raskolnikov i mposhtet nga përjetimi i peshës së kimit dhe për këtë shkak bëhet gati të vetëdenoncohet, aq më tepër ai e kupton se hetuesit ishin shumë larg së vërtetës. Dinamika e kahëve të kundërta në këtë rast dëshmon për pamundësinë e

akordimit të së drejtës jashtë njeriut.

Mungesën e garancisë absolute të provës dhe po kështu mundësinë e manipulimit deri në asgjësimin e plotë të saj, Dostojevski e pa edhe në raport me inteligjencën njerëzore, pothuaj në shkallën më të lartë. Për t'u vërtetuar, teza e Dostojevskit duhet ta kalonte edhe këtë provë, nëpërmjet së cilës na bëhet e qartë pozita qesharake e personazhit që e bart dhe e përdor këtë inteligjencë, në raport ky me dinjitetin dhe personalitetin e pavarur të Raskolnikovit, elemente këto që përbëjnë thelbin e përjetueshmërisë së këtij të fundit, ashtu si për çdo njeri. Në fund të fundit Raskolnikov, si punëtor i dijes, duhet të përballej me një sivëllain e tij në aspektin intelektual. Diferencat në këtë aspekt, si shprehje e inferioritetit të Raskolnikovit apo si shprehje e superioritetit të kundërshtarit të tij, do t'u përkisnin rasteve konkrete, të cilat, për shkak se janë të tilla, bëjnë përjashtim nga rregulli apo ligji abstrakt. (Mërsi i Kamysë mendonte se në qoftë se do të kishte qëlluar që avokati i tij, rastësisht do të ishte më inteligjent se prokurori dhe gjykatësi, ai (Mërsoi) do ta kishte fituar të drejtën. Por rastësisht është e kundërta dhe në këto rrethana absurde ai dënohet me vdekje). Eksperimenti i Raskolnikovit në raport me drejtësinë si organizëm juridik shtetëror, ndër të tjera, duhet të vërtetojë parimin e paafësisë së këtij organizmi për të akorduar drejtësi, dhe parimi si i tillë ka karakter abstragues.

Është hetuesi inteligjent, Porfiri Petroviç, i cili, nëpërmjet shenjave dhe induksionit të tyre, arrin tek e vërteta, por edhe kjo e vërtetë është e përjetuar vetëm nga ai, ka natyrë intuitive, është pjesë e nëndheut të tij, pjesë e iracionales dhe në këtë kuptim pa mundësi vëzhgueshmërie, çka duhet të karakterizojë provën e aq më tepër atë me karakter juridik.

Kështu në romanin "Krim e ndëshkim", lexuesi njihet, nëpërmjet fokusimit letrar që u bën autori, me rastet anormale të praktikave të drejtësisë si organizëm juridik shtetëror. Rasti i parë ka të bëjë me

rrethana kur provat janë të pamundura të gjenden, sepse ato mund të fshihen dhe madje të zhduken deri në asgjësim të plotë. Në këtë mënyrë lexuesi në fokusin e vëzhgimit ka kriminelin përballë të cilit janë humanët hetues, që për arsye objektive janë shumë larg perceptimit të provave që do të identifikonin kriminelin e vërtetë. Rasti i dytë ka të bëjë me rrethana kur, në raport me inteligjencën njerëzore, mund të interceptohet krimi, por për shkak se ky interceptim karakterizohet nga mungesa totale e vëzhgueshmërisë, si njohje intuitive që është, dhe në të kundërt, karakterizohet nga përjetueshmëria absolute, sepse për shkak se është njohje intuitive, është dhe iracionale (e brendshme) kjo njohje nuk mund të shërbejë si provë jashtë subjektit që e intercepton. Për arsye të statusit njerëzor (të njëjtë me Raskolnikovin) dhe autoritetit civil, sado e sinqertë të jetë përjetueshmëria e Porfirrit, nuk ngrihet dot në nivelin e provës juridike. Prandaj Porfiri e këshillon Raskolnikovin që ta pranojë vetë krimin dhe ta vërtetojë atë, përkundrejt një dënimi të reduktuar, të çlirohet prej kimit dhe të fillojë një Jetë të Re. Vetëm kështu, sipas Dostojevskit, nga brenda njeriut, shmanget absurdi dhe zgjidhet ngërçi i provës me efekte juridike, për akordimin e drejtësisë. Prandaj, kur flasim për një *antropodice*, për një drejtësi të brendshme, pjesë e *iracionales*, e nëndheut që e karakterizon njeriun, në marrëdhënie me mekanizmin e jashtëm dhe të ftohtë të drejtësisë juridike shtetërore, ajo mund të realizohet vetëm si *autodice*, si vetëdrejtësi dhe kjo, sipas Dostojevskit, është drejtësia e vërtetë, e mundur, e pagabueshme. Padyshim që zgjidhja e problemit në këtë mënyrë ka të bëjë me idenë *antropocentrike* të Dostojevskit, çka përbën dhe risinë e tij në lidhje me rivlerësimin e njeriut, duke i kundërvënë humanizmit racional humanizmin irracional, si toka ku do të kultivohet qenia e denjë, e trumbetuar nga Dostojevski si Zoti-Njeri, në kundërvënien me Njeriun-Zot.

6-Ana tjetër e medaljes

Një njeri (në rastin tonë Raskolnikov) mund ta ketë kryer krimin dhe në kushtet e inteligjencës të arrijë t'i fshehtë provat apo t'i manipulojë ato deri në asgjësim të plotë, e akoma më tej, një njeri tjetër, edhe ky në kushtet e inteligjencës, përkundrejt këtij të parit (në rastin tonë Porfiri Petroviç) nëpërmjet induktimit të shenjave me natyrë jomateriale, mund të arrijë ta interceptojë kriminelin, por për shkak të mungesës së vëzhgueshmërisë së këtij interceptimi me natyrë intuitive dhe përjetueshmëri absolute nga ana e interceptuesit, kurrsesi ai (interceptim) nuk mund të shërbejë si provë, e aq më tepër si provë juridike. Kjo është njëra anë e medaljes.

Ana tjetër e medaljes ka të bëjë me rastin kur njeriu nuk e ka kryer krimin, por rrethana specifike, si njerëzve që janë përreth, edhe hetuesve, u krijojnë iluzionin e provës së sigurt. Mbi bazën e kësaj prove iluzive njeriu, i pafajshëm për një rast konkret, trajtohet si kriminel, nga nivele më të ulta të dënimit deri në ato kapitale. Kemi të bëjmë këtu me rastin e Mitja Karamazovit në romanin "Vëllezërit Karamazov" (1879-1880) nëpërmjet të cilit Dostojevski rimerr çështjen e provës juridike. Me këtë rast ai, si për ta trajtuar në mënyrë të plotë problemin, sjell idenë e pavërtetësisë së provës juridike, e cila për të, në shumë raste është një abstragim racional mbi disa të dhëna dhe rrethana të jashtme, të cilat sado lidhje të kenë me njeriun (në rastin tonë Mitja Karamazov) e karakterizojnë dhe e rrëfejnë atë së jashtmi, duke mos arritur kështu të zbulojnë thelbin e tij. Në qoftë se në rastin e parë (rasti i Raskolnikovit) zgjidhja ishte imanente, brenda personazhit, dhe vinte si rezultat i dinamikës së kësaj imanence, rasti i dytë është në thelb krejtësisht përjashtues dhe antinjerëzor, sepse duke mos arritur ta njohë, mohon thelbin e njeriut, shpirtin, imanencën, lirinë e tij. Sigurisht, për hir të një analize racionale, e cila si e tillë përjashton gjithçka iracionale tek njeriu, ky i fundit, (në rastin tonë Mitja Karamazov), s'mund ta quajë veten fajtor për rastin e fajit konkret (vrasjen e Fjodor Karamazovit) dhe rrjedhimisht nuk do të pajtohet me dënimin. Perspektiva e tij, e sheshtuar në planin e arratisjes dhe mënyrën se si do të jetonte e mbante lidhje me Rusinë, është perspektiva e njeriut të cilit tash e mbrapa i duhet të jetojë i përzënë dhe i ndjekur nga shoqëria, i fshehur prej saj duke ndërruar elementet formalë të identitetit (anën e jashtme) por kurrë thelbin e tij (faktin që është rus dhe Karamazov), është perspektiva e njeriut që është i huaj për ligjin racional juridik shtetëror, për shkak të paafësisë së këtij ligji të depërtojë në imanencën e njeriut, sepse është një ligj i hartuar nga mendja *euklidiane* dhe si i tillë i mungon përmasa e thellësisë (irracionalja).

Me romanin "Krim e ndëshkim", botuar në vitin 1866 dhe romanin "Vëllezërit Karamazov", botuar në vitin 1880, Dostojevski, siç e argumentuam më lart, ndër të tjera, thelbin e njeriut, lirinë e tij, e shëh në raport edhe me drejtësinë si organizëm shtetëror juridik, e cila, si produkt i mendjes racionaliste njerëzore, nuk është drejtësi (si e tillë), pikërisht për shkak të kufizimeve të asaj që e prodhon atë: mendjes njerëzore. (rasti i tragjedisë dhe i komedisë) E parë kjo marrëdhënie njeri-shtet në të dyja anët e medaljes, përkatësisht në dy romanet e përmendura më lart, pavarësisht distancës kohore prej 14 vjetësh të botimit të tyre (1866-1880) vjen tek ne si një lidhje përmbajtësore ndërmjet dy veprave, në ngjashmëri me romanet *a thèse*. Në këtë aspekt këto dy vepra do të strukturohen tek pasardhësit modernistë në shekullin XX dhe më dukshëm tek Kamy, sidomos në romanin "I huaji".



Botimi i ri në gjermanisht “Die Stadt der Äpfel” i Luljeta Lleshanakut shpallet në dhjetë librat e rekomanduar me poezi të autorëve të huaj nga Deutsche Akademie für Sprache und Dichtun

Sipas një tradite të filluar vite më parë, Deutsche Akademie für Sprache und Dichtun (Akademia Gjermane për Gjuhën dhe Poezinë), në një deklaratë për shtyp në muajin mars, shpalli listën e librave të rekomanduar për vitin 2022. Nga botimet e reja u përzgjedhën 20 vëllime me poezi nga fillimi i vitit 2021 deri në mars 2022, ndër ta: 10 libra të autorëve gjermanë dhe 10 libra të autorëve të huaj të përkthyer në gjermanisht. “Të mrekullueshëm, emocionues dhe befasues”- cilësohen në njoftimin për shtyp. Rekomandimet e këtij viti vijnë nga një juri e përbërë nga: Nico Bleutge, Nora Bossong, Marie Luise Knott, Kristina Mardt-Zinke, Christian Metz, Marion Poschmann, Kerstin Preiëuß, Joachim Sartorius, Daniela Strigl dhe Norbert Wehr. Midis dhjetë librave të rekomanduar, të përkthyer në gjermanisht, është edhe libri “Die Stadt der Äpfel” i Luljeta Lleshanakut, përkthyer nga Andrea Grill.

Rekomandimet për poezinë publikohen çdo vit në muajin mars; ato janë një projekt i përbashkët i Akademisë Gjermane për Gjuhën dhe Poezinë, Stiftung Lyrik Kabinett, Haus für Poesie, Shoqatës Gjermane të Bibliotekave dhe Fondit Gjerman të Letërsisë.

Për Ditën Botërore të Poezisë më 21 Mars, vëllimet e rekomanduara u prezantuan në mbi 260 librari dhe biblioteka. Pas kësaj, autorët ftohen për prezantime individuale të librave të tyre dhe ture leximesh.

“Die Stadt der Äpfel” u botua nga Hanser Literaturerlage në tetor të vitit 2021. Botuesi, në vlerësimin e tij, shprehet se “Luljeta Lleshanaku është një nga zërat më influencues në poezinë e re të Europës Lindore”. Deri tani, libri është prezantuar nga autorja dhe përkthyesja Andrea Grill në një seri eventesh publike në Gjermani, Austri dhe së shpejti do të prezantohet edhe në Zvicër.

Luljeta Lleshanaku Die Stadt der Äpfel



Gedichte

AUS DEM ALBANISCHEN
VON ANDREA GRILL

EDITION LYRIK KABINETT
BEI HANSER

Poezi për artistët në vëllimin “Love” të autorit Skënder Sherifi

nga Dr. Gëzim Puka

Ndërsa lexoja poezitë e vëllimit me poezi “Love” të shkrimtarit Skënder Sherifi, m’u kujtua një thënie e studiuesit Roland Barthes në librin e tij “Aventura semiologjike”. Ky studiues i njohur, duke trajtuar stilin si mjeshtëri, pohon se një klasë e tërë shkrimtarësh të vendosur që ta marrin mbi vete tërësisht përgjegjësinë ndaj traditës, do ta zëvendësojnë vlerë-përdorim të shkrimit me një vlerë-punë. Shkrimi do të shpëtohet jo në sajë të qëllimit të tij, por në sajë të punës që ka kushtuar. Atëherë fillon të përpunohet një përfytyrim për shkrimtarin artizan, i cili mbyllet në një vend legjendar, si punëtori në dhomë, gdhend, pret e pastron formën e vet, pikërisht si gurgdhendësi që e nxjerr artin nga materia, duke kaluar në këto punë orë të tëra vetmie dhe përpjekjeje. Një autor si Skënder Sherifi mendoj se është pjesë e një lloji “esnafi” letrar, ku punimi i formës përbën shenjën dhe veçorinë e kësaj shtrese “artizane” intelektuale.

Poezia “Portret” që përshkruan një artist ose një personalitet të madh intelektual përbën një tipologji poetike, e cila riafirmohet nga Sherifi në epokën tonë postmoderne si një përfundim i kremit romantik të gjeniut dhe të heroit. Bëhet fjalë për një lloj poezie e cila edhe pse nuk praktikohet gjësisht ka jehonë. Të bën

përshtypje se një pjesë e poezive të “Love” i përkasin kësaj tipologjie poezie. Vargjet vijnë në një hark kohor dhe në një hapësirë kronologjike shumë të gjerë dhe së bashku kanë si rezultat disa tipare të veçanta, në mënyrë që të bëjmë portretizimet e këtyre artistëve. Teksti poetik i Sherifit do të lëvizë në kahjen e karakterizimit të “poezisë për artistin”, në rrenjë historike dhe motivimet estetike.

Le të ndërmendim disa vargje nga poezitë me titujt e tyre të veçantë:

“Jennifer Lopez (II)”, “E qeshura shijon si bajame karremi...”


Do të ketë ardhje e riardhje në luginën e luleve plot all,
pamja jote një pikturë e bukur nën gushën që pret”.

“Nicole Kidman II”, “Leshverdhja trëndelinë që mbjell ekstaza gjithandej,
Nuk ka rëndësi muzika, nëse muzikanti të përkëdhel.”

“Claudia Cardinale II”, “Bukuria jote zgjohet në historinë e gjërave të pathëna
Ku shkëlqejnë kujtimet tona,
Mes çekanit dhe gozhdëve të lëna.”

“Monica Vitti III”,
“O Monica: e dua të gjithë misterin tënd
... pa shpirtin tënd thuajma mos është gjë si shumë”

“Lucia Bose IV”, “... Ti je gjithë Italia!



Ti ke shkëlqimin e Venecias, dritën e Parisit.”

“Zemra të kryqëzuara (n.66), Greta Garbo I”, “Ti shpalos flokët dhe unë shpalos qenien

Hija dhe drita e jetës sime grinden erotit pafund

Albatros i Albanisë: ti më përshkon të gjithin me rreze,”

“Marlène Dietrich II”, “Ti ndryshon ashtu sikurse dunat, megjithëse peizazhi mbetet”

“Rita Hayworth IV”, “Ti hiqje dorezat e tua të zeza si një dhëlpëruse e vjetër.”

“Uma Thurman II”, “Ti je agimi i lulëzuar në Gizë”

“Elisabeth Taylor IV”, “Princeshë rebele,”

“Meryl Streep VI”, “Magji engjëjsh shpëtimtarë, gati për të bërë mirë.”

“Penelope Cruz II”, “Si një yll që shndrit për një kohë të gjatë

Ndriçoi jetën time që të të dua i mahnitur”.

“Asia Argento V”, “Çdo ditë ti rinovon imazhin e një mirësie,” etj.

Hetimi i këtyre poezive të dokumentuara dhe të një stili të lartë e bëjnë këtë poet që në mënyrë legjitime të marrë statusin e poetit të ëmbël, i cili na zbulon një rrugëtim të privilegjuar për të kuptuar poetikën e tij. Praktika e përshkrimit të një artisti në një vepër arti është e lidhur ngushtësisht me një dukuri estetike që karakterizon epokën moderne dhe është reflektimi mbi artin. Interesi për figurën e artistit nuk kufizohet vetëm në idealizimin apo trillimin e personazheve që i përkasin fantazisë autoriale, por nganjëherë është zgjedhur të jetë vetë biografia e artistëve, të cilët në të vërtetë ekzistojnë dhe kanë ekzistuar. Poeti na paraqet artistin me tiparet e gjenit individual, i vënë në kundërshti me botën e vogla banale dhe prozaikë. Kulti i gjenit artist ka qenë një nga trashëgimitë më të vazhdueshme të romantizmit. Kërkimi i një referenti letrar të dallueshëm apo një alternative, siç është portreti i artistit, përmes poezisë që ka në domethënien e vet përsosmërinë individuale, kontribuon në identifikimin dhe ekzaltimin e këtyre figurave. Në qoftë se në estetikën e klasicizmit, perfeksionizmi i kodit ishte prioritet dhe krijimi personal ishte i tëri në përputhje me respektin ndaj vlerave e modeleve, në estetikën romantike personaliteti i artistit vlen më shumë se kodi gjuhësor me të cilin ai shprehet, nga kjo merr vlerë rritja e individualitetit artistik të poetit. Portretin e artistit e gjen të shprehur shpesh edhe në prozë, por në poezi, siç është ajo e Skender Sherifit, e tërë ekzistenca e artistit mund të jetë shtrirë në një skenë ose në një situatë të veçantë. Individualiteti i papërsëritshëm dhe i përzgjedhur është një pikë e thjeshtë fillestare për konsiderata të natyrës poetike dhe ekzistenciale. Një vlerësim i ngjashëm mund të shprehet me shumë arsye për poezitë portret, që u kushtohen njerëzve të mëdhenj të artit, që janë njerëz të guximit, të veprimit, por edhe të meditimit. Falë specifikimit ligjërimor poetik të Sherifit, që është i aftë të ushqejë fjalën nga kjo tokë e mirë dhe prodhimtare, vijnë këto vargje për artistët. Individët artistë që përzgjedh poeti nuk varen prej peizazhit, por varen humusi që ushqen rrënjët. Portretet e artistëve në poezinë e Sherifit vendosen mbi pafundësinë e kozmosit dhe vrojtohen si një moment epifanie. Artisti shfaqet paradoksalisht si çelësi i portretit universal njerëzor. Po e përfundoj me Barthesin duke e cituar atë në koherencë me tekstin e Skënder Sherifit: “Poezia zë një pozicion të kundërt me mitin. Miti është një sistem semiologjik që pretendon të kalojë në sistem faktik, ndërsa poezia është një sistem semiologjik që pretendon të tërhiqet në sistemin thelbësor. Këto mite faktike të artistëve të përbotshëm të skenës dhe ekranit, të cilët ekzistojnë në mendjet e lexuesve, përmes poezive të Skënder Sherifit, lënë më shumë gjurmë të qenien tonë.

Kur boton Ridvan Dibra, unë zbatoj një rregull personal: ai libër duhet lexuar menjëherë, para se të ftohet letra e dalë nga shtypi. Që nga koha e njohjes sime me këtë autor, vjetrimin ia pëlqej në kujtesë a rilexim, kurrë në shtyrje të leximit të parë pas botimit.

Romani i fundit i Profesor Dibrës, “Gruaja që deshe”, edhe pse roman për nga struktura, në thelbin e vet i ngjan esesë. Herë-herë i ngjan një studimi që ka tendenca për nga romani ku rregullat thyhen butësisht. Pena e Dibrës ka qenë përherë e butë, por këtë herë rreket të jetë e lehtë si pupël, sa më larg banales së përditshmërisë e në të njëjtën kohë larg ekstremeve të ngjarjeve tronditëse dhe të papriturave dramatike. Tingëllon si një nga ato fjalitë e stisura, por jo, është e vërtetë dhe është një balancë e hollë. Një balancë e arritur me shumë mund, me anë të ndërthurjes së zërit të personazhit-autor, që do të kalojë me lexuesin një natë të plotë pa gjumë pranë një vatre, duke kujtuar historinë e tij të dashurisë. Subjekti është veç kaq. Autori ndez oxhakun e shtëpisë, shtriqet dhe ngrohet ndanë tij dhe kujton veten në raport me gruan që i jep emrin romanit. Nga ana tjetër, gruaja-objekt studimi, është edhe personazh real/i gjallë. Ajo i afrohet disa herë e rreket ta bindë që ta shoqërojë në shtrat e të flejë, por burri i shkon deri në fund - ai kujton e analizon, dhe ne vëzhgojmë me të. Gruaja hyn e del disa herë, deri në agim.

Një lexim sipërfaqësor do të perceptonte veç një histori martese të lumtur: përtej kësaj teksti rreket të na japë një studim të vetes pasqyruar në këtë histori dashurie dhe partneriteti, një studim të psikikës së vetes si shkrimtar, si ndërtesues të vetes në raport me botën, por disi rrëshqanthi, si të mos dëshirojë të ngecë veç aty. Dibra synon përmes vetes të prekë universalen, synim ky që kur vepra tingëllon si autobiografi, duket pothuaj e pamundur. Zëri i narratorit në vetë të dytë i jep natyrë akoma më analitike - personazhi autor është burrë, është bashkëshort, është i penduar, është prind, ëndërrimtar e idealist, vëzhgues dhe në fund, tmerrësisht i zakonitë. I lumtur pafundësisht në të qenurit i tillë, falënderues dhe në paqe me veten, por gjithnjë analitik. Gjithnjë i shqetësuar, një sëmundje që e kanë me gjasë të gjithë shkrimtarët.

Elementi thelbësor i romanit është Oxhaku. Dibra i pëlqen shumë elementet e tilla dhe i vendos pothuaj përherë në qendër të prozës së tij.

Po çfarë është Oxhaku?

Burri e adhuron këtë objekt jo të gjallë, pranë tij ndihet mirë, në kontroll, ndihet se mund të analizojë lirisht veten në tri situata, si bashkëshort, si lexues e si shkrimtar. Janë tre role që personazhi i shijon në mënyra të ndryshme e në mes qëndron Oxhaku, vatra që metaforikisht herë ngjan si shpirti i familjes, herë si zjarri simbol i dëshirës për të jetuar e përjetuar fuqimisht çdo aspekt të jetës. Në dy krahët e Oxhakut qëndron biblioteka, ndarë në mes prej tij, ku librat siç na rrëfëhet, ndahen në dy rryma, modernë dhe klasikë. Gati në luftë mes tyre janë librat, ashtu si gati në luftë mes tyre janë dhe tre elementet që ndërtohen: Oxhaku i ndezur, Gruaja

“GRUAJA QË DESHE” OSE “ROMANI QË DESHE”

Adela RADOVANI

Nga shënimet e një lexueseje

që deshi dhe do akoma, dhe Fshati, një element i vjetër, i një romani tjetër, që sidoqoftë shpjegohet edhe për ata që nuk e kanë lexuar “Gjumin mbi bore”.


Në fund të një analize kaq të thellë, cili element mbart peshën kryesore në jetën e një burri që çdo gjë e këqyr nën mikroskop? Cilin do të caktojme si parësor për nga rëndësia, gruan, librat apo Fshatin që i ndryshoi jetën? Shumë gjëra nuk mund të dihen.

“Ku me e ditë?”, përsërit si lajtmotiv autori.

Lexuesi do të zgjedhë atë që i pëlqen atij më tepër. Vepra qëndron deri në fund e hapur dhe bashkëbiseduese, e sidomos nxitëse për vetë-reflektim. Një romantike si unë, për shembull, do të thoshte se ishte gruaja e para, një realist

do të thoshte librat dhe e vërtetë do jetë me gjasë Fshati, që pothuaj i merr jetën autorit-personazh. E të vdesësh nuk është gjë e vogël.

“Gruaja që deshe” mund të lexohet edhe si “Romani që deshe”, ndërsa shtresat kuptimore ngatërrohen, me qëllim e ndonjëherë edhe pa qëllim. Është një lexim i lirshëm dhe frymëzues. Mund të quhej dhe “Romani që deshe”, por edhe “Romani që nuk e lexuam dot”, “Romanet që i lamë në mes”, “Romanet që nuk u shkruan kurrë”. Një lexim, i cili atyre që e kanë leximin mënyrë jetese, ua lehtëson paksa barrën dhe presionin për sensacionin e radhës. Po, ka mundësi që gjërat të mos jenë gjithnjë dramatike. Ndonjëherë jeta mund të jetë e lehtë.



Që në vitin 1982 në Maqedoni kishte nisur të përhapej një ide e çuditshme, sipas së cilës, shqiptarët duhej t'i përdornin toponimet maqedonisht. Domethënë, tash e mbrapa emri Shkup-i do të quhej Skopje, Dibra – Debar, Tetova – Tetovo, Kërçova – Kiçevo e kështu me radhë. Kalonin vite që gazetata, radioja e televizioni i Shkupit s'pushonin së shkruari e së foluri për këtë temë që, se vinte, bëhej më e nxehtë. Nuk duhej shumë kohë që kundërshtimi i shqiptarëve të quhej nacionalizëm.

(Kjo valë sulmi kundër shqiptarëve nuk ishte e rastit. Ajo vinte menjëherë pas demonstratave të Prishtinës në vitin 1981. Dhe, si të ishte e thënë, kurdo që Serbia hapte ndonjë plagë në Kosovë, kurdo që ajo i trazonte marrëdhëniet aty, ky acarim do të fillonte edhe në Maqedoni me të qena e të paqena. As kësaj radhe nuk bëri përjashtim.) Idenë e marrë për ndryshimin e toponimeve shqipe e hodhi një njeri, të cilit nuk mund t'i thoshe budalla, por që e kishte një damar marrëzie – e kishte. Këtë s'e luante topi. T'i thoshe i paditur një njeriu me shkollë, për më tepër atij që pret të bëhet doktor shkencash, këtë s'e thoshe dot. Pastaj, ky njeri me dell marrëzie ishte njëfarë politikani në Maqedoni – ja deputet, ja zëvendësministër. Në këtë hierarki ndoshta kishte arritur duke u mbajtur një herë shqiptar, pastaj turk dhe më në fund maqedonas! Sidoqoftë, ky mistrec-skilipeç, me shtat në shtat (nuk po ia përmendim emrin jo vetëm sepse tanimë ai e ka mbështetur brinjën, por që të mos ua quajmë faj marrëzinë e tij fëmijëve), e pra ky mistrec-skilipeç pothuaj s'kishte ditë që nuk futej në ndonjë mbledhje të organizatave politike e arsimore dhe, vend e pa vend, fliste kundër atyre që e kundërshtonin idenë e tij (ne nuk mund ta dimë nëse këtë ide ia kishte pjellë mendja, apo atë ia kishte futur aty politika). Në mos në mbledhje, ai do të fliste në konferenca shtypi.

Ideja nisi të realizohej dita-ditës. Në të vërtetë ajo s'kishte si të realizohej, sepse nuk kishte asnjë mundësi të sendërtohej, por filloi të pranohej, të çante përpara si urdhër. Të parët që e përqafuan ishin emisionet shqipe të RTM-së (të radios e të televizionit të Maqedonisë), ndonëse në kundërshtim me mendimin e gazetarëve të këtyre dy redaksive. Në televizion toponimet u ndryshuan pas ndërrimit të redaktorit përgjegjës të këtij emisioni, Menduh Ajdinit, që ishte një gazetar me përvojë të madhe dhe me dinjitet. Aty shumë i interesuar për ndërrimin e toponimeve ishte drejtori i përgjithshëm i RTM-së. Menjëherë pas largimit të Menduh Ajdinit, sakaq filluan të përdoren toponimet e mistrecit. Pastaj filluan në administratën republikane, aty ku ajo përktente shqip tekste të ndryshme. Një nga një pasuan vendimet e këshillave komunale të Tetovës, Gostivarit, Dibrës, Strugës, Kërçovës etj., që të gjitha në kundërshtim të madh me mendimin e qytetarëve. Në asnjë letër zyrtare toponimet nuk shkruheshin më në trajtën shqipe. Sesi kishin arritur t'i ndërronin toponimet, këtë e dinin vetëm ata që i kishin ndryshuar, megjithëse edhe ata s'dinin gjë prej gjëje. Zbatimi i këtij urdhri u ndoq me masa përjashtimi nga puna të disa arsimtarëve.

Siç mund të merret me mend, urdhri për ndryshimin e toponimeve, po na sillte rrotull edhe neve në Redaksinë "Flaka e vëllazërimit". Në shumë mjete të informimit – në radio, në televizion, madje edhe në dy gazetata e përditshme maqedonase të Shtëpisë së madhe gazetare-botuese "Nova Makedonija", ku bënim pjesë edhe ne, na sulmonin që nuk i ndërronim toponimet. Në Redaksinë "Flaka e vëllazërimit" asokohe botohej gazeta me këtë emër, që dilte tri herë në javë (në pritje të bëhej e përditshme), pastaj revista për shkencë e kulturë "Jehona", dy revista për nxënësit e tetëvjeçares – "Fatosi" dhe "Gëzimi" (me një tirazh dhjetëra mijë kopjesh) dhe zhvillohej një veprimtari botuese me rreth 15 libra në vit.

Drejtori, që qëndronte në krye të të gjitha botimeve të kësaj shtëpie, pra edhe në krye të redaksisë sonë, nuk na e kishte përmendur këtë punë. As ne nuk ia kishim zënë në gojë. Një ditë vendosa ta bisedoja me të çshtjen (atëherë isha në postin e kryeredaktorit). Lamë një takim, pasi ai u pajtua se biseda do të zgjaste disa orë. Një ditë u poqëm.

Batakçillëku me toponimet Vetëmbrojtja e shqipes

nga Rexhep Zllatku

Drejtori porositi dy kafe dhe m'u drejtua

- Hë de, më trego.

E njoftova shkurtimisht.

- Le të themi disa çështje parimore para se ta zbërthejmë problemin. Së pari dua të të them se kjo nismë është shumë e dëmshme për marrëdhëniet ndërnacionale, por, për fat, është e pazbatueshme. Unë mendoj se s'ka njeri që di të thotë se si duhet të ndërrohen toponimet. Së dyti, këtë s'e lejon gjuha shqipe. Së treti, atë s'duan ta zbatojnë shqiptarët. Unë nuk kam dëgjuar që diku në botë është zbatuar një gjë e tillë. Këtë nuk e kanë bërë as regjimet totalitare. Sa e di, nuk e ka bërë as Shqipëria e Enver Hoxhës me maqedonasit e atjeshëm, pa marrë parasysh numrin e tyre të vogël. Pastaj, duhet të jetë e qartë se Maqedonia nuk mund të vendosë gjë për gjuhën shqipe. Në kompetencë të saj janë përmasat e përdorimit të shqipes në administratë, në shkolla, institucione etj. Por, në gjuhën shqipe ajo s'mund të vërë asnjë presje. Për gjuhën shqipe mund të vendosë vetëm shteti shqiptar. Këtë të drejtë, për më tepër, nuk e kemi as ne pjesëtarët e minoritetit shqiptar në Maqedoni. Ne mund të japim kontribute, propozime, por nuk mund të vendosim.

(Duke qenë se kjo e keqe një ditë do të trokiste në portën e redaksisë sonë, unë, që në fillim, iu vura leximit të literaturës përkatëse. Së pari lexova Gramatikën e Bllazhe Koneskit, babait të gjuhës letrare maqedonase, redaktorit të Fjalorit të parë të maqedonishtes. Lexova botime të ndryshme që kishin të bënin me këtë temë. Bisedova me shumë gjuhëtarë. Më në fund, m'u mbush mendja t'i drejtohesha vetë shqipes! Mbase ajo do të vetëmbrohej, mbase do të na mbronte edhe ne. Atëherë i shkova pas gurrës, natyrës së saj. Por, njëkohësisht, shkrova në kokë disa fjalë me të cilat do ta njoftoja drejtorin kur të vinte çasti i duhur: "Jam i detyruar të heq dorë nga posti i kryeredaktorit pas urdhrorit për ndërrimin e toponimeve. Së pari – unë nuk mund ta bëj këtë gjë, së dyti – nuk di ta bëj dhe, së treti – nuk dua ta bëj. Ju falem nderit për bashkëpunimin dhe qëndrimin tuaj korrekt të derisotëm. Ngaherë do t'ju kujtoj si mjeshtër të vërtetë të profesionit tonë dhe si njerëz me dinjitet").

-Nuk e di. vazhdova t'i flitja drejtorit, pse nuk bëjmë krahasime me maqedonishten. Ju vetë e quani Beogradin Bellgrad, Romën Rim, Selanikun (Thessaloniki) Solun... Përse nuk pi ujë ky krahasim. Mbase që të shkojë inati në vend, që toponimet shqipe të ndërrohen patjetër. E di se kush i prin kësaj propozicie? - i thashë duke ia përmendur emrin e intrigantit.

-Lëre atë, ai është budalla!- tha drejtori.

Fillova të qeshja.

-Ti tani, tani që ka ardhur në Shkup, e ke parë se është i kokatur. Unë kam pasur rastin ta njoh qëmoti.

E di që nuk është tamam. Ai është nga fshatrat e Dibrës dhe një kohë punonte aty.

Tërë qyteti e dinte se ishte pak i krisur. Këtë e dinin deri edhe fëmijët. Ndaj, kur dilte në rrugën kryesore të qytetit, ata e ngarronin, i bërtisnin dhe e sillnin vërdallë tutje-tëhu duke i fishkëlyer, ndërsa ai bërtiste si i çartur. Me gjasë, tani do ta shpalojë e ta nxjerrë mllëfin e dikurshëm.

Ti thua është budalla. Unë pajtohem me ty, porse realiteti është ndryshe. Ai budalla ka qenë në disa funksione shoqërore, ka qenë deputet i Kuvendit të Maqedonisë, sot është zëvendësministër i arsimit. Ai po plas nga inati

që nuk është në gjendje që edhe neve, ashtu si ua ka bërë shkollave shqipe, të na dërgojë një letër e të na urdhërojë t'i ndërrojmë toponimet. Letrën ne do t'ia hidhnim, sepse nuk ka të drejtë t'i drejtohet e ta urdhërojë një redaksi.

Drejtori herë-herë po qeshte.

-Tani, - vazhdova unë, le ta marrim punën nga ana praktike për të parë që kjo gjë s'mund të bëhet kurrsesi, përveçse në mendjen e atyre që e dëshirojnë. Le të marrim si shembuj emrat e disa qyteteve të Maqedonisë: Shkup, Tetovë, Dibrë... Gjëja e parë në të cilën do të pengohen e do të thyejnë qafën këta sharlatanë është shquarja e emrave të përveçëm.

Drejtori hapi sytë. -Si? Si shqueshkan emrat e përveçëm?

-Po, në gjuhën shqipe shquhen të gjithë emrat, të përveçëm e të përgjithshëm. Tani dalim në pengesën e parë, që s'di njeri si t'ia bëjë. Maqedonishtja, sikurse serbishtja, nuk e njih shquarjen e emrave të përveçëm. Në gjuhën shqipe, emri Shkup, si emër i përveçëm, është në trajtën e pashquar, ndërsa në të shquarën del Shkupi. Emrat e përveçëm në gjuhën shqipe përdoren më shumë në trajtën e shquar. Kjo është, si të themi maqedonisht, Skopja (!), sikurse emri i përgjithshëm gur (kamen) që në trajtën e shquar del guri (kamenot). Tani a mund të më thuash ti se si do të dalë emri Skopje në trajtën e shquar? Këtë nuk mund ta bësh ti, nuk mund ta bëj unë, nuk mund ta bëjë njeri. Do të detyroheshim të thoshim Skopja (trajtë qesharake jo vetëm për ne, por edhe për ju)!

Le ta marrim emrin Tetovo maqedonisht. Nëse ky emër duhet të mbetet në këtë trajtë, atëherë ai, në të shquarën, do të dalë Tetovoja.

Drejtori më ndiqte fare i heshtur dhe i habitur.

- Shpjegimi yt është shumë i qartë. - tha ai. Deshi të thoshte edhe diçka, por unë i ndërhyra:

- Kjo është pengesa e parë, por s'është as e vetmja, as më e madhja. Edhe përtej kësaj maqedonishtja ndryshon shumë nga shqipja, sepse ju e lakoni emrin me anë të parafjalëve, ndërsa në shqip emri lakohet me mbaresa rasore. Le të kalojmë tani te lakimi i emrit. Tetovo. Ai do të na dilte: Tetovo, i Tetovosë, Tetovosë, Tetovonë...

Ai i hapi sytë. Thua do ta zinte kokën me dorë.

-Tani, cila është më e afërt për ju maqedonasit – Tetovë, Tetova, i Tetovës, Tetovës, Tetovën, apo – Tetovo, Tetovo, i Tetovosë, Tetovosë, Tetovonë...

Më dukej se drejtori kishte nisur të thyhej moralisht.

- Nga ana tjetër, shumë fjalë kanë çerdhen e tyre. Psh. nga emri Dibrë (Debar), na del mbiemri dibran (debarçanec), na del edhe ndajfolja dibrançe (debarçanski, na debarski naçin, kako debarçanite). A mund të më tregoni si të themi dibrançe nga emri Debar?

-Si i thonë këta të radios, të televizionit? - m'u drejtua ai.

- Atë trajtë nuk e përdorin, sepse s'dinë si ta përdorin. Dibrançe nuk mund të thonë, e vetmja mënyrë është ta përshkruajnë – si në Debar, në mënyrën e debarçanëve, por kjo jo vetëm që nuk është aq e thukët, as aq e fuqishme, por është një gjë e çoroditur!

Drejtori dukej i lodhur. Me gjasë koka i ishte bërë finjë.

-Të lutem ki edhe fare pak durim, - e luta. - Nëse themi se shqiptarët në Maqedoni duhet

t'i përdorin toponimet në gjuhën maqedonase, atëherë kjo do të thotë se të gjitha minoritetet, kudo që janë, duhet të veprojnë në të njëjtën mënyrë. Unë nuk di ndonjë shembull të tillë. Po, pastaj, a nuk do të thotë kjo se edhe maqedonasit në Shqipëri duhet t'i përdorin toponimet në gjuhën shqipe?

-Po, unë ashtu e kuptoj, - m'u përgjigj prerazi drejtori.

-Por, kjo është e pamundur! Edhe të duan – nuk do të mundin! Toponimia varet

edhe nga gjuha në të cilën përdoret. Si do të mund ta shkruanin e ta thoshin emrin e Shkodrës kur maqedonishtja nuk e njih shkronjën "ë"? Si do të thoshin Durrës, kur nuk e kanë as ë-në, as rr-në? Si do t'u thoshin emrave me shkronjat "dh" dhe "y"? Si do të thoshin Qafa e Thanës, kur as i shkruajnë e as i shqiptojnë dot shkronjat "th, ë"? Qafën e Thanës ju e quani Qafasan, por ai është emër i burimit shqip (ia përktheva si do të dukej maqedonisht). Ju ka thënë kush pse e quani ashtu, përse e keni ndërruar emrin shqip? A nuk do të thotë kjo se toponimet varen shumë nga gjuha, nga të folurit e saj, nga shkrimi i saj?

Tanimë drejtori dukej fare i lodhur, madje, ca edhe i përhumur.

-M'u bë mendja çorbë, - tha. - Me sa kuptova kjo punë na qenka shumë e ndërlikuar.

- Ke të drejtë. Vetëm sharlatani, që s'di gjë, mendon ndryshe...

-Them të ndalemi me kaq. Unë pajtohem me ato që the, nuk mund t'i kundërshtoj. Por, të të them se nuk do t'i ndërrojmë toponimet s'të them dot. Mund të mos më pyesin fare mua dhe çështjen ta zgjidhin në një mënyrë tjetër... Një herë për një herë ju vazhdoni si mendoni vetë.

Këtu u ndamë. Fjalët e tij sikur ma lehtësuan pak barrën. As ai, as dy drejtorët që do të vinin, nuk do të na imponoheshin me këtë marrëzi. Vërtet, ata ishin drejtorë, njerëz të parë të të gjithë shtëpisë, por ne dikur i kishim pasur kolegë me të cilët ndonjëherë shkonim nëpër Maqedoni duke ndjekur si gazetarë ndodhi të ndryshme. Asnjëri prej tyre nuk i kishte harruar raportet e viteve të shkuara.

Ne vazhdonim me toponimet shqipe. Sulmet s'kishin të pushuar. Nga mbledhja në mbledhje na kritikonin që nuk e kemi bërë ndryshimin. Ndër këto zëra dëgjohej aty-këtu edhe ndonjë funksionar. U ngritën të flasin edhe drejtuesit e emisioneve shqipe në radio e televizion. Në një mbledhje të gazetarëve të Maqedonisë, që u mbajt në Ohër, një redaktor ishte ngritur e na kishte sharë. Për fat, aty kishte qenë i pranishëm edhe drejtori ynë, me të cilin kisha biseduar disa ditë më parë. Ky e kishte marrë fjalën dhe e kishte bërë qepaze redaktorin e emisioneve shqipe të televizionit. Më në fund i kishte thënë: "Ti rri aty e mos u ngatërro në punët e "Flakës". Ajo di ç'bën. "Flaka" e ka kryeredaktorin e vet". Këtë rast ma treguan disa kolegë që kishin qenë të pranishëm. Por, drejtori nuk ma zuri në gojë kurrë që na kishte dalë në mbrojtje vendosmërisht.

Ata të parët që duhej të ngrinin zërin për këtë çështje – Instituti i gjuhës maqedonase, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Maqedonisë, shoqata e shkrytarëve, gjuhëtarë e intelektualë të njohur nuk e hapën gojën (për çudi nuk e bënë edhe të kundërtën, që ta përkrasin këtë ide të marrë). Të gjitha ia kishin lënë mistrecit. Ky sikur nuk kishte punë tjetër në ministri veçse t'i sulmonte, t'i shante e t'i ndiqte shkollat shqipe, arsimtarët shqiptarë dhe nxënësit e këtyre shkollave. Vite me radhë për çështjen nuk kishte thënë asnjë fjalë, as të mirë e as të keqe, ndonjë funksionar shqiptar. Ata i qëndronin larg çështjes. Po bëheshin disa vjet që asnjëri prej tyre, ndryshe nga më parë, nuk e kishte shkëlur pragun redaksisë sonë. Ç'është e vërteta, edhe ata, pas demonstratave të Prishtinës, ishin në pozitë shumë të vështirë, sepse ua kishin qepur arnën e u nxirrnin kleçka. Një funksionar shqiptar fliste nëpër mbledhje të ndryshme për nevojën e ndërrimit të toponimeve. Herë-herë ai shkruante ndonjë artikull dhe ndonjëherë botonte ndonjë libër te ne. Një ditë erdhi në redaksi. Unë e ftova për një kafe.

- Pa më thuaj ç'mendon ti për çështjen e toponimeve? – e pyeta.

Ai filloi të shtypej, sikur i vinte zor.

Unë i ndërhyva:

- Më fal, që nuk ta thashë një herë mendimin tim. Unë them se kjo punë është e mbrapshtë është një punë që s'bëhet dhe s'duhet të bëhet!

- Edhe unë mendoj kështu, - më tha. M'u duk se i erdhi zemra në vend.

- Po, veçse ti flet atëherë e këtë se toponimet duhet të ndërrohen. Në vend që t'i mbrosh, ti flet për ndryshimin e tyre...

Më erdhi keq sepse ra ngushtë.

Pas shumë kohësh që merreshim me toponimet më tha mendja se do të bëja mirë të shkoja edhe te kryetari i Republikës (i Kryesisë së Republikës). Kryetarin e njihja nga qarqet e gazetarisë, sepse dikur ishte marrë me të. Më pranoi. Ia tregova hallin për të cilin kisha ardhur të qahesha. Kërkova të na ndihmonte, sepse punët nuk kishin marrë të mbarën. Kjo që po bëhet këtu nuk është parë dhe nuk është dëgjuar të bëhet ndokund. Më në fund i thashë se unë ende kam shpresë se Maqedonia nuk do të shkelë në dërrasë të kalbur. Përderisa këtë gabim nuk e ka bërë redaksia jonë, them se nuk e ka bërë Maqedonia. Nuk është vonë të korrigjohet gabimi, sepse dëmi do të jetë akoma më i madh. Më në fund i shpreha bindjen time që ma thoshte intuita: Maqedonia nuk do ta bëjë këtë gabim...

Kryetari më dëgjoi me vëmendje, por vetë nuk më dha ndonjë mendim a vlerësim për çështjen. Më bindi se atë do ta shtronte në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë.

Në këtë kohë, sektori ynë i librave duhej të botonte një vepër për Kryengritjen e Dervish Carës. Unë nuk e kisha lexuar dorëshkrimin, por më kujtohet që Lutfi Rusi, përkthyesi, kur na e dorëzoi tekstin e përkthyer, më tha: Ki parasys se kjo vepër do të zgjojë reagimin e maqedonasve, sidomos të maqedonasve tetovarë. Këto fjalë ai m'i tha duke u nisur nga brendia e vepërës, por edhe nga situata shumë e nderë politike. Kur erdhi koha e botimit, unë dyzova. E thërrita autorin, z. Aleksandar Matkovski. Ai erdhi dhe më pa buzëqeshur. Duke qenë njeri që dinte t'i vlerësonte rrethanat në të cilat rronim, ai e mori fjalën e tha: - Hë, si do t'ia bëni me Historinë e Dervish Carës?

-Vepra është e rëndësishme, me sa dimë për Kryengritjen e tij nuk është shkruar gjë as në Shqipëri. Pra, që do ta botojmë është e sigurt, por mbase do të jetë mirë ta shtymë nja dy vjet...

U çudita shumë që ai tha:

- Pajtohem plotësisht me mendimin tuaj. Madje, unë vetë desha të vija e t'jua propozoja këtë gjë. Jam i vetëdijshëm se kjo kohë nuk është e përshtatshme as për shqiptarët, as për vllëhtë...

Më habiti që tok me shqiptarët i zuri në gojë dhe vllëhtë.

Kur erdhi koha dhe vepra e Matkovskit doli në dritë, ai ia behu në redaksi dhe na tregoi se ato ditë në Stamboll ishte mbajtur ndonjë takim i historianëve. Kishte qenë edhe ai. Me këtë rast, kish takuar edhe disa historianë të Shqipërisë dhe ua kishte dhënë librin "Kryengritja e Dervish Carës". Na tha se ata e kishin përshëndetur me entuziazëm këtë studim.

Në këtë kohë ne do ta botonim edhe Historinë e popullit maqedonas, vepër e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, redaktor i së cilës ishte kryetari i kësaj akademie, Mihaillo Apostollski. Historia ishte në shtypshkronjë dhe mendonim se duhej ta njoftonim z. Mihaillo se toponimi do të ishte "Shkup". Kryetari na pranoi një mbrëmje në shtëpinë e tij në lagjen Vodno. Bashkë me mua ishte edhe redaktori teknik. Kur i treguam pse kishim ardhur, ai ia priti: Skopje. I kërkova të falur dhe i thashë se ne i shkruajmë në gjuhën shqipe toponimet. Skopje është Skopje - tha ai. Historia, - i thashë unë - do të lexohet në Maqedoni, por do të lexohet edhe në Shqipëri, edhe në Kosovë, në botën e jashtme ku rrojnë shqiptarë. Ata as që e njohin emrin Skopje, ata e dinë Shkupin! Atëherë ai tha - le të jetë në të dyja gjuhët: Skopje (Shkup). Ky propozim është më i mirë, i thashë, por më duket se pak më mirë do të ishte Shkup (Skopje). Mirë, tha

ai, pa e zgjatur (për çudi vepra është botuar me rendin Skopje (Shkup). Se kush e bëri këtë ndryshim në shtypshkronjë nuk e morëm vesh).

Redaksia jonë vazhdonte vite me radhë, si gjithmonë, me toponimet në gjuhën shqipe. Po një ditë na u duk se do të bënim mirë të lëshonim pak pe; fare pak. Menduam se s'do të prishnim punë po të futnim në përdorim të kufizuar emrin e Manastirit (maqedonisht Bitolla, ndryshe nga serbishtja Bitolj). Morëm vendim dhe filluam ta praktikojmë: në tërë artikullin do të shkruhej Manastir (në mbititull, në titull, në nëntitull, në mestitujt e artikullit dhe në tërë tekstin), Por, vetëm një herë, në rastin e parë (në tekst) kur përmendet emri Manastir të shkruhet në kllapa (Bitolla) dhe asgjë më. Ky qe i vetmi ndryshim që bëmë. Të nesërmen e këtij ndryshimi, redaktori i revistës "Fatosi", poeti Mehmedali Hoxha, më takoi në korridorin e redaksisë, m'u afrova dhe më pëshpëriti në vesh: Dje e dëgjova Radio Tiranën të thoshte manastiri i Bitolit. Qesha dhe iu falënderova. Unë kam në shtëpi një atlas gjeografik të Shqipërisë, të botuar në Tiranë në vitin 1970, që e ka këtë toponim: Bitoli (Manastiri), - i thashë.

Tani, disa vjet që toponimet kishin nisur të ndryshonin dhe mbetën vetëmbotimet e "Flakës" pa e bërë këtë, ashqare ideja e batakçiu, e mistreçit-skilipeç (që tanimë ishte bërë doktor shkencash) nuk mund të zbatohet ndryshe përveçse me nxjerrjen e një ligji të posaçëm për këtë gjë. Sakaq, nisma u mor. Si e do radha, puna duhej të fillonte në komisionet e Kuvendit Republikan, konkretisht në Komisionin për marrëdhënie ndërnacionale. U caktua mbledhja dhe u ftuam edhe ne. Tri-katër ditë para mbledhjes unë e shkrova diskutimin dhe vajta t'ia jepja drejtorit se mos vallë kishte ndonjë vërejtje. Ia thashë këtë dhe e luta që të vinte edhe ai në mbledhje.

Ai nuk donte ta merrte diskutimin tim. Për më tepër, më tha:

- Unë nuk do të vij në mbledhje, por as ti s'do të shkosh.

- Unë do të shkoj patjetër, jo se dua, por ngaqë e kam për detyrë, - i thashë. - Për kë bëhet fjalë këtu? Përse do të nxirret ligji? Për ne të "Flakës". Por, unë të lus që të vish edhe ti. Si më thua të mos shkoj? Si t'u tregoj përse ne nuk i ndërrojmë toponimet dhe përse ato nuk duhet të preken?

Nuk iu hidhërova që më tha të mos shkoja. E dija se të vetmin qëllim e kishte që të mos

luaja me zjarrin. Pas pak, seç iu kujtua dhe m'u drejtua:

- Unë kam një shok të klasës, që sot është gjuhëtar i njohur. Nuk di nëse e kanë ftuar. Prit ta marr në telefon.

- Për kë e ke fjalën?

- Për Trajko Stamatoskin.

Vërtet, ai ishte një gjuhëtar i njohur, shumë vjet drejtor i Institutit të gjuhës maqedonase, një nga tre autorët e fjalorit të parë të maqedonishtes. Drejtori e mori në telefon dhe Trajkoja i tha se nuk e kishin ftuar. "Po të të ftonin, do të shkoje?" e pyeti. "E pse jo", iu përgjigj ai "unë jam autor i disa studimeve nga toponomastika". "Mirë, i tha drejtori, do të marrësh ftesë". Sakaq, drejtori e mori në telefon kryetarin e Kuvendit. "Edhe këtë e kam shok klase", më tha. Bisedoi me kryetarin dhe puna mbaroi.

Ditën që mbahej mbledhja në Kuvend, me të hyrë në një sallë të vogël, më ra në sy z. Stamatovski i ulur. E përshëndeta buzagaz. Mbledhjen e hapi kryetari, edhe ky "pishtar e prijatar" i flaktë i ndërrimit të toponimeve në gjuhën shqipe. Ndër të tjera ai i quajti nacionaliste tendencat e mospranimit të ndryshimit dhe nacionalizëm përdorimin e toponimeve në gjuhën shqipe. Erdhi radha e diskutimit. Në fillim njëri i binte gozhdës, tjetri potkoit. Unë sqarova disa çështje dhe, ndër të tjera thashë se nacionalizmi s'ka të bëjë me toponimet, sepse nacionalizmi si dukuri shfaqet vonë, në epokën e borgjezisë, ndërsa toponimet, pikërisht në këto trajta që kanë sot, përdoren prej shumë e shumë kohësh. Ndër të tjerë, në diskutim mori pjesë prof. dr. Remzi Nesimi, prof. dr. Xhevat Gega, profesore të katedrës së gjuhës shqipe të Fakultetit filologjik, të cilët mbrojtën toponimet shqipe. Dikur e mori fjalën z. Stamatovski. Ai që në fillim theksoi se nuk shikon ndonjë problem që toponimet e Maqedonisë përdoren edhe në gjuhën shqipe, që qyteti Kiçevo quhet Kërçovë, që Tetovo quhet Tetovë, që Debar quhet Dibër, që Kumanovo quhet Kumanovë. Në vazhdim ai foli për mikrotoponiminë. Ishte e qartë se fjala e tij i kishte dhënë fund tërë kësaj marrëzie. Fytyra e kryetarit të Komisionit dukej një çehre e prishur. Ai e dinte se pëpjekjet e tij të derisotme kishin marrë fund. "Ah, thashë me vete, të kisha mundësi t'i shikoja edhe një herë fëmijët e Dibrës duke e sjellë vërdallë mistrecin".

Duke dalë nga mbledhja, iu afrova gjuhëtarit Stamatovski. Ai m'u drejtua: -Unë

ju mbrojta më shumë ju shqiptarët, - tha ai.

- Ju falemi nderit, profesor. Sot shkenca e bëri të vetën: i vuri justëk fjalës.

Pavarësisht se ky ishte mendim vetëm i një maqedonasi, i një pensionisti, ai ishte mendimi i njeriut më kompetent në Maqedoni, që i vuri pikë çështjes.

Çështja e toponimeve u mbyll një ditë dhe nuk u dëgjua më. Ky ishte, ashqare, rezultat i qëndresës që i bëri me shumë durim, maturi dhe urtësi kolektivi i Redaksisë "Flaka e vëllazërimit" (me rreth pesëdhjetë e ca të punësuar). Së dyti, rezultat i qëndrimit profesional, korrekt dhe njerëzor i të tre drejtorëve të Shtëpisë gazetare-butuese "Nova Makedonija": Pançe Mihajlov, Radosllav Ognjanovski dhe Pande Kolemishovski (në periudhën 1982-1991), që nuk dhanë një urdhër të gabuar, të dëmshëm e fyes. Por, grushtin e vërtetë kësaj së keqeje ia dha vetëmbrojtja e gjuhës shqipe.

*

Ditëve që po mbyllej çështja e toponimeve, Forumi "25 Maji" (i të rinjve) organizoi në Shkup një takim që iu kushtua marrëdhënieve ndërnacionale. Ishin të ftuar disa intelektualë dhe politikanë nga Maqedonia dhe nga Kosova. E mbaj mend që ishte i pranishëm edhe filozofi kosovar Shkëlzen Maliqi. Për çudi, në bisedë e sipër u cek edhe emri "shiptar", me të cilin serbët dhe maqedonasit i quanin me nënçmim shqiptarët. Më vinte çudi se po kalonin rreth 15 vjet që ky emër fyes ishte lënë në harresë (me vendimet e komiteteve qendrore të partisë (në Maqedoni në mledhjen e KQ të LKM-së, me fjalën e kryetarit të tij Kërste Cërvenkovski - pa asnjë diskutim) dhe, me të drejtë, në vend të tij përdorej emri "albanac (serbisht), albanec (maqedonisht)". Çuditërisht, këtë çështje e shtroi Vllado Popovski, profesor i Fakultetit Juridik në Shkup. Madje ai e ngriti çështjen e këtij emri me nostalgji. Ja, tha ai, nuk e di pse e lamë dhe e harruam emrin e bukur e melodik "shiptar". Për më tepër shqiptarët maqedonasit i kanë thirrur gjithnjë me këtë emër.

Unë e kisha fare pranë. Ia qepa sytë i çuditur fare që këtë çështje e parashtrohte në mënyrë të mbrapshtë pas kaq vjetësh një profesor universitar, po edhe një njeri që merrej

herë pas here me çështje konkrete teorike politike. Ja, mendova, na dolën toponime të reja! Me të mbarova ai, unë e kërkova fjalën.

- Është për tu habitur rihapja e këtij problemi të harruar, - thashë. - Është fare e qartë se ky emër s'ka pasur qëllim tjetër veçse t'i nënçmojë shqiptarët. Së dyti, edhe atëherë ai përdorej në kundërshtim me tekstin dhe frymën e Kushtetutës së Jugosllavisë dhe të Maqedonisë (Popovski m'i kishte ngulur sytë dhe, seç më dukej, priste të thosha ndonjë marrëzi. Por, shumë shpejt, fët, ai ndërroi çehren). Siç dihet - vazhdova fjalën - me të dyja kushtetuat e lartpërmendura shqiptarët në Jugosllavi kanë pozitën e minoritetit, paçka se e gëzojnë emrin "kombësi". E tani le ta shtrojmë pyetjen: kush është pjesëtar i një minoriteti? Pjesëtar i një minoriteti në Jugosllavi është njeriu që i përket një populli i cili e ka formuar shtetin e vet kombëtar jashtë kufijve të Jugosllavisë (sakaq i hodha një vështrim Popovskit; dukej se ishte ngushtë). Prandaj, ashtu si quhet populli përkatës, ashtu do të quhet edhe minoriteti i atij populli, çdo pjesëtar i tij. Pra, albanac (albanec).

E dyta, nuk është e vërtetë se maqedonasit e kanë traditë të na quajnë shiptari (z. Popovski sërish zhgapërreu sytë). Ky emër ka nisur të përdoret rreth viteve '60, nën ndikimin e Serbisë. Unë e kam marrë letërnjoftimin e parë në vitin 1957 në Shkup. E dini ç'më shkruante në të: albanec! Emri shiptar në Maqedoni, nën ndikimin që përmenda, është përdorur nja dhjetë, e shumta pesëmbëdhjetë vjet. Maqedonasit na kanë quajtur gjithmonë albanci. Po, në të kaluarën na kanë quajtur me emër tjetër: arnauti (huazuar nga turqishtja).

Sapo mbarova unë këtë ndërhyrje të shkurtër, fjalën e mori menjëherë Shkëlzen Maliqi. Ai e përkrahu qëndrimin tim dhe e zgjeroi duke folur gjerë e gjatë. Askush nuk tha gjë për këto që kishim përmendur. As vetë z. Popovski.



Muzeu, kushtuar shkrimtarit të nderuar e të pavdekshëm, Sterjo Spasse, më zgjoi ndjenjat e mia studentore, kur isha i ri.

Kur mora lajmin se zona e Pustecit dhe e gjithë Prespës nderoi shkrimtarin Sterjo Spasse, me ngritjen e muzeut në shtëpinë e tij të vjetër, në fshatin Gollomboc, ku ai lindi në vitin 1914, u gëzova pa masë dhe më këtë rast përshëndes Bashkinë e Pustecit që nderoi birin e saj, të Prespës, por dhe të gjithë Shqipërisë.

E gjithë zona e Prespës mburret me të drejtë, që nga gjiri i saj ka lindur një i tillë burrë, shkrimtar, mendimtar i madh, por mbi të gjitha njeri tepër i dashur dhe shumë i thjeshtë.

Unë e kam takuar për herë të parë rreth vitit 1955 në shtëpinë e shkrimtarit tjetër të madh, në shtëpinë e Petro Markos. Ata të dy ishin shokë të ngushtë dhe vazhdimisht i shihje bashkë.

Kur shkova në shtëpinë e Petro Markos, Petro i thotë Sterjos:

- Këtë djalosh e kemi nga Përmeti dhe është një student i mirë dhe që e dashuron me pasion letërsinë.

Sterjo më përgëzoi, dhe vazhdoi:

- Djalosh, je nga Bilbilentë e Frashërit dhe të Kombit Shqiptar... Nëse e dashuron letërsinë do të bëhesh një shkrimtar i mirë.

Unë iu përgjigja:

- Unë jam nga Maleshova...

- Oh, je nga vendi i origjinës të Sejfulla Maleshovës.

- Po, - i thashë unë, - gjyshja ime ka lidhje fisnore me Zenepen, nënën e Sejfullait. Kur kam shkuar për vizitë me gjyshen në shtëpinë e tij, e kam takuar dy herë atë. (Në atë kohë, Sejfulla Maleshova ka qenë i goditur nga partia në pushtet, e megjithatë ishte drejtor i Botimeve në Shtëpinë Botuese në Tiranë.)

Sterjo më tha: - Sejfullai është njeri i ditur dhe me kulturë të gjerë. E kam takuar disa herë edhe këtu por edhe jashtë Shqipërisë.

Prespa nderoi shkrimtarin Sterjo Spasse, me ngritjen e muzeut në shtëpinë e tij të vjetër, në fshatin Gollomboc, ku ai lindi në vitin 1914

Muzeu që më zgjoi kujtimet e viteve studentore

Nga Xhafer Korro

Mbas disa çasteve unë iu lash shëndenë dhe u largova.

Më vonë, pyeta Petron për të më treguar diçka mbi jetën dhe veprimtarinë letrare të Sterjos.

Petro më tha se e kishte shok prej shumë e shumë vitesh. Të dy kishin pasur kohë të vështira në Tiranë kur nuk gjenin dot punë. Në vitet '30 shkruanin një grup shkrimtarësh të rinj. Shkruanim dhe unë edhe Sterjo. Sterjo Spasse, në vitin 1933 kishte shkruar romanin "Pse", të cilin e botoi në Korçë në 1935.

- Një ditë, - vazhdoi të më tregonte Petro, - Sterjo më dha për të lexuar romanin e tij dhe më pyeti nëse mund ta botonte ose jo këtë roman.

- Mos e boto tani, - e kishte këshilluar Petro. - Vendin tonë e kanë lënë në errësirë kulturore regjimet që ka pasur dhe nuk do ta kuptojnë idenë e romanit tënd.

Po Sterjo e botoi romanin "Pse". Romani përgjithësisht u prit mirë, por pati dhe shumë kritika dhe për këtë Sterjo i thotë Petros: - Petro, ti kishte të drejtë, do të kisha bërë mirë të kisha dëgjuar këshillën tënde dashamirëse.

Por nëse e lexon "Pse", çdokush, kritik letrar apo dashamirës i letërsisë e kupton

se romani ishte me ide përparimtare për kohën. Por fatkeqësisht mjedisi letrar i asaj kohe nuk e kuptoi idenë themelore të autorit. Dashakeqësit përhapën shprehjen "Pse-në nuk e gjeti dot as Sterjo Spasse" të cilën e përdornin kur nuk dinin përgjigjen e një pyetje.

Petro më tregoi se për një kohë të gjatë kishin punuar së bashku. Por për të gjetur punë ishte tepër e vështirë për shkak të moskujdesit të qeverisë së asaj kohe për arsimin.

- Mbas shumë përpjekjesh, - vazhdon Petro, - më në fund na emëruan si mësues të parë në Dervican të krahinës së Dropullit. Ishte e vështirë për të shkuar atje, sepse nuk kishte transport. Në fillim fjetëm jashtë, nëpër varreza. Mëngjeseve, banorët e fshatit kur na shihnin nëpër varreza, bënin kryq, tepër të çuditur. Edhe bukën mezi e siguronim dhe shpesh na e jepnin banorët. Më vonë na erdhën ndihma nga shokët e Sarandës. Hapëm shkollën nëpër shtëpi të banorëve. Dhe ne kur filluam të mësonim nxënësit e parë, banorët besuan se ne ishim me të vërtetë mësues dhe filluan dhe vazhduan të na nderonin dhe respektonin anembanë Dropullit. Shpesh na ftonin për vizita në



familjet e tyre, - përfundoi Petro Marko.

Unë i shikoja gjithmonë bashkë, Petro Markon dhe Sterjo Spassen në Tiranë dhe përshëndetsha me ta si me dy miq të mirë.

Më vonë lexova, dhe i kam, pjesën më të madhe të veprave të Sterjo Spasse në bibliotekën time. Romane dhe tregime të shkruara bukur, me gjuhë të rrjedhshme, dhe me personazhe të skalitur me mjeshteri që të mbeten në kujtesë gjithmonë. Romanet e tij flasin më së shumti për krahinën e vendlindjes së tij të cilën ai e donte dhe ndihej krenar për të.

"Afërdita", "Të fala nga fshati". "Afërdita përsëri në fshat", "Ata nuk ishin vetëm", "Zjarre", "Zgjimi", "Pishtarë", "Ja vdekje, ja liri", dhe natyrisht dhe romanin, që mbahet si kryevepra e tij, romanin "Ose" që më bëjnë që Sterjo Spassen ta kem një nga shkrimtarët e mi më të dashur.

Miami, prill 2022



NIËNËS I VDIQËN DY FËMIJËT E PARË

nga Arbër Selmani

Albana jetoj tri javë
por me kaq mbaroi fluturimi i saj
u copëtua
dikush gjykoi që ajo të mos jetonte
të mos lindte
të perëndonte.

Albana sot do të ishte e rritur, nënë
e dashuruar në poezinë franceze
njohëse e gjuhës së shenjave
shtatlartë, e zjarrtë, tmerrsisht e
ngarkuar.

Ndoshta,
sa shumë ndoshta që nuk u definuan
kurrë.

Albana jetoj tri javë
për të na thyer zemrat treqind vjet vetmie.

Albanës i dhanë kohë qesharake prej tri
javësh
të gatuante, të vishej vet, të punonte në
oborr
të shkruante një roman, të fitonte çdo garë
këndimi
të mësonte psalme, të dashuronte me epsh
të dëshmohej, të tregohej
nuk mundi, dhe nuk jetoj
kështu vendosi gjykata vrastare e
foshnjeve.

Albana sot do të ishte 40 vjeç

me palltot deri pak poshtë gjunjëve
me dhëmbë të bardhë, me fytyrë të pastër
prej vajit të kokosit
e detajshme, e dehur prej klimaksit
ndoshta do ta bënte mamografinë.

Ndoshta,
këto ndoshta të bejnë të rrotullohesh në
shtratin e të pamundurave.

Albanës, zanat, ia dhanë 21 ditë afat
të forcohej, të dilte në sheshin e qytetit
të bëhej presidente e shtetit
të shtegëtonte, të luante në violinë
ta thyente të keqen me mirësi.

Nuk ka shumë orë dita e një foshnjeje që
vdes.

Me Albanin ishte ndryshe
Albani e pati shumë ftohtë

ishin tjera temperatura në motin kur ai
lindi
ia lejuan veç disa frymëmarrje
syçkat e tij të skuqura numëruan katrorët
e tavanit të spitalit
mbështjellur me çarshaf të bardhë
e me fat të përljer zi.

Albani jetoj pak orë
nuk arriti të bëhej dikushi
nuk u bë as ëndërrimtar, as furrtar
as nuk shkoi kurrë në çerdhe fëmijësh
e këshilluan të provonte zanatin e mjekut
nuk kishte hapësirë, e pamundur.

Pa u bërë as njeri, e as flutur
Albani dha shpirt, me shpirt të këputur.

Albani sot mund të ishte roje burgu
trupmadh, plot rrudha
kurrë i dhënë pas alkoholit e cigareve
eliptik,
i rrasur thellë në oqeanin e të bëmave të
mira
shpirt i huaj,
i vendosur si piktura më e bukur në çdo
dhomë shtëpie.

Ky Alban sot do të ishte mashkull vigan
në kërkim të dashurisë, a pasurisë, a
lumturisë
por në pak orë, i thanë të ngjiste malin më
të rrëpirë
të bëhej mjek popullor
ja shkëputën kontratën e jetës, nuk mundi,
e pati vështirë.

Një mal me detyra për Albanin
por u shua, si qumësht u vlua,
as gjykatës nuk mundi të paguante
botës nuk i plas për një foshnje më pak
njerëz të tmerrshëm do të lindin, do
jetojnë përhera,
nëna natyrë është e zënë me halle tjera
e Albani pret ende t'i vijë pranvera.

Nënës i vdiqën dy fëmijët e parë
ata nuk janë në asnjë fotografi
janë dy numra inkubatorësh, pa asnjë sy

janë veç në këtë poezi
që po e shkruaj afër një shtëpie shëndeti
ku një bebe tjetër do të jetojë pak orë
dhe kaq,
pos nënës që e lindi,
nuk do të kujtohet më kurrë.



NË LIBRARI, LIBRI I RI I POETIT LAUREAT, RUDOLF MARKU. "SIBILAT NË SHKALLËT TONA"

Në një dialog të mprehtë me Europën posthegjemoniste, Rudolf Marku mbetet dishepull i paepur i një shkollë të përvetshme; banor malesh dhe anëdetesh, poezia e tij i shmang perspektivat tokësore për të bërë bashkë najadat dhe ujqërit. Marku është poet tragjik, por tragjedia nuk është fjala e tij e fundit. Ashtu si Odiseja homerik – njëri prej heronjve të tij të preferuar – ai e vetëzbulon trajektoren e vet si një barrë qëllimi që ia bën udhëtimin shumë më tepër sesa personal. Duke i rënë gjatë navigimit të historisë së kombit të vet, ai i çliron endjet e tij meditative prej përkitjes hapësinore dhe kohore, I familjarizuar me majëmalet e poezisë, ashtu siç parathotë Herakliti, kurrë nuk ia del të mbërrijë në shtëpi, ngase nuk mund të hysh dy herë në të njëjtin qytet. Destinacionet e tij mbeten trishtimi dhe vetmia. Tragjedia për Markun është Gehenna e një bote lutjesh statike, e prizmit miopik të modernitetit. “Poetët, - thotë ai, - janë qytetarë të Ferrit”, por prapë kjo cilësi qytetarie nuk mbetet (nën) kuptim final. Ferri i poetëve ka një liri të brendshme ngaqë brenda kufijsh të dhënë, brenda ligjesh të paracaktuara, ata finalizojnë politika fluide.. Për Rudolf Markun poetët janë “agjentët sekretë” të atdheut, mjeshtër galerash që minojnë të nëndheshmen, duke mbetur një racë e ndryshme. I bën të tillë përshtatja me sferat qiellore, aftësia për të përdorur epitetet e ferrit edhe kur përshkruajnë parajsën. Poetët për Rudolf Markun kryqëzohen padukshëm në zemrat e të gjithëve dhe të asnjërit, ata ofrojnë zemërgjerësisht çlirim prej realitetit skllavërues. Duke jetuar vargmaleve antike dhe dallgëve të kohës, aty në habitatin e Ovidit dhe të pavdekshmëve të tjerë, poetët e vërtetë e dinë se fati nuk vdes, se trishtimi ka flatra morbide, se mungesa e fundit tokësore ekziston si pasojë e absolute së prekshme, se dashuritë na bëjnë “të biem jashtë kohe”. Poezia e Rudolf Markut frymëzon kujtesën selektive, flakjen dhe harrimin.

James Manteith

STRUKTURË E KUQE

Gjithkush do të tronditej në qoftë se do t'i fliste në rrugë një lopë e kuqe. Sa herë që kujtoj këshillat e tij qesh, megjithëse shpesh mendoj se ato marrin formë kur përçarshem dhe humbas në kujtime. Kjo më ngjall një lloj frike për vërtetësinë paranormale dhe telepatike, diçka supersticioze më mban të lidhur dhe sikur ma drejton jetën në një mënyrë të fshehtë e të sikletshme. Bashkë me përfytyrimet e mundshme ngjizen dhe këshillat primitive për shpjegimet e duhura.

Në qoftë se do të shohësh ndonjëherë në ëndërr sikur ndjek një lopë të kuqe, mos mendo se do të vijë cikli po qe grua, as se do të bëhesh me vajzë po qe burrë. Nuk është e thënë as se gjërat do të shkojnë keq pas kësaj ëndrre, thjesht ti do të vazhdosh të flesh në shpinë. Një lopë, qoftë dhe ajo e kuqja e ëndrës, nuk do të mundet dot kurrë të flejë në shpinë.

Po çapitem në një rrugicë, një puhizë e lehtë më lëviz balluken që më bie në sy. Sapo të mbërrij në shtëpi do ta pres këtë cullufe të pabindur. Para se ta pres më duhet të mpreh gërshërët, ato kërcasin e nuk e zënë mirë prenë e tyre. Duke u ngatërruar në këto përfytyrime me gërshërë

më mbytet era e fortë e një bajge, shoh rreth e rrotull mos më sheh njeri dhe marr frymë thellë. Dua ta ndiej. Klorofili i ngrohtë më shpon hundët dhe në çast dal pak nga zona ime e qytetarisë. Dëshiroj me shpirt që lopa, e zonja e erës, të jetë e kuqe.

Kontrolloj mes shkurreve sa më ha syri të fut në objektiv kafshën e shenjtë. Më bëhet sikur ajo do t'më shpëtojë nga përfytyrimet e ndjesitë e e mia të mbrapshta, do t'ma legjitimojë ekzistencën.

Të gjitha këto sikur më largojnë ca çaste nga paniku, nga makthi dhe frika e tmerrshme që më ka zaptuar. Hap sytë dhe dëgjoj rrahjet e shpeshta të zemrës.

Kjo është, këtë dua!

Jam një lopë e shenjtë, qumështi im është zbrazur për të ushqyer me mëmësi botën. Nga goja më dalin ca jargë të ngrohta veshtullore të cilat fshehin buzëqeshjen e një qenie të çartur dhe të fyer.

Në të gjithë këtë zëdhallje më mirë një lopë se një lolo që s'bën askënd për të qeshur. Lëre më të mendosh se e ke në dorë dhe je në gjendje të mos i presësh kurrë flokët e tu, e me një mesatare të matësh shtatëqind e njëzet e pesë kilometra flokë, nëse u jep liri të rriten gjithë jetën, kuptohet. E në këto përfytyrime një "muuu" e fortë të nxjerr nga përjetimet më të thella të shpirtit tënd prej ëndërrimtarit të sëmure. Lopa e kuqe del nga shkurret, të merr majë brirëve dhe si për ironi të fatit të lë një shenjë nga ana e djathtë e fytyrës, fiks mbi buzë.

ME TITULLIN, MARTOHEMI

Dëgjomë!

Ti e di, po s'më lëndove unë nuk mund të të dua. Në qoftë se unë nuk e ndiej gjëmën, si mund të të dua?! E mban mend kur më braktise, kur më le mes katër rrugëve për një nga ato të lëvizurat e vogla?!

Sa shumë të desha atëherë, i përmbysi dashuria të gjitha rastet e tjera. Sa nuk u çmenda nga dhimbja. Ti e di, mezi mbijetova nga vdekja. Kur e mora veten nga sëmurdja dhe u bëra më mirë, shkova dhe mblodha të gjitha lulekuqet që kisha parë. Bleva ftesa dhe të përgatita funeralin. Ti erdhe i lemeritur nga çmenduria ime, më gjuajta mes gjindjes me këpucë.

KATRENË TREGIMESH

nga *Esmeralda Shpata*

E mban mend si ikën të gjithë të tmerruar?!

Kur salloni u zbraz u pamë në sy dhe ia dhamë së qeshurës me të madhe. Më pas u përvodhëm në heshtje në cepin më të errët të shtëpisë dhe u puthëm. Ti vure muzikë dhe kërcyem tërë natën. Si iku koha! Në ag, sapa zbardhi dita, më përplase me dhunë në tokë sepse u kujtove ç'të kishte sjellë mbrëmë pranë meje.

Mund të martohemi, por do të ishte torturë të më sillje kafën, të paguaj faturat, të më prisje thonjtë e dorës së djathtë çdo të diel pasdite. Sa herë ma thua që përgjegjësia ta shpif, ta bën shtrydhjen. Asnjë s'mund t'i shohë plagosjet dhe therjet tona të brendshme, ato të thellat. Askush! Me ngazëllim hamendësojmë rastet ngjyrë qelibari.

Shiko ç'sajova!

Të të hedh helm e të ta heq në çastin e fundit nga ushqimi. S'mund ta bëj se ma shpifin të vjellat. Po sikur një herë të vetme mos të ta heq helmin, gjoja e harrova pa dashje?!

Jo i dashur, nuk mundem të bëj sehir e të gjej mënyra për ta vrarë dashurinë tonë.

Kur të shihemi të dy te portat hijerënda të së ardhmes, do të gajasemi me retë që na kanë mbyllur. Ato janë të bardha, por të

shqetësuar e të sëmura, na shkruajnë një vragë të brendshme, të kuqe.

Qeshim për ta fshehur tronditjen, marrim rrugën dhe martohemi pa ceremoni në kishën tonë.

ME QENË NJË PAMJE REALISTE

Jo e keqe si vajzë. Aspak e keqe.

Tani që po e mendoja, ajo nuk kishte asnjë emër të përshtatshëm. Gjithsesi, ky interpretim ka kufij. Pamje me përmbajtje, parë nga jashtë.

Ajo heshtte pareshtur, ndoshta ishte mesi i muajit kur e vura re. Mbase ishte fundi i vitit që shkoi ose fillimi i këtij që jemi. Në dukje nuk ka rëndësi, por unë dua ta kujtoj. Një blanë madhoshe më shfaqet në kujtesë para ditës që mbërriti ajo. Unë nuk kam kujtesë. Unë kam aftësi të veçanta, sulmin dhe mbrojtjen i kam aleatë.

Ajo ishte tërheqëse ose çasti që e solli para syve të mi, ishte i magjishëm.

"E kam shumë problem, - i thashë,- Edhe pse ti nuk flet, unë ta ndiej mungesën."

Më mirë të bëja diçka sesa të rrija

duarlidhur. Vështrimi i saj i ngultë nuk më stepi.

Nuk kisha asgjë, pësjtjellimi më mbuloi dhe u gjenda i humbur. U shtriqua në një trup dhe mendje tjetër. Nuk kam qenë asnjëherë i zoti të dal nga emri im dhe të bëhem i ditur. Mendova nga një emër tjetër për të, megjithëse nuk isha i prerë për të qëndruar në trupin e tij petashuq. Ajo ngriti sytë dhe më zbuloi. Më pa me një vështrim të zbrazët dhe më kërkoi një këngë të krijuar veçmas për të.

Çfarë ironie!

Para gjashtë-shtatë vitesh, nuk e di fiks se kur, unë e kisha krijuar një këngë.

Si kisha mundur ta parashikoj këtë?!

Rasti e solli, nuk di të parashikoj.

Ca çaste më vonë i këndova këngën.

U përpoqa ta zhdukja të gjithë vetëdijen time duke gërmëzuar çdo fjalë të saj. Për një çast u ndjeva në pozicion mbrojtës, e ruaja këngën time të krijuar para kohe për të. Po të kishte qenë e mundur, do ta kisha parë çudinë e tingujve nga brenda.

"Unë di të dëgjoj, - më tha. - E kam dëgjuar në një kohë e në një trup tjetër këtë këngë.

Çfarë rrethanash absurde dhe çfarë kthese kishte marrë fati me këngën time.

Dyshova.

Të kthehem aty ku e lamë.

Nuk ishte aspak vajzë e keqe.

E NESËRME PREJ DRITE

Kam një armik.

Prirë të bërtas me sa ma lejojnë tejtat e zërit "Të kapa!", por e di se fati më nxjerr fluturimthi jashtë dhe, e ndjek me sy vendin ku mendoj se fshihet.

E kam mbajtur në cep të syrit, atij të djathtit, atij që ka parë të dashurën time të shtrenjtë.

Ah, nuk mund ta tregoj dot historinë pa u rrënuqethur. Ngrihem t'u dal para dënësave, por ato hapërdahen nëpër trup dhe më paralizojnë.

Ajo bëri një gjest, tha dy-tre fjalë nga ato me tringëllimë që t'i rrafshojnë të gjitha njohjet e hershme. Buzëqeshi aq dëlirësisht sa dhe zmalti i dhëmbëve derdhi kamomil të bardhë.

Armiku im nuk ka nevojë për retorikë. Ai është zhveshur krejt lakuriq, ka zënë një cep të errët dhe ushqehet me vjetërsirat e trupit.

Ma ndërpret ëndrën dhe më shpie në një kthinë të vogël. Aty frika ka veshur këpucët e zeza dhe i ka lyer buzët me një bojë të bardheme, ato dridhen dhe ofshajnë të trembura.

E dashura ime depërtoi brenda ëmbëlsisht, shkeli me këmbët e zbathura mbi të. Armiku ndihet i trazuar. E ka humbur qetësinë dhe i përvidhet dhimbshëm syrit. Është bërë flakë i kuq, i erdhi koka vërdallë kur mësoi për ardhjen e të dashurës sime.

Ajo, ah ç'është ajo! Hyjneshë!

Si e mblodhi veten nga tronditja dhe fshiu lotët që i rridhnin çurg, përpiu me hundë të gjithë oksigjenin që kishte përreth dhe u blata.

Iu dha tërësisht dritës. Drita që erdhi nga Dielli iu qep skutave, të gjitha atyre prej karboni dhe prej fryme dhe e dëboi frikën me gjithë këpucë.

"Të zhdukaj!"

Hasmi im u mblodh, u tkurr, firoi, e la të gjithë mënjatë atë historinë e luftës.

Drita e Diellit fshin me zell gjurmët dhe më lëpin me afsh fytyrën. Po ta shohësh me vëmendje syrin tim të djathtë, do t'ia lejosh vetes një shaka të hollë të fatit.



VAJZA DHE KRIJESA

nga Pajtim Statovci

Përktheu nga anglishtja: Driola Kraja

Për gati një vit nuk ka ndërë dritë dielli mbi lëkurë, vetëm muret e ftohta të guvës së vet, të cilat i gërvisht dhe gërryen pandërprerë, nervoz dhe pa pushim, me kthetra dhe dhëmbë të copëtuara e të pamprehura; nuk di të bëjë dallimin e natës nga dita, gjumit nga zgjimi, flatrat e veta nga katrani i errësirës apo trupit gjithë kallo nga gurët e shkëmbinjte, me të cilat, nga forca e zakonit, shkëmben përshëndetje të sjellshme.

Ia tregojnë historinë në përralla të frikshme që tmerrojnë fëmijë të vegjël. Mbaroje darkën, se përndryshe ta merr ajo, thonë ata. Mendon se të ka shok, dhe ndërkohë që je në gjumë do përvidhet brenda si fllad nga dritarja ose do ngrihet si avull nga dërrasat e dyshemesë, aq ngadalë sa nuk e dallon dot, do të të futet në shtrat dhe do të shtrihet qetësisht pranë teje, më pas do të ngulë gjuhën e pirunjte drejt e në flegat e hundëve të tua, gojës e veshëve për të dalë më në fund nga sytë e tu, do të lutet që të vdesësh e të mos

shohësh diellin e së nesërme. Mos ia kthe fjalën prindërve, mos u bëj egoist, mendjemadh, dembel, i babëzitur, ziliqar; mos gënje, se do shfaqet të të hajë të gjallë, të të gëlltisi si alte.

Jeton në gjykimet e kaluara dorë më dorë nga të inatosurit, fjalët e përdorura në përshkrimin e kokëfortëve dhe të acaruarve, të meriturve e të hidhurve, strehohet në rrugët ku ecim vetëm, ku lumenjtë takohen e ku rrymat janë më të pabesa, në shtëpi të braktisura, pyje e lugina të papopulluara, në male të vetmuara, majat e të cilave shpojnë retë si tullumbace.

Një herë në vit i lejohet të dali nga shpella e vet, gjithmonë në pranverë, me lindje të diellit, ku pemët rrinë drejt dhe fushat kanë nisur të rrisin një gëzof bimësh të ri. Vetëm atë ditë ka një palë flatra të marra hua dhe e quajnë kulçeder, po ditët e tjera quhet ndryshe. Thuhet se ndërkohë që është e lirë, shkatërron çdo gjë që shikon, godet drurët me flakë, boshatisë qytete, rrafshon çdo gjë për të cilën njerëzit kishin punuar gjithë vitin.

Pas kësaj, fillon e kërkon për ndonjë vend të përshtatshëm për të dremitur; viziton detin, tokën, hyjninë, e pasi bie dakord për ndonjë vend, harron se nga ka ardhur, ku qëndronte vetëm një ditë më parë, sa njerëz ka vvarë, të fajshëm e të pafajshëm, madje këndon me zë të ngjirur deri në joshje.

Një vit, teksa tundej dlireshëm mbi një degë, ndjeu një guralec ta godiste anash. Buçiti si bubullimë dhe u zhduk sa hap e mbyll sytë.

“Kush është atje?” pyeti një zë i kthjellët nga goja e një vajze të mbështjellë me lëkurë ariu, që po rrinte në rrëzë të pemës. Me flakërim, krijesa ra nga qielli dhe kapi vajzën, mbështolli veten rreth trupit të saj e i mbajti fytyrat e tyre afër njëra-tjetrës. Solli gjuhën e vet nëpër zgavrat e syve të vajzës, të cilat ishin të zbrazta si të të vdekurve.

“A e di se çfarë jam unë, ti budallaçkë?” pyeti.

“Jo,” u përgjigj vajza para se të niste nga e qeshura. “Jam e verbër.”

“Më gudulise me që ra fjala,” tha dhe vazhdoi të qeshte. “Je shumë i fortë,” ia behu sërish ajo, ndërkohë që krijesa e shtrëngoi më shumë. “Do të doja të isha dhe unë.”

“Nuk ke frikë nga unë?” pyeti.

“Frikë?”

“Po.”

“Sigurisht që nuk kam frikë nga ty,” iu gjegj ajo, duke goditur me shaka lëkurën e krijesës, e paaftë të vlerësonte pafundësinë e saj, dhe qeshi prap. “Dhe nuk është shumë e sjellshme të më quash budallaçkë kur nuk më njeh. Vërtetë jam e verbër, por jam shumë e zgjuar.”

“Vërtetë?”

“Pooo!”

E vetmja gjë që mund të bënte ishte të bashkohej me të qeshurat e saj, e uli vajzën në tokë e ndërsa po bëhej gati të ikte, vajza nxori dorën e majtë dhe e kapi nga fundi i bishtit.

“Ku mendon se po shkoni?”

“Po iki,” u përgjigj, e liruar nga mbërthimi i vajzës e sjellur në pozicion sulmi, lëkura e mbështjellë nga luspa e rrudha vezulluese, goja si armë e mbushur, gati për të këputur krahun e vajzës si ndëshkim për paturpësinë e saj.

“Mirë,” tha ajo. “Po mos ik që tani. Dëshiron të luash me mua si fillim?”

“Të luaj?”

“Pooo!”

Pasi e mendoi për pak kohë, pranoi ftesën e vajzës, dhe të dyja bashkë ndoqën njëra-tjetrën përgjatë fushave dhe kullotave, duke u fshehur me rradhë nëpër shkurret e degët e pemëve, dhe me të afruar të darkës, të dyja ishin të dërrmuara e i kishin thënë gjithçka njëra-tjetrës: vajza për familjen e saj, e cila e kishte përzënë nga shtëpia se nuk dinin çfarë t'i bënin një vajze të verbër, ndërsa krijesa i kishte treguar për shpellën ku kishte kaluar jetën dhe gjithë emrat e ndryshëm që i kishin vënë.

Emri i vajzës ishte Drita, e krijesës i ishte dukur e mahnitshme pasi vajza nuk e kishte parë kurrë dritën.

Para se të thonin lamtumirë, ranë dakord të takoheshin sërish pas një viti, dhe që nga ai moment, ata u takuan çdo mot, gjithmonë në lulëzim të pranverës, në të njëjtin pyll ku u takuan herën e parë, në të njëjtën skutë ku vajza gati kishte humbur krahun e saj.

Ndër vite, i mësoi vajzës gjueti, si të zinte pre e si të gjuante me shtizë. I këputi vajzës gjysmën e gjoksit në mënyrë që të shtinte më mirë me shigjetë, dhe krenarisht ndoqi zhvillimin e saj drejt maturimit e rritjes, një grua po aq e fortë sa një burrë.

Një pranverë, krijesa mori kurajën të pyeste, gjithë turp e frikë, nëse Drita do të martohej me të, nëse ajo do mund të jetonte me të, duke kaluar çdo moment bashkë, çdo ditë të vitit.

Drita nisi të qante dhe nuk mundi të përgjigjej, e mposhtur nga emocionet.

“Dhe a ka rëndësi që unë dikur gjithashtu kam qenë... vajzë?” pyeti krijesa.

“Jo,” u përgjigj Drita, duke u qetësuar e duke zgjatur duart tek faqet e krijesës. “Nuk ka aspak rëndësi,” vazhdoi ajo, duke afruar e prekur buzët e veta me të sajat, të ngurta si lëvore. “Do të bëhem gruaja jote, sigurisht që po. Tanimë e kam parë.”

“Çfarë ke parë” pyeti krijesa.

“Dritën.”

Thuhet që edhe sot e kësaj ditë, ato rrojnë aty, vetëm bashkë, të ngjitura si statuja njëra përballë tjetrës, në një shpellë në shpat të malit ku nata nuk ikën kurrë.

(fragment nga romani “Bolla”)



DEBATI

Kisha kohë pa e takuar atë njeri. E njihja si një ndër studiuesit më të mirë të historisë, sidomos të ndriçimit të fakteve të panjohura të saj, të cilat, për një arsye apo tjetër, kishin mbetur në hije. Pak a shumë isha dakord me mendimet e tij dhe shkrimet ia lexoja me interes kur i botonte në gazeta. Veçanërisht, kur e takoja, kisha dëshirë ta dëgjoja, sepse ai rrinte gjatë në bibliotekë, hulumtonte, madje edhe jashtë shtetit shkente jo rrallë, për të rrëmuar në arkivat e huaja. Librin e fundit mbi disa vështrime për perandorinë osmane nuk ma kishte dhënë.

Ne u ulëm në një lokal buzë Lanës, i cili mbulohej nga shelgjet që kishin çelur në pranverë. Profesori pinte kafe me ujë të ftohtë, ndërsa unë porosita një birrë.

-Studimet e tua më pëlqejnë, -i thashë-, megjithëse të jem i sinqertë, kam lexuar vetëm shkrimet nëpër gazeta.

Ai rufti kafën dhe heshti një hop. Flokët e bardhë iu tallazitën pakëz nga një erë e freskët që filloi. Vuri syzet më mirë në kurrizin e hundës së tij prej shqiponje dhe nxori nga çanta një bllok, pastaj e rifuti atë prapë në çantë dhe nxori pllakën e celularit, e pastroi xhamin e tij pakëz dhe e hapi. Ekranin u ndez.

-Kam menduar gjatë të bisedoj me një mik. Kam një sèkëllid të madhe!

Në fjalët e tij vura re një dridhje ose më mirë kjo dridhje mund të kapej përmes një ndjesie të pakuptueshme. Sidoqoftë se ku do dilte tymi i këtij shqetësimi më duhej të prisja. Ai hapi krahët sikur donte ta përmbledhonte shqetësimin e tij, të mos i largohej.

-Ti e njeh FK, -më tha.

-Po. Burrë i mirë, jo vetëm por edhe mjek i zoti.

-Në është mjek të rrijë mjek, -foli ai. Pse duhet të merret me studime historike? Unë jam njohësi më i mirë i studimeve për mesjetën.

-Këtë nuk e di, -thashë, -mundet. Unë jam një amator i histories vetëm se ajo më pëlqen...

-Ta them unë, dhe kjo është më se e vërtetë. FK më komenton në fb mbroçkulla. Ja për shembull, ai thotë se Skënderbeu është nga Sina e Dibrës. Kundërshton tezat e mia pa argumente. Dhe, do të thuash ti, merr pëlqimet më të shumta, dhe tërheq pas një ushtri të tërë mediokrësh. Duke i tërhequr ata, ai bëhet i besueshëm. Si të thuash, merr vlerat e një historiani. Këta që janë amatorë të studimeve kanë një këmbëngulje të madhe, ata bindin veten se janë shkencëtarët më të mëdhenj dhe harrojnë ne të vërtetë, që na ka rënë qafa mbi gjoks duke mbajtur me orë të tëra kryet ulur nëpër biblioteka, duke rrëmuar nëpër arkiva e duke gjetur dokumenta që të tjerët nuk i kanë parë as në ëndërr...

Historiani fliste me një dhimbje të lehtë, me një ndjenjë keqardhje të konsiderueshme, por ai po thoshte ato fakte që dihen dhe që nuk u shpëton dot.

-Megjithatë, -thashë unë, -janë disa gjëra të cilat duken si të padukshme, si të papërfillshme, por, në të vërtetë, për shkak të cilësisë, tharmit, mbeten të rezistueshme. Dhe këto janë veprat e mira, vlerat e vërteta.

-Ke të drejtë! -murmurimi ai...

-Bota e sotme është imazh. Jo gjithnjë imazhi e pasqyron thelbin. Njerëzit, jo të gjithë, janë si delet. Hyn një dele në lumë dhe të tjerat turren pas saj...

-Sërish ke të drejtë, -përforcoi ai.

Në tavolinë erdhi kamarieri dhe solli dy uiski.

-Po këto?-pyeti profesori.

-I keni nga Arjani...

-Ktheji mbrapsht, nuk pi! Ti do?

-Jo, -thashë.

Atë që quhej Arjan, profesori e sqaroi më vonë. Ishte një nga kalemshinjtë, siç e quante ai, që donte të merrte doktoraturën.

TRE TREGIME

nga Qazim Shehu

Ai kishte vjedhur pasazhe të tëra nga librat, i kishte montuar dhe kishte zhgarravitur një biçim teme, që ai nuk do t'ia miratonte kurrë. Dhe ky Arjani, si për kast, i qepej mbrapa, pa i rënë në sy dhe provonte ta qeraste, për ta marrë me të mirë.

-Harruam thelbin e bisedës, -foli profesori, -e kishim fjalën te FK. Edhe unë e kam mik, por ...

Ai heshti një hop. Mos vallë shumë po hapej me mua? Mos nuk duhej ta niste atë bisedë? Nuk mund ta kuptojë mirë në atë rast. Ku e kishte prekur FK, për çfarë debatonin dhe a ishte i zoti FK, mjek, të futej në terrenin e tij? Doja t'ia thosha këtë profesorit, por në përgjithësi nuk më pëlqejnë rrënimet, ato gjithësesi tregojnë mungesë edukate dhe mbeten të pahijshme. Këto mëdyshje të mijat, të vogla, nuk do të ndërkeqmbeshin shumë, sepse profesori vijoi:

-Po më mirë të flasim me fakte. Ja çfarë i shkruaj. Ai e rindezi telefonin dhe filloi të tregojë mesazhet:

FK: I dashur profesor! Ju në një shkrim tuajin ngrini lart figurën e diktatorit, i cili ka qenë një kriminel. Ju nuk bëni mirë, i nderuar, sepse me këtë rast, e ulni reputacionin dhe atë emër të mirë që gëzoni.

Profesori: Unë nuk e prisja këtë gjuhë nga ty. Jam historian dhe si i tillë mbështetem në fakte, dokumenta, që për mua kanë rëndësi të dorës së parë. Nëse do të dalin dokumente të reja, unë do pajtohesha me ty.

FK: Çfarë dokumentash doni profesor? Një Shqipëri e varfër si trashëgim, e izoluar, njerëz të futur nëpër burgje, të internuar, të pushkatuar...

Profesori: Unë nuk bëj analizë sistemesh. Çdo sistem ka elementët e zhvillimit dhe të frenimit. Po e përsëris: Jam historian dhe mbështetem mbi fakte, të cilat zbulohen nga dokumentat. Por, meqë ra fjala, te sistemi, dua të bëj një pyetje: Cili sistem të bëri mjek ty, të çoi për specializim në Francë?

FK: Pse pashë botë me sy, që atëherë fillova të ndryshoj.

Profesori: Gjepura!... Të ndryshosh tani është shumë lehtë, por kjo mbetet e pabesueshme.

Kjo fjalë (gjepura), FK nuk i kishte tingëlluar mirë. Ai më poshtë e kishte ulur nivelin e komunikimit të fjalëve duke u dhënë atyre një përdorim paksa banal, me një regjistër ku shpesh ligjërimi ndërpritej dhe fjalët kërcisnin në thyerje sintaksore.

I lexova shkarazi. Nuk doja të lexoja më. Ç'vlerë kishte? Debat i njohur që, sa herë ndodhte, e shmangja duke imponuar një temë tjetër.

-Nuk ke qejf të lexosh më? -tha profesori. -Ndihehesh i lodhur?

-Paksa, -thashë. -Profesor, ai është miku im, miku yt...

-Parimisht po! Veçse, nëse unë do të hiqja dorë nga e vërteta, nuk do të isha ky që jam.

-Profesor, -ndërhyra, -e vërteta, thotë një proverb, rri gjithnjë në fund të pusit...

-Edhe nëse nuk e kam arritur, i jam afruar asaj me ndershmëri... -vijoi ai.

"Pra, ky po shkoka drejt fundit të pusit, për t'u mbytur në marrëzinë e tij", ndërmenda, por nuk ia thashë me zë. Nuk doja ta fyeja. Ç'nevojë kisha?

Sesi m'u ringjall një dëshirë e beftë për t'ia lexuar ato çfarë ishin shkruar. Ndoshta ai do të kënaqej ose do shkente drejt bindjes se unë do ta shfaqësoja në lidhje me këtë debat pa bereqet. Dhe lexova: "FK, megjithëse ju jeni një mjek i talentuar, i keni shpëtuar jetën gruas sime, në fushën e historisë mbeteni një nxënës i mirë dhe në provim do t'ia kisha vënë katër".

E lëshova me kujdes celularin mbi tavolinë, me kujdesin se mos thyhej. Duart më dridheshin lehtë dhe ndjeva një pezmatim, të cilin ma shkaktuan ato fjalë, sikur të me qenë drejtuar mua.

-Profesor, -i thashë, -është e vërtetë që ai u ka shpëtuar gruan?

-Po, po, por kjo nuk ka rëndësi para së vërtetës shkencore.

-Po e vërteta shkencore nuk është absolute. Nga se vuante gruaja jua?

-Nga zemra. Shumë mjekë nuk i dhanë shpresë. Është e vërtetë, ai e shpëtoi...

-Profesor, këtu mbaron debati, -thashë.

-Ti nuk ke asnjë të drejtë.

Ai më pa i habitur...

AUTOIRONI

Dola në qendër të qytetit të takoj Fredin. Atij i kisha redaktuar një libër me një parathënie shoqëruese. Libri i tij, një monografi për një krahinë të largët, më pëlqeu. U ulëm në lokal dhe vura re se Fredi mbante të mbështjellë me një letër të bardhë librin e ri. E vuri mbi tavolinë, pastaj hodhi vështrimin nga lokali, kamarieri nuk po vinte. Atëherë u ngrit vetë dhe erdhi pas pak duke murmuritur:

-Ta hajë drejt! Kamarieri merrej me celularin, ulur diku, na shihte ne, shihte celularin dhe nuk vendoste të vinte. I fola.

-Ikim, -thashë.

-Tani presim!

Erdhi kamarieri, një djalë i zeshkët me një mjekër të mprehtë mbuluar me qime të zeza.

-Çfarë do merrni! -tha i zemëruar. Kjo u ndie në tonin e zërit të tij.

-Çaj! -thashë. Dy çaj...

Ndërsa po pinim çajin, erdhi pranë nesh studiuesi ST: e njihja prej kohësh, shkruante monografi, studime dhe artikuj. Dy libra ia kisha lexuar dhe më kishin pëlqyer. Ishte pasionant dhe me sa e kuptoja unë nga leximi i librave të tij, ngulmues. Ai bëri të ulej në tavolinën anash, por e ftova. U ul duke psherëtirë.

-Mirëdita sot, pranverë e vërtetë, -tha.

-Që në mëngjes vapë, -plotësova.

Ishin fjalë sa për të nisur bisedën. Studiuesi ST, vuri në një karrige bosh çantën e tij të zeze dhe psherëtiu sërish, nuk ishte kjo psherëtime një efekt pranveror, s' dihej se çfarë e mundonte. Si zakonisht me njerëz të tillë biseda nis për fushën e tyre, për punimet shkencore, literaturën, të rehat nga botimet dhe, siç e kam zakon, nuk flas kurrë për gjëra që nuk i di ose i di përgjysmë. Sa po bëhesha gati të flisja për një studim të ST, që e kisha lexuar kohët e fundit, studiuesi ST e mori fjalën:

-Ju nuk jeni ftuar?

-Ku?

-Te Muzeu Kombëtar. M'u vardis DGJ, i cili ka ardhë nga Italia. Ka shkruar një libër rreth pesëqind faqe. M'u lut të diskutoja, po çfarë të diskutosh? Përralla! Ky njeri ka shkruar për të gjithë fiset e fshatit, krahinës, çfarë mban mend ai, nuk ka lënë njeri pa përmendur...

-Mirë ka bërë! -thashë, -në fund të fundit kjo është memorje.

Atij nuk i erdhi mirë që unë i thashë kështu. E pashë sesi i lëvizti një muskul i vogël në faqe, por nuk e dha veten, u vetëpërbajt. Aty për aty u ndërmenda se ai kishte të drejtë. Këto botime dihet se çfarë brumi kanë. Sot, epidemia e fjalës së harxhuar pa kriter është e madhe. Shkruajnë për fiset, për njerëzit, për gjysh- stërgjyshërit, monografi, kujtime, autobiografi, dhe libra të tillë paraqiten para një publiku të madh. Dhe natyrisht me një koktejl të bollshëm. Dikur kisha menduar se libra të tillë duhen, se janë një dëshmi, por sot ky mendim më ka ikur. E përse duhen? Çdo njeri në këtë tokë e ka një histori, por a ia vlen ajo të bëhet e tjerit, a krijon një ngjashmëri, a ka një thelb filozofik dhe, nëse ka, sa rrezaton ky thelb në të ardhmen?

Studiuesi ST, si t'ia kishte kuptuar mendimet e mia, foli:

-Mbrëmë gjithë natën e lexova, kuptohet, nëpër të. Është një kronologji bajate, pa strukturë, një shkrim i thatë, pa asgjë interesante. Nuk desha të shkoj, por bashkë kemi punuar në një gazetë lokale dikur, është, si të thuash, një miqësi e vjetër... Nganjëherë shkohet për kortezi.



-Por ti mund të mos flasësh, -thashë.
-Më ka zënë rrasa bishtin. -Po nuk fola unë, kush do flasë?E ke vënë re, miku im, besoj edhe në raste të tjera, të gjithë flasin pa lexuar librin. Është bërë modë kjo. Ka njerëz frazistë sa të duash, ata kanë një aftësi të çuditshme për të mbushur sallën me fjalë, lavdërime e kujtime, sa të ngjan se të hedhin fije kashte te këmbët. Madje e fillojnë diskutimin kështu: "Megjithëse s' e kam lexuar librin, po them nja dy fjalë". Besoj jam i vetmi që e kam lexuar atë libër...

Fredi, që deri atëherë kishte heshtur, nxori stilolapsin nga xhepi dhe i shkroi një dedikim, duke ia dhuruar librin studiuesit. Fredi ishte studiues i ri, por mjaft i zoti.

-Ti shkruan mirë, -tha ST, -nuk dua të bëj elozhe, unë s' di të bëj qejfin kot...

Fredi u skuq pakëz dhe nuk tha gjë. Pas një heshtjeje të natyrshme, ST vijoi:

-Kurse ai DGJ e ka katranosur fare.

Pas pak, ai u ngrit. Mori çantën dhe tha:

-Erdhi ora, më duhet të shkoj, ju do të vini?

-Jo, -thashë unë, -ne nuk kemi ftesë.

Pasi pagova, i thashë Fredit se duhej të shkonim atje. Fundja, promovim ishte. Nuk ishte keq të dëgjoni ndonjë një orë. Një veprimtari, sido që të jetë, shpërfaq diçka, një vlerë, sado e vogël. Fredi nuk deshi, por unë ngulmova. Ai pranoi.

Salla ishte mbushur plot. Në tribunë, panel siç i thonë, rrinte autori, një përfqësues i pushtetit lokal, ST, moderatori. Të gjitha diskutimet ishin njësoj. Fillonin me jetën e autorit, me atë çfarë kishte shkruar (asgjë për strukturën e librit, idetë, gjuhën, stilin) dhe përfundonin me lavdërime dhe madje me propozime të tilla: I propozojmë bashkisë që autorit t' i jepet certifikata e qytetarit të nderit.

ST kishte pasur të drejtë. Gjithë kjo autoironi që zdërhallet brenda një vetkuptimi të sinqertë, që nuk është e tillë. Me siguri ai do të përmbysë diçka ose do ta shuajë pak atë zjarr pasioni të lig. Njerëzit duhet të jenë më në këmbë në tokë, më të arsyeshëm. Dhe nuk vonoi, ST u ngrit, shkoi në katedrën e foltores dhe ia nisi:

-Libri që po promovojmë sot, është një nga librat e rrallë që kam lexuar. Të them të vërtetën, për DGJ, të cilin e njoh, kemi punuar bashkë, nuk e kisha këtë pritshmëri, por njeriu evoluon. Që kur ka shkruar në emigracion, s' jemi takuar. Ky libër pasyron një pjesë të rëndësishme të historisë kombëtare. Krahina e tij ka qenë një bastion i fuqishëm kundër hordhive të huaja. Libri ka informacion të bollshëm, portete njerëzish të gdhendur me mjeshtëri, gjuhë të pasur dhe ide të thellë. Pa frikë mund të them se DGJ është njeriu-institucion.

ST e ndërprente disa herë me duartrokite, ndërsa unë i thashë Fredit se duhej të dilnim dhe ashtu bëmë. Seç kisha një ndjesi të zënies së frymëmarrjes dhe një therje të lehtë në gjoks.

KEKUPITIMI

E shoh vazhdimisht në lokalitë e lagjes dhe më përshëndet, po ashtu edhe unë. Nga pamja, me trupin dërdëng, kokën e madhe dhe hapin e shtrirë, duket se i ka punët mirë, këtë ta jep edhe ngeja që e pushton teksa rri me orë të tëra dhe thërret në tavolinë njerëz që nuk i njoh, disa po, me të cilët bisedon dhe flet me zë të lartë.

Sa herë e takoj apo shkëmbehem me të, më thotë: mirëmbërë apo mirëmëngjes profesor. Në të vërtetë s' dua të më thërrasin me këtë titull i cili është konsumuar, aq sa po e humbet rëndësinë e tij, sipas përshtypjesjelljes që më sjell ky përdorim i shpeshtë vend e pa vend. Dhe unë ia kthej përshtëndetjen: mirëmbërë Mark, si po ia kalon? Ai ma kthen me zërin e tij buçitës: Ekstra fare. Këtë fjalë e kam kuptuar në këtë kontekst, si jashtë problemeve të

zakonshme që kanë njerëzit, anash tyre, duke i vëzhguar me sigurinë e njeriut që i ka punët në rregull. Përshëndetemi po kurrë nuk jam ulur me Markun, as më ka ftuar ndonjëherë, as dua të më ftojë. Dhe ai e kupton këtë, unë po ashtu. Megjithatë seç kam një dëshirë t' i flas, sepse e kuptoj se ai ka një nderim për mua, një nderim që s' di si ta shpjegj, po kjo më jep një engledisje të mikluar, një farë përkëdhelje të fshehtë në sedër. Janë gjithnjë ca njerëz që duam t' i afrojmë duke i mbajtur larg dhe kjo mbetet e pakuptueshme dhe as nuk dimë ta shpjegojmë pse. Atyre u është fiksuar se ne jemi ata çfarë mendojnë ata dhe ne i kuptojmë të tjerët çfarë mendojnë për ta. Dhe ja një mbrëmje maji, kur blirët vërshonin një aromë në trotuar, Marku më thirri:

-Profesor a ke kohë të pish diçka?

-Jo Mark, unë kurrë nuk pi në mbrëmje..

Po Marku u ngrit nga tavolina, duke tërhequr hapat rëndë-rëndë, dhe më futi krahun.

-Ti, -tha ai, -pi çfarë të duash?

Ishte herë e parë që më ftonte në tavolinë. Njerëz nuk kishte përreth dhe, siç dukej, i ndodhur vetëm, ai e donte një njeri si shoqëruar. Nga kjo më erdhi pakëz inat, por nuk mund të tregohesha i pasjellshëm. Zakonisht mbrëmjeve dal dhe shëtis në rrugët e lagjes, vetëm, krejt vetëm. Nuk më pëlqen të ulem me njerëz që pinë dhe rrinë pranë gotës së rakisë si të kapur në pëshpëritjen e një rituali. Kjo është natyra ime prej profesori, siç do të mendonte Marku. Por jo, nuk është kjo. I tillë jam, të ndenjuri me njerëz e kam dëshirë, por nuk mund të rri me këdo, dhe kjo, më tepër se nga mendimi, vjen nga një dëshirë instiktive.

-Profesor, -tha Marku, -çkemi? Çthotë universiteti?...

-Mirë, -thashë, -çfarë mund të kemi, të zakonshme Mark...

-Ju profesorët keni punë të vështirë, por fisnike...

Shumë njerëz kanë një mendim tepër pozitiv për punëtorët e arsimit, ose neglizhuar. Nuk më pëlqen asnjë nga këto dy qëndrime. Sidomos ata të mendimit nënvlerësues, të cilët thonë se arsimtarët nuk janë shumë mendjekthjellët. Dhe kush e thotë, ata që kurrë nuk kanë lexuar një libër. Në përgjithësi, për njerëzit e librit të dijes, ekziston koncepti i hutaqit, harresëtarit dhe kjo është kuptueshme, sepse ai që provon të dijë, të zhytet në të, nuk mund të sëkëlliset me gjëra aq të thjeshta praktike, që merret një që nuk di.

Marku foli:

-E di pse të thirra profesor?

-Nga ta di?-thashë.

-Unë kam një hall.

-Fol!

-Një nipi im është në universitet. Ai ka mbetur në dy lëndë. A mund ta ndihmosh të kalojë...

-Mark, -thashë, -në cilin universitet është?

-Në Universitetin Bujqësor...

-Por unë nuk punoj në universitet. Unë jam mësues gjimnazi, -i sqarova.

Pashë se Marku uli kokën. Ai mbase nuk e kishte pritur këtë...

-Po kë mund të gjejnë ndonjë profesor nga universiteti, që mund të na ndihmojë?...

-Nuk njoh asnjë, -thashë.

-Asnjë, asnjë?...

Ai sërish ishte këmbëngulës. Çuditërisht! Por, edhe unë, i mësuar të them atë që është, nuk dua të përfitoj nga momenti, përveç ndonjë gotë rakie sa për mirësjellje, për të mos e fyer ftuesin. Erdhi kamarieri:

-Më falni, -tha, -u vonova, çfarë do të merrni?

Unë heshta, fjalën e kishte Marku.

-Asgjë, -tha, -jo, jo nuk duam gjë!...

SHQIPONJË NË QIELLIN TONË

nga Delvina Kërluku

Edhe kjo e shtunë, si shumë të shtuna në kryeqytet, më gjen në dhomën time.

Dhomën më modeste dhe më të dashurat nga çdo dhomë tjetër. Aty jam vetja. Më shoqërojnë librat, kujtimet, malli dhe vetmia. Por kjo vetmi, nuk është si çdo vetmi tjetër. Është e veçantë, pasi nuk më lë vetëm. Më shtyn të krijoj personazhe letrare, të cilëve u jap jetë, pra i bëj të gjallë që të më shoqërojnë pastaj. Në dhomën time hynë vetëm drita – ditën e diellit, natën e poqeve elektrike. Hë, pra harrova: edhe drita më bën shoqëri. Nga shumë gjëra që më mungojnë në dhomën time të dashur, por jo edhe të ngrohtë përherë, janë edhe rrezet e diellit, pasi të vetmen dritare që ka, përballet me Veriun. Më thoshte nëna: mos merr shtëpi në Veri, se do të marrë malli për një rreze drite, por ec e zgjidh në kryeqytet. Këtë këshillë kisha dëgjuar shpesh, edhe nga të moçëm të tjerë: Jugun zgjidh, por edhe Lindja e Perëndimi, s'janë për t' u sharë.

Qetësia në dhomë më jep kënaqësi pas lodhjes në zyrë, por edhe nga vrapim maratonomak i gazetarisë. Dëgjohet vetëm zhurma e makinave që furnizojnë dyqanet përreth me ushqime dhe artikuj të tjerë të konsumit të gjerë. Sidomos kur u çel kjo shitorja e re përballet dritares së dhomës time. Me javë ka zgjatur zhurma. Po kush të pyet: luftë për ekzistencë. Eh, ligje tregu: mbyllet një biznes sot, dy i hapin dyert nesër. Edhe Çarshia e vjetër e Shkupit, me këto ligje gjallon. E, kur përmendi shitoren e re, nuk harroj t'ju tregoj se në fillim, më mbetën sytë tek ajo. Pronari me gjithë familjen, lanin e fshinin çdo cep: me dyer e dritare, dysheme e tavane, rafte e tavolina. Edhe atë pak trotuar në hyrje, xixë e bën. Ia kisha lakminë vullnetit të tyre. Shpresonin dhe besonin se ky dyqan do t'ua transformonte jetën, prandaj kishin angazhuar gjithë atë energji. Inshallah! Unë dilja në atë copë ballkon të vogël të dhomës time gjithashtu të vogël, e ngazëlleshja me punën e tyre aq

entuziaste. I dëgjoja edhe bisedat midis tyre dhe urimet e kalimtarëve të njohur e të panjohur. - Urime Hasim! Të vaftë mbarë! - Faleminderit. Zoti na ndihmoftë të tanëve mos me e braktis vatanin. Ma mirë zotni në fukarallëkun tand, sesa shërbëtor i të pasunve të botës - ua kthente Hasimi. Edhe unë i shoqëroheshja urimit të tij, me gjithë zemër, e pa zë, kur i shihje rrugët e shkretuara, shtëpitë e kyçura, mësonjëtoret me një grusht nxënësish. Kah do që i hidhje sytë, kah do që të shkel këmba.

Shqiponjat shpesh kishin marrë fluturimin edhe në Perëndim. Aty, shqiponjat, gjenin bukë, paqe dhe drejtësi. Këtu, në Ballkanin e thepisur, shkon kot për një kothere buke, për pak drejtësi e për më pak barazi. U mundova ta bind një shqiponjë se edhe këtu mund të jetohet, ose: edhe ky vend mund të bëhet i përshtatshëm për të jetuar, por s'arrita dot. - Me urrejtje, zili, xheloz, padrejtësi, dembeli, zhvatje..., s'bëhet, më tha.

Por mua më mbetën sytë dhe mendja te dyqani i ri dhe impenjimi i milingonave, për ty ndryshuar këtë realitet, për të bindur veten dhe botën përreth, se jeta dhe fati ndërtohet me pak sakrifica.

Pastaj, me arritjet e furnizimeve, nisi të shpërndahej edhe aroma e sendeve që tregtonin. Si të atyre ushqimore, ashtu edhe të artikujve për mirëmbajtjen e pastërtisë trupore dhe ambientale. Aromë parfumeshe dhe detergjenteshe bashkë. Kutërbimi i erërave të gjellëtores, është tregim më vete. Depërtonin në dhomën time, bashkë me bezdinë, edhe nëpër të çarat më të ngushta të derës dhe dritares. Prejardhjen e këtyre plasaritjeve nuk e mësova dot, mbase ishin nga ndonjëri prej tërmeteve të shumta që e dredhin këtë qytet. Ky vend është sprovuar me tërmete, edhe me luftëra. Të të gjitha llojeve dhe natyrave.

Njëra nga shqiponjat e mërguara, më shpotiti: Ju poetët vetëm ëndëroni! Por ajo nuk e dinte faktin se ne poetët me hijen tonë e kishim bërë Atdheun.



Strumbullari i diellit je ti
që depërton poshtë nëpër
barin tim të njomë
ndriçuar nga lëngjet e ëmbla
që zgjohet nga prekja jote

Diell mund të jesh tani
që ngre përpjetë pyllin tim të prerë
e tërheq nga vetja dhe hyn nëpër
vjollcëgështenjen e trëndafilkuqen
drejt buzëve mbërthyesë që thërrasin
për t'u gjetur

Valëzat godasin klap-klap
fundin e anijës sime
Gjëmime të gjata vijnë
drejt bregdetit tim
Valë të zjarrta me lavë që mbulojnë
tokën time

Tani janë qetësuar paksa
janë tërësisht të qeta e lehtë të shuara
derisa buzët përsëri të thërrasin nga larg
dhe ti të vish pa i dëgjuar

Ende po dridhem- ti më ke tronditur
më ke tronditur thellë -
ti ke prekur diçka
shumë thellë në mua
Nuk mund të bëhej ndryshe

Unë po vdes
ti po i mbulon të tëra
themelet e mia
unë këlthas
në një tjetër vetëdije

Është rrezik
për jetë a vdekje
Kur hap sytë
ti më ke lindur

Ti më kryqëzon
Unë vdes
ti më rilind

ti hedh lëngun tënd drejt vrimës sime
unë jam toka ku ti hedh lëngun
unë jam shkëmbi drejt të cilit ti vibron
jam bregu ku ti lëshohesh
Në vrimë e përzijmë lëngun
e shpërndajmë gjithandej
e përzijmë dhe ripërzijmë
lëngun e dy botërave
një e tretë krijohet
jashtë nesh
dhe e jona

Sonte shpërtheu një enë gjaku
u zgerua shpejtë
doli jashtë e nxehtë ngjyrë purpuri
në seksin tënd

e ndjeva shkrehjen
e purpurit të nxehtë
ty të ndeshi një liqen i vogël
i kuq

Janë duart e tua
me të cilat ti flet me mua
jo fjalët apo sytë
me asnjë pjesë tjetër
tënden
si me duart e tua.

Prandaj
nëse më pyet
si është malli im për ty
do të përgjigjem

Është dora jote.

Dora ime në dorën tënde të ngrohtë
dora jote në qafën time
dora jote në errësisirë
dora jote rreth zemrës sime

Strumbullari i diellit je ti

poezi nga

ANN SMITH

1930-2018

Përktheu Qerim Raqi



Ujë gjallë je ti në mua
gjithandej me mua.
Lëngun tënd e bartë në një legen
ujë i gjallë i lëvizshëm
me ngjyrën e hënës ndriçuese me tufa të
vogla bore
me fara të vogla të nxehta që
vrapojnë përreth.

Lëngun tënd e kam me vete
kur eci
nuk e lëshoj
e mbaj brenda në mua

Dua ta kemë me vete
kur kaloj urën
dhe takoj njerëz në mëngjes.

Ti më bënë që t' i dua njerëzit
dhe gjithë botën kur ti
hedhë lëngun tënd shi
mbi shkëmbin tim

Herdhet e tua në dorën time
pulsu yt shteg i enëve të mia të gjakut
i ëmbël trupi yt për buzën time
e puth ajrin sepse ajri
je ti

Si rrebesh shiu
ti shkrehesh në mua

më mbulon me
borë të ngrohtë

rregullon për ne të dy një fole
në buzëqeshjen tënde

Sa i bukur bëhesh nga epshi
fytyra mollëzat e faqeve të plota
të tëra me mirrë vërshuese

Sa i bukur je
kur merr
si një fëmijë

Sa i bukur që je
me duart e shtrira
si shpirt dielli

Atëherë unë dua të hidhem mbi mirrë dhe
skumri
të t' i mbërrij të gjitha vrimat
të tëra gojë
të tëra pusët e hapura.

Me shi më është mbushur dhoma
shumë e pasur jam tani me shi
me pasuri të blertë
me freski shiu

Si një zog
i ngrohtë që pulson je ti
në mua

I paqëndrueshëm dhe i fuqishëm
shkrehesh

Tani rritet
bota ime
përkëdheluese

E kam parë tek ti
shikimin që unë e dua
ti kafshon frutin e jetës
që kurrë nuk do të
marrë fund

Ai që mund
të kënaqet kështu
ai është i dashuri im

Mendimet e mia kënaqen tek ti

dhe këmba ime ka mall për dorën tënde

Më pëlqen të vij tek ti
në mëngjes
kur ti je i rëndë, i nxehtë dhe i butë
një fole e butë një mullar bari
mbuluar me trupin tim

Dashuria ime është e menjëhershme
sepse ti nuk zbrapsesh
por më lë të qëndroj
Me ty dua të vazhdoj

Kam mall për dorën tënde të ngrohtë
dhe barkun tënd që më përshtatet

Sonte kalëroj kuajt e mi drejt
asgjëje

Sonte nxitoj kah deti
ku vera është akoma
ku lakuriqi i natës godet mbi ujë
dhe skajet e mëdysjes përcjellin valët
nën dritën e hënës

Unë të marr dritën e hënës mbi ujë
dhe etjen e barit të njomë
dhe me qejf dritën mbi qiell
ku dita merr fund
dhe ndizet ylli i parë i natës
kur kalëroj kuajt e mi
drejt hënës

Sot kënaq veten time
sepse dua të bëjë dashuri

Sot i tërë trupi është
i gudulisur në lojë ledhatuese
sepse ka dalë nga përqafimi yt

Ti erdhe
erdhe vonë
unë vuaja si një shtazë
nga shqetësimi nga plaga
nga dyshimi
pa ty e lënduar
çdo orë e mallëngjyer
nata e bardhë tërhequr
mëngjes i pavullnetshëm

Ti më ke bërë një grua të zakonshme
që nuk dëshiron
të jetë vetëm
që dëshiron të jetë vetëm
me ty

Nuk ka dritë më të fuqishme
se drita në sytë e tu
Më e fuqishmja dritë është
drita në sytë e tu

Nuk ka asgjë tjetër që shkëlqen
sikur sytë e tu në mëngjes
dhe kur i shoh
shkëlqejnë edhe sytë e mi

Kur më thua
e dashur
ti bënë një pretendim
në mua.
Jehona e kësaj
fjale
mbulon krejt trupin tim
dhe e bënë të këndoj.
Kjo fjalë, e dashur
është shi për trupin tim

Unë përkëdhel trupin tim
tërë kohën
për ta ngushëlluar.
Zëri yt është aty brenda

por më thuaj
çfarë të bëjë trupi im
pa ty

Unë ledhatoj trupin tim
tërë kohën
pa ty
Dëgjoj shiun
Shi bie në zemrën time
por çfarë të bëjë trupi im
tërë këtë kohë të gjatë
pa ty

Sot vetknaqem
sepse unë jam i dashuri

Sot i gjithë trupi im
i eksctuar lozë ledhatueshëm
ngaçë ka dalë
nga përçafimi yt

Unë asgjë nuk di për ty
por dua të të shoh
kur bëjmë dashuri

Ta masë shkathtësinë time
me shprehjen e fytyrës tënde?
Dëshiron që të shpërthej?

Dua që të jetë
aq i fuqishëm
sa ti ta harrosh veten tënde
dhe të bërtasësh

Fillimisht u ndez një dritë e vogël mes nesh
me një zjarr ndriçues
Ne e dinim që të dy se duhet të vazhdonte
të digjej
dhe i bëmë hapësirë, por pikërisht pse e
shihnim kështu ai
e kishte kryer misionin e tij dhe nuk e pamë
më.
Mbase u zhvendos në duart tua ngaçë unë
akoma
mund të ndjej copëza të vogla zjarresh tek
përfshijnë gjoksin tim.

Sytë e mi shtegtojnë tek sytë e tu.
Ato vëshetrojnë çdo detaj me radhë.
Duan të shohin secilën gjë veçmas.
Secilën balluke të zezë të flokut tëndë.
Është një pjesë e errët në nënsqetulla, një
tjetër mbi krahun tënd ndriçuar nga drita
Ka çaste që ne lëvizim me erën
si një trung dhe kurorë e vetme.
Ndoshta atëherë ne tingëllojmë si Një Zë i
vetëm, sikur kur vëmë veshin mbi një kalli
në erë.
E kam dëgjuar atë zë si një shushurim të
ngadalshme ere
që depërton thellë në brendinë e viteve të
pemës.
Kur shkruaj kështu sytë më mbushen me
lot dhe
dhe goja me krip
Ç' mall është ky që na afron me origjinën
tonë
sikur të rridhnim nga deti?
Unë kam notuar një herë nën hije dhe kam
parë thellësinë
dhe e kam ndjerë se si më tërheqte.
Fëmijët nganjëherë mendojnë se kanë
dëshirë të vdesin në det.
Por kripa që vie në sytë dhe në gojë
është shenjë e jetës, është thellësia
që vie mbi sipërfaqe, pra lëre të ngrihet,
qetësinë,
është aty afër.
Duart e tua krijojnë nga trupi im gjire deti
ku uji ka qejf të rri.
Ato bëjnë njolla nëpër stomakun tim
një kërpudhë vjollcë me një kapelën
valore bëhen një.

Kur të mplakesh do ta kuptosh, thua ti
Unë jamë një pjesë e jetës tënde.

VARIANT PËR DITË TË VERBËR

nga Arben Velo

Alfabet i bletëve

Ngatërruar Prilli në pjalmin e luleve
është bërë lot bletësh..

Unë lotin e bëj orë të mas trishtimin
e të bukurës paemër.

Një çurgë bletësh po gumëzhijnë
në kosheren e syve të mi.
Poshtë barkut të tyre, si Odisea dikur
pres të bukurën dhe rri...

Dhe nis të shkruaj me thumbin e bletëve
ca gërma të pashpikura i gdhënd
çdo thumb bëhet shkrepse, të ndez qirinjtë
e gërmave të emrit tënd!

Variant për ditë të verbër

Tërë ankth ngjan qyteti, s'di si ta qetësoj
Nga një grusht zogjsh, është një zog më pak,
qaj moj dita ime me zërin e ngjirur
dalë nga fyti i kësaj çafke të vrarë.

Më ngeci dhimbja brenda fytit
si manaferrë e papjekur ende
Cili shënues gjeti terrin për të të vrarë
në botën e vrarë prej njerëzve?

Në sytë e të verbërve të krijuar prej nesh
Cafka e vrarë mbi bar
vesh nallane prej resh...

Gjyshja prej Hëne!

Kërcasin shirat e Prillit
si menteshat e baules së gjyshes.
Pafka e sheqerit është bërë një hënë
racioni që gjyshja prej kohësh s'më ka dhënë.

E mira ime e kthyer në Hënë ...
dritë e kursyer,
brerore më rri mbi kokë...
kërcasin menteshat e baules së qiejve
derdh gjyshja prej hëne, sheqer mbi tokë!

Simboli

Me një kokërr gruri në sqep
dhe kujtime brenda gushës futur
Një harabel krahëhapur kërkon
një harabele të bukur

Deri dje gruri ishte qeshje stine
tek hidhej nga sqepi në sqep
Sot u blua lot,nën një gomë makine
e ardhur si një i zi ortek



Dhe befaz kokrra e grurit, u kthye
nga ushqim, një dhimbje e tejmbushur
loti i zogut, në dy pjesë e ndau
një vijë fati, përmes e këputur

Njerëz,nëse shihni harabela rrugës,
kërkojnë një tempull, si pelegrinë
falen para kokrrës së grurit
me cijatje që përkthehen "Amin"!

Ikja jote

Ike, Unë ngela bosh si gropat prej dheu
të braktisura anës Përroit të gjakut,
Dy- tre lëkura më ranë, u bënë baltë vapem
për të mbështjellë plagët ...

Na zunë puthjet nën vete këtë dimër
si zënë dherat nën vete gropat në mjegull
Njëzetë gishtat tanë fluturojnë kah njëri
tjetrit
e kthehen në tufa me gerguj te egër...

Vdekja e Lamit (ruajtesit te buajve ne Divjakë)

U kyçe në syrin e Buajve
Lam..
Për të zotin
në varr e kthyen syrin që qan...!

Etyd

Po ndez llullën e zjarritë trëndafil
në syrin e një vaje të qeshur
Në mangallin e kuq të tij
nëntë rrathët Ferri ka ndezur?

Elegji për një rrap.

Ky dimër i pa ardhur,
do të jetoj,
sa një qiri,që e ndez lamtumira
e një rrap.
Njëqind vjet më pare,
Pemës,
mbështjellë me dhera,
si foshnjë kërthinj,
qerrtarët i këndonin ninullë
legjendën e Ali Pashës.
Trupin ia sollën në Fier
rrënjët ia lanë në Janinë.
Njëqind vjet toreadoret e erërave
fshehur pas dimrave
e goditën deri në dhimbje.
Një ditë,
në breg të Nëntorit, i tretur
Ai ra dhe u këput mbi supin tim
nën një qiell
si mizanskenë e Traviatës.
... çdo dimër kur më lutet të vdes
trupin ka në Fier
këmbët në Janinën e Ali Pashës.

Një dukuri e papritur u shfaq në sistemin e të menduarit teorik të studiuesit të shquar Cv. Todorov, i cili njihet si një ndër përfaqësuesit e strukturalizmit francez. Botimi para disa vitesh i librit *Letërsia në rrezik*, (2007) jo thjesht befasoi, por rihap për diskutim çeshtje thelbësore që kanë të bëjnë me thelbin e shkencës letrare, me raportin e veprës letrare me autorin, me kontekstin historiko-kulturor dhe me lexuesin. Dihet kalimi i vullshëm i këtij teoricieni të njohur nga shkolla bullgare, që ngrihej mbi teorinë ideologjike marksiste, tek strukturalizmi, që ishte mohim ekstrem i kësaj shkolle. Duke iu referuar tezave të Formalizmit Rus, mbi të cilat u mbështetën strukturalistët francezë, Todorov zhvilloi më tej teorinë e narracionit. Por, papritur, mbas gjysmë shekull, shfaqen teza që duken si kontradiktore me pikëpamjet e mëparshme të tij, duke iu rikthyer shpjegimit mbi një marrëdhënie të re me autorin si dhe mbi misionin e letërsisë. Konceptet mbi shkencën dhe objektin e saj, letërsinë, rishfaqën në një qasje më të gjerë, larg sistemit teorik strukturalist. Çfarë vlere ka kjo në përpunimin e mendimit të sotëm teorik-letrar?

Duke undalur në disapikëpamjet teorike që trajtohen në veprën e këtij teoricieni bullgaro-francez, i cili u bë i famshëm në mjedisin kritik francez të viteve '70, theksoj që në fillim se interpretimi nuk ka lidhje thjesht dhe vetëm me këtë vepër, por me metodologjinë e interpretimit kritiko-letrar. Më i rëndësishëm është diskutimi i shkaqeve të befasive që u shfaqën në mendimin e tij teorik, mbas 4 dekadash, lidhur me thelbin e studimit letrar dhe specifikën e objektit, letërsisë. Pyetja është: çfarë ndodhi në sistemin e të menduarit të këtij teoricieni të shquar? A janë pikëpamjet e fundit luhate, dilema apo dhe kontradikta në sistemin e tij teorik, të zhvilluar përkrah strukturalistëve R. Bart dhe Zh. Zhenett? Mendoj se janë dy aspekte themelore që duhen marre në konsideratë, për të kuptuar pse ky sistem pësoi një lëvizje të re, jo pak të çuditshme për ata që e njohin teorinë narrative dhe gjithë konceptin e tij mbi strukturën shenjore të tekstit letrar.

Së pari, Todorov, si bullgar, kreu studimet në universitetin bullgar, që mbështetej plotësisht në teorinë sociologjike-kulturore marksiste, të cilat mbizotëronin studimin shkencor jo vetëm në Bullgari por në gjithë vendet e sistemit komunist. Intuita jo e zakonshme e njohësit të letërsisë bëri që në heshtje të mos e pranonte dogmën, ndikimin e ideologjisë zyrtare në studimin e letërsisë dhe në pergjithësi të humaniteteve. Siç sqaron vetë, rruga e tërthortë e kapërcimit të kësaj dogme ideologjike u bë për të qasja tek dukuritë gramatikore që organizojnë tekstin letrar. Por, formim i parë me teorinë pozitiviste, sado që u mohua në vitet që erdhën më pas në Francë, kish lënë sado, pak gjurmë, që ose do dilte dikur, ose do mbetej fshehur në pavetëdijen e tij. Ky është një faktor i rëndësishëm që na ndihmon për të kuptuar sot kthesat e papritura në teorinë e Todorovit.

Së dyti, kontakti me teorinë strukturaliste të R. Bart dhe Zh. Zhenett në Paris, ishte një zbulim për vetëdijen e interpretuesit të letërsisë, i jashtëzakonshëm në metodologjinë e interpretimit strukturor-gjuhësor, duke zhvilluar me tej konceptet e Formalizmit Rus mbi dallimin e gjuhës poetike nga ajo praktike, duke thelluar vëzhgimet

A ndryshoi mendimi teorik-letrar i strukturalistit Cvetan Todorov?

Floresha Dado

mbi strukturën narrative të tekstit letrar. Depërtimi në thellësitë e teorisë strukturaliste ishte i vullshëm, ishte një përmbysje e sistemi teorik që sundonte shkencën letrare të vendit të tij, Bullgarisë, prandaj edhe kthesa ishte shumë e fortë, gati ekstreme. Ishte një lloj siç ndodhi me Formalizmin Rus që, duke mohuar shkencën pozitiviste në fillim të shekullit XX, kaloi në qëndrime të skajshme mbi mënyrën e interpretimit letrar. Tezat e mohimit të autorit, të marrëdhënies me realitetin, të ideve të veprës, etj. duke qenë ekstremisht radikale, mbas disa vitesh do të korrigjoheshin nga disa teoricienë formaliste, si M. Bahtin, i cili kish zhvilluar idenë se përdorimi i gjuhës në letërsi është edhe përdorim letrar, edhe social dhe ideologjik.

Ndikimi i këtyre dy faktorëve formues, nga dy sisteme teorike të ndryshëm, padyshim ka lënë gjurmë në formimin teorik të Todorovit, në vetëdijen por dhe në pavetëdijen; në kohë dhe momente të ndryshëm ato janë takuar brenda vetes, për të nxjerrë kokën, sado pak, në fazën e tretë të zhvillimit të teorisë së tij. Marrja parasysh e këtyre dy faktorëve është shumë e rëndësishme për të kuptuar sot lëvizjet e papritura në sistemin e këtij teoricieni të shquar. Mjeshtëri i analizës së rrëfimit, vëzhgues i hollë i dukurive të strukturës gramatikore të tekstit letrar, Todorov zhvilloi në një drejtim tjetër teorinë strukturaliste, veçanërisht në fushën e narratologjisë, duke identifikuar rrëfimin me gramatikën, duke u futur në strukturën e ndërtimit të frazës së tekstit



letrar, në logjikën e marrëdhënies të pjesëve të ligjëratës, në ndërtimin e skemës së raporteve të personazheve, etj. Nuk po hyj në tezat e rëndësishme që shtjelloi në fushën e interpretimeve strukturore-gjuhësore të tekstit letrar, në zhvillimin e kategorisë së transformimeve narrative, në analizat interesante të ligjërit letrar, mbështetur gjithnjë në tregues gramatikorë dhe sidomos në shtrimin për herë të parë të çeshtjes: "si na shpie një tekst të ndërtimi i një universi imagjinar? Cilat janë ato aspekte të tekstit që përcaktojnë ndërtimin, të cilin e përftojme gjatë leximit dhe në ç'mënyre?" (Poetika e Prozes) etj. sepse tani nuk është synimi të ve në dukje vlerat dhe risitë e teorisë narrative të Todorovit. Në këtë fazë të përpunimit të sistemit të tij teorik strukturalist, ndjehet fuqishëm refuzimi i koncepteve paraardhese të analizës... Në këtë fazë 'franceze' ai mbetet brenda në një skemë ngushtësisht teknike, analizat që i bën strukturës së personazhit brenda strukturës rrëfimore janë interesante, origjinale, ndonëse, sipas mendimit tim, në një farë mënyre e mekanizojnë personazhin, duke e bërë thujtë mjet që lidhet me mjete të tjera të rrëfimit. Kështu, duke shkuar te gjuha e tekstit, një kthesë e madhe në konceptin e analizës, Todorov stopoi në aspekte thellësisht teknike, për të braktisur konceptin se letërsia nuk është thjesht dhe vetëm skemë, por emocion njerëzor... Sigurisht, siç e thashë më sipër, kjo është faza e triumfit të lirisë së mendimit të teoricieni, që ndërton një teori origjinale, krejt ndryshe nga sistemi i shkollimit të tij në Bullgari.

Mirëpo, disa dekada më pas (viti 2007), trajtimet në librin *Letërsia në rrezik* dëshmuar se forca e logjikës (vetëdija) dhe intuita e jashtëzakonshme, do takohen, duke bërë që, në një farë mënyre, në disa aspekte, pikëpamjet e tij teorike mbi interpretimin e tekstit letrar të pësojnë një ndryshim. Madje përmbysje. Pyetja është: kemi luhate, kontradikta apo pikëvështrim teorik të ri, të vetëdijshëm? Mendoj se këto pyetje lidhen me dy çeshtje thelbësore, *metodologjike* e *kuptimore*: së pari me kuptimin mbi shkencën e letërsisë, se dyti mbi natyrën e objektit të saj, letërsinë. Duke hyrë në arsyetimin e Todorovit, mund të ndalemi në këto dy drejtime:

1. Si nisi lëkundja e parë (e vetëdijshme apo intuitive?). Duke rrefyer procesin që ndodhi me të, kur zhytet në analizën gjuhësore strukturaliste të tekstit, ai shkruan se iu desh të pranonte koncepte të psikologjisë, antropologjisë, historisë... "Meqë idetë e autorëve kishin aq forcë, me qëllim që t'i kuptoja sa më mire, kam dëshiruar të zhytesha në historinë e të menduarit mbi njeriun dhe epokat e tij,

LETËRSIA NË RREZIK

TZVETAN TODOROV



Përktheu nga origjinali frëngjisht
MEHDI HALIMI

BUZUKU

në flozofinë morale dhe politike” (f.13) Në mënyrë të papritur Todorovi i rikthehet rolit të kontekstit, realitetit, të mohuar nga formalistët dhe shkolla e tij strukturaliste. Bashkëteoricieni francez Zh. Zhenett kish pohuar se “Letersia është shikuar si mesazh pa kod, tani është e nevojshme të shikohet si kod pa mesazh”. Por Todorov në pyetjen që i bën vetes “edhe sot përse e dua letërsinë?” konfirmon rolin njohës të letërsisë, pohon se “ajo na bën që bota reale të bëhet më e ngarkuar me kuptimësi, apo “larg te qenit një argëtim...”. Merita e jashtëzakonshme e formalizmit kishte qenë se për herë të parë synoi të saktësonte specifikën dhe pavarësinë e shkencës letrare në raport me shkencën të tjera humane dhe se përcaktoi dallimin thelbësor midis gjuhës praktike dhe poetike. Todorov, duke ruajtur këtë vlerë të dyfishtë të kësaj teorie, që kish qenë një nga burimet e strukturalizmit francez, shfaqet tashmë me trajtim befasues, duke afirmuar në mendimin teorik të fillimit të shekullit tonë disa aspekte të mohuara nga teoria formaliste dhe më pas ajo strukturaliste (së cilës i përkiste prej disa dekadash), siç ishte realiteti, idetë e veprës, raporti me lexuesin, etj.

Lind pyetja: a mund të qëndrojnë këto pohime në sistemin teorik strukturalist të përpunuar prej tij, që mbështetet në teknikën e skemave të narracionit? A ka mospërputhje dhe a mund pranojmë një kontradiktë në sistemin e tij të menduarit, apo kemi një luhajtje që shkon përtej vetëdijes? (Vite me parë, ai kish kundërshtuar pikëpamjen e Niçes, i cili, në vlerësimin mbi Dostojevskin, shihte te letrarja psikologjiken, filozofiken, shoqëroren... Kthesa, nëse do ta quajme kështu, vjen te Todorov më e drejtpërdrejtë kur pohon “...mësojmë keqkuptimësinë e një teksti po qe se e shohim këtë nga një qasje rreptësisht e brendshme, në momentin kur veprat ekzistojnë cdo herë në kuadër të një konteksti dhe në dialog me këtë të fundit; as mjetet nuk duhet të bëhen qëllim, as teknika, që te na bëjnë të harrojmë qëllimin e ushtrimit” (f.23). Gjithashtu “...të krijosh një botë më të vërtetë nënkupton që arti të mos e ndërpresë lidhjen e tij me botën” (f.55).

Në fillim të shekullit XXI, gati një shekull mbas teorisë formaliste dhe një gjysmë shekulli mbas lulëzimit të strukturalizmit francez, mbi të cilat kish përpunuar teorinë e tij të gramatikës së rrëfimit, duke zhvilluar më tej konceptet strukturaliste, Todorovi befason lexuesin. Tashmë nuk e mohon qasjen e jashtme (tradita e vjetër e shkollës në Bullgari), por shprehet se qasja e brendshme (d.m.th. studimi i marrëdhënieve mes elementeve të një veprë) duhej të plotësonte qasjen e jashtme (studimin e kontekstit historik, ideologjik, estetik), apo kur pranose se letërsia është një laborator ku mund të njihet autori. Duke përvetësuar, tashmë, një traditë tjetër të analizës në shkollën franceze, e cila e konceptonte veprën letrare “si një objekt të mbyllur i të folurit, i vetëmjaftueshëm, absolut” (f.28) mendoj se kjo nuk është me luhajtje, por kthesë e rëndësishme në teorinë e tij dhe një kontradiktë me disa aspekte të sistemit teorik të mëparshëm. Është shumë interesante pikëpamja e tij se rënia e interesimit të nxënësve për letërsinë i ka shkaqet pikërisht te pikëpamja se letersia nuk qënka gjë tjetër përveç ilustrimit të mjeteve të nevojshme për analizën e saj” (29), apo se “letërsia flet vetëm për vete dhe se mënyra e vetme për ta nderuar atë është

të nxjerre në pah lojën e elementeve të saj përbërës.” (f.31). Pohimi i tij se “Letërsia imagjinative dhe shkrimet shkencore apo filozofike janë të ndryshme, por në kuadër të një gjinie të përbashkët; si të parat, ashtu edhe të fundit varen nga bota dhe veprojnë në te...” (f.50) mund të merret si luhajtje, apo si mbështetje e një koncepti më të gjerë të marrëdhënies formë/përmbajtje?

Pra, natyrshëm lind pyetja: a ka luhajtje në pikëpamjet e reja të Todorovit?

Sigurisht, atëherë kur synon të bashkojë qasjen formaliste me njohjen e faktorëve të jashtëm, që ishin mohuar kategorikisht. Fakti që Todorovi iu kushtua gjuhës, strukturës së brendshme të veprës do të ndikonte në përpjekjen e tij për të afruar dy metodologji të kundërta. Ai u kthehet faktorëve autor, lexues, qëllim i veprës, duke ndjekur periudha të ndryshme historike të mendimtarëve të artit dhe letërsisë. Pse e bën këtë? Sepse gjen diçka racionale në evoluimet e konceptimeve, sepse në mënyrë instiktive i vendos lëvizjet e tij në kurbën e zhvillimit të mendimit teorik, nga antikiteti në teorinë modere të kohës. Dhe në këtë oshilacion historik vjen natyrshëm përseri luhajtja, apo kthesa e vetëdijshme.

Duke ritrajtuar teza e pikëpamje të mendimit teorik-letrar Todorovi, nisur nga përvoja tashmë e gjatë e interpretimit të letërsisë, shtron një pyetje shumë interesante dhe të rëndësishme për mënyrën e kontaktit me letërsinë: “A po marrim një dije që ka të bëjë me vetë disiplinën, apo mos ndoshta me çeshtjen e saj?”. Mbas një shekulli kur formalistët kishin ngritur si çeshtje kryesore pavarësinë e shkencës letrare si dhe përcaktimin e thelbit të objektit të saj - letërsisë- Todorovi e rimerr çeshtjen, por duke iu qasur në një mënyrë origjinale thelbit të shkencës së letërsisë. Pyetja e tij: a duhen studiuar metodat që ilustrohen përmes veprave të ndryshme, apo studiohen veprat duke përdorur metoda nga më të ndryshmet. “Cili është qëllimi dhe cili është mjeti?” (f. 19).

Çeshtja e dytë thelbësore, që rishikon Todorovi, është mënyra e qasjes te vepra

letrare; edhe rreth këtij aspekt ndeshim pikëpamje pak a shumë befasuese në raport me atë çka perfaqësonte deri vonë sistemi i tij teorik, thellësisht strukturalist. Duket se në të menduarit e tij është zbehur paksa kureshtja për teknikat e veçuara të strukturës së brendshme, të përpunuara prej tij dhe strukturalistëve të shquar francezë.

A është lëkundur besimi i Todorovit në këto ‘mjetet të qasjes’? Nisur nga pohimi i tij: “Risitë e sjella nga qasja strukturaliste në dekada paraprake janë të mireseardhura me kusht që të ruajnë funksionin e mjeteve, e jo të bëhen qëllimi i tyre i vetëm” na lind mendimi se kjo ka ndodhur.


A ka paqartesi te Todorov?. Sigurisht jo. Përkundrazi, përvoja e gjatë në interpretimin letrar, njohja e thellë e dy metodologjive diametralisht të kundërta, ajo sociologjike dhe strukturaliste, përpunohen brenda vetëdijes së tij për të kristalizuar një qëndrim më të qartë në rishpjegimin e thelbit të letërsisë dhe qasjes ndaj saj. Duke ndjekur disa pikëpamje teorike, shfaqur gjatë historisë së zhvillimit të mendimit teorik-letrar, ai kupton me intuitë vlerën e rrugëtimit të këtyre pikëpamjeve, të cilat unë nuk i shoh as si gabime, as si kapricio, por si pikëvështrime të ndryshme, të pashmangshëm mbi tekstin letrar, që kanë ndikuar në mënyrat e ndryshme të interpretimit letrar

Pra, vështruar në tërësi, mendoj se kontradiktat nuk janë në sistemin e të menduarit teorik të Todorovit, por në gjithë teorinë e kuptimit dhe interpretimit historik të letërsisë. Koncepti metodologjik i tij mbi shkencën e letërsisë shfaqet i larguar tashmë nga pikëpamjet e mëparshme, kur bashkë me Bartin, Zhenettin kish synuar që ta çlironte interpretimin e letërsisë nga ‘pamaku i hekurt i kombeve dhe shekujve, me qëllim të hapjes drejt asaj që i bën veprat te afert me njera-tjetrën” (f. 12). Synimi, sigurisht kishte qenë i drejtë dhe mbetet ende në konceptet e Todorovit, por tashmë diçka ka lëvizur në mënyrën e realizimit të këtij objektivi shkencor.

Teoricieni e zhvillon qartazi raportin midis shkencës së letërsisë dhe objektit të saj, duke riinterpretuar të dy kahet ekstreme të kuptimit të letërsisë: “veprat prodhojnë kuptim, shkrimtari mendon, roli i kritikut është ta shndërrojë këtë kuptim dhe këtë mendim në të folurit e përbashkët të kohës së vet – dhe është fare pak e rëndësishme të dihet se me çfarë mjeti ai arrin qëllimin e vet.” (f. 80) dhe me pas “studimet letrare do të gjenin sot vendin e tyre në kuadër të humaniteteve, përballë historisë se ngjarjeve dhe të ideve, duke bërë që të gjitha këto disiplina të avancojnë të menduarit, duke u ushqyer nga veprat po aq sa edhe nga doktrinat, nga veprimet politike po aq sa edhe nga ndryshimet shoqërore, nga jeta e popujve po aq sa edhe nga jeta e individëve”. (f.82)

Pse ka rëndësi diskutimi i pikëpamjeve të fundit të teoricienit të shquar strukturalist Cv. Todorov?

Jo thjesht se në fillim të shekullit XXI konceptet mbi shkencën e letërsisë dhe thelbin e artit letrar rishfaqen me një kuptim më të gjerë, por sepse na rikujton se letërsia, sipas skemës së përcaktuar nga R.Jakobsoni, nuk është as vetëm kod (strukturë shenjore), as vetëm autor, as vetëm kontekst kulturor, as thjesht mesazh, por është një kompleksitet funksionesh që realizohen nga disa faktorë krijues, të cilët ngrihen mbi një kod specifik gjuhësor. Çdo kritik, studiues ka të drejtën e vet të përqendrohet në njerin apo tjetrin aspekt të strukturës së brendshme. Kjo është zgjedhje metodologjike e studiuesit, por që nuk do të thotë se shteron interpretimin e veprës letrare. Në këtë kuptim them se, me vetëdijen dhe intuitën letrare të jashtëzakonshme, teoricieni bullgaro-francez Cv.Todorov, arriti natyrshëm në riinterpretimin e koncepteve të tij teorike, duke dëshmuar se mendimi teorik letrar ndjek vazhdimisht letërsinë dhe nuk mund të qëndrojë i ngurtësuar në njerin apo tjetrën skemë. Njohja e thellë e letërsisë korrigjon çdo lloj qëndrimi të skajshëm.





DAVIDI i Michelangelo

Buonarroti

Dr. Bledar Kurti

Nëse Helena e Trojës është fytyra më e njohur e historisë letrare, e cila bëri të vërshojnë një mijë anije, dhe portreti i *Mona Lisa* të bën të ndiesh një mijë buzëqeshje, mashkulli më i famshëm i të gjithë kohërave në botën e artit është pa asnjë dyshim, *Davidi*, (1501-1504) i Michelangelo Buonarroti (1475-1564).

Homeri e mitizoi Helenën me fjalë; Leonardo e përjetësoi *Mona Lisa* me ngjyrë; ndërsa Michelangelo e çliroi përtej epokave këtë figurë vigane nga një bllok mermeri të ardhur nga Carrara, që kishte mbetur i pa sfiduar për më shumë se një shekull, i flakur diku pas Katedrales së Firences. Me daltën e tij, pak e pak, ditë pas dite, e vit pas viti, mermerin e akullt Michelangelo e solli në jetë, duke i dhënë frymë, pulsime zemre, vërshim gjaku, dhe një shpalosje të përsosmërisë së trupit njerëzor. Por, mbi të gjitha kjo statujë u bë ikonë e një beteje të re: betejës midis epërsisë së Zotit dhe forcës së njeriut. Për herë të parë në historinë e njerëzimit, njeriu

nisi të pretendonte se ishte ai Zoti mbi tokë.

Kjo ikonë e humanizmit gjendet në figurina, ilustrime e ballina librash, e shpalosur me madhështi, por ndjesia e vërtetë, dhe yshtja që ofron, mund të përjetohen vetëm në vendlindjen e tij, në Firence.

Teksa shkel rrugët e Firences, Davidi shfaqet plot egoizëm në hyrje të *Palazzo Vecchio*. Sigurisht, vizitorët nuk mund t'i rezistojnë tundimit së bëri foto e ta shohin plot admirim, por pavarësisht se ajo statujë i përafrohet kryeveprës botërore, ajo është vetëm një imitim i bukur, një kopje ndër të shumtat, ndërsa mrekullia e vërtetë gjendet pak qindra metra më larg, në *Galleria dell'Accademia*, ku ajo figurë e mermertë të hipnotizon me madhësinë e vet.

Davidi është mbi pesë metra i lartë dhe e bën çdo vizitor të duket e ndihet i vogël. Michelangelo nuk çliroi nga materia e mermerit një bari hebre por njeriun humanist. Tematika e veprës është e krishterë, por përveç emrit dhe

elementit të hobesë që ai mban mbi supe, çdo gjë tjetër është humaniste. Bashkë me këtë David evropian lindi edhe njeriu humanist.

Nën kontekstin e krishterë në të cilën gjendej mbarë Evropa, tematikat dhe motivet në art ishin kryesisht fetare, mitologjike, apo të heronjve të lashtësisë. Kisha e lejonte disi "shturjen" që kishte nisur në art e krijimtari por për aq kohë sa ato ishin të bukura ato pranoheshin, sepse bukuria ishte reflektim i natyrës, dhe natyrën e kishte krijuar plot bukuri vetë Perëndia.

Por artistët kishin një agjendë tjetër, ndaj nën emrin e krishterimit dhe nën hijen e historive biblike ata arritën simbolet më humaniste të të gjitha kohërave. Dhe shembulli më i mirë i trillimit që humanizmi i bëri krishterimit gjendet tek kryeveprat e Rilindjes italiane, të cilat përpiqeshin ta sfidonin krishterimin duke patur madje më të shumtën e kohës mbështetjen financiare të vetë klerit, papës dhe duartrokitjet dhe admirimin e krishterëve më të zellshëm.

Disa kryevepra të Rilindjes, pa u vënë re, promovonin humanizmin përpara syve të kishës. Shumica prej tyre madje u kryen në ambiente kishtarë, në zemrën e Evropës, në Vatikan, apo në sheshe publike në Firence dhe Romë. Dhe mbi të gjitha këto vepra "heretike" kryeson Davidi, si njeriu i ri, i fortë e i fuqishëm, i patëmetë dhe i pavdekshëm, ndryshe nga njeriu i rënë, mëkatar, dhe i humbur që përshkruhet në Bibël.

Për të gjithë bashkëkohësit e Michelangelo, madje edhe të disa kritikëve të ditëve të sotme, skulptura e Davidit është një vepër me temë biblike. Historia tregon se Davidi, një djalë i vogël, një bari izraelit, mposht Goliathin, luftëtarin kolos dhe të fortë, vetëm me një gurë me hobenë e tij. Kjo vepër u bë e njohur që kur u shfaq për herë të parë, por ndryshe nga si e shihnin njerëzit, kjo skulpturë nuk është e Davidit të Biblës, të vajosurit të Perëndisë, por e një Davidi tjetër, birit të humanizmit. Statuja me emrin David ishte thjeshtë një titull.

Në historinë e Biblës, tregohet sesi një i ri, i parëndësishëm, i pastërvitur dhe trup vogël, por i mbështetur nga forca e Perëndisë mposht një kolos dhe luftëtar të frikshëm si Goliathi. Në këtë histori Goliathi tallet me Davidin duke i thënë: "Eja këtu, dhe unë do t'ia jap mishin tënd shpendëve të qiellit dhe kafshëve të fushës. Por Davidi u përgjigj: "Ti po më vjen me shpatë, më shtizë dhe me ushtë, kurse unë po të dal në emër të Zotit të ushtrive, Perëndisë së ushtrisë së Izraelit që ti ke fyer."

Davidi i Biblës është një djalë i vogël që bën një mrekulli të madhe në emër të Zotit të tij, por Davidi i Michelangelo ka trupin e një atleti i cili nuk duket as i vogël dhe as i pafuqishëm. Ai duket sikur nuk e ka nevojën e Zotit pasi ka një trup perfekt, plot muskuj dhe forcë. Për më tepër, nëse Davidi i Biblës ishte i rrethprerë, për shkak të traditës hebraike, Davidi i Michelangelo duket qartë se është i parrethprerë, thënë ndryshe, i pabërë synet.

Të gënjyer nga historia e mrekullueshme biblike ishte e vështirë të dallohej se Michelangelo po promovonte njeriun e ri, të fortë, të sigurt në vetvete, perfekt, sportiv,

të arsyeshëm, të bukur, inteligjent, vizionar, guximtar, etj., attribute të cilat Bibla nuk ia jepte as Davidit në këtë histori dhe as racës njerëzore në përgjithësi, e cila, sipas saj, ra bashkë me mëkatin.

Michelangelo krijoi Davidin për të promovuar se njeriu është madhështor. Shikoni proporcionin më të madh të duarve në krahasim me trupin. Kjo dredhi e qëllimshme e bën më të fuqishëm këtë figurë njerëzore. Nuk ka patur dhe nuk ka asnjë njeri si Davidi. Nëse një vajzë do binte në dashuri me skulpturën dhe do priste gjersa të takonte një njeri që i ngjason atij, ajo do mbetej pa martuar.

Njeriu perfekt gjendet gjithmonë në veprat e Rilindjes por asnjëherë në Bibël. Njeriu i përsosur ishte një metër e matës artistik dhe filozofik në Greqinë e Lashtë, ndaj rilindësit italianë kishin vendosur ta ringjallnin atë koncept, por Michelangelo shkoi përtej, ai krijoi një njeri të ri, ashtu siç bota nuk e kishte njohur kurrë më parë, njeriu humanist: zot i vetes, zot i kombit, zot i botës.

Davidi qëndron në këmbë, me një qetësi të shtirur, në një pozicion *contrapposto*, me peshën e trupit të anuar në njërin këmbë, ndërsa tjetra është e dalë nga përpara. Michelangelo e shpalosi trupin në lëvizje, me bustin që rrotullohet paksa nga e djathta, ndërsa qafa nga e majta. Ndonëse Davidi duket i qetë, arrijmë të ndiejmë nervozizmin tek muskujt e qafës dhe shohim venat që fryhen në pjesën e pasme të dorës së djathtë.

Statuja ka dy plane. Davidi ka dy natyra. Nëse e ndajmë atë në mes vertikalisht do e vërejmë këtë dyzim personaliteti dhe lëvizje. Trupi i tij është i ndarë në dy natyra: *vita activa* dhe *vita contemplativa*, jeta aktive dhe jeta ëndërrimtare. Ana e djathtë e trupit është pjesa aktive. Krahu i tij i djathtë i zgjatur dhe i fortë shtrëngon gurin me të cilin do vrasë Goliathin, armikun e tij, e më pas do e bëjë atë luftëtar të ri mbret të Izraelit. Këmbe e tij e djathtë, e mbështetur fort e duke mbajtur peshën fizike dhe psikologjike të gjithë trupit të tij, manifeston nevojën e veprimit mizor që ai ka për të kryer. Ana e tij e djathtë është themeli i ekzistencës së Davidit, pasi ajo mban në këmbë pozicionin e fortë dhe të gjallë të tij. Ana e tij e majtë bën të kundërtën. Krahu i tij i majtë e mban butësisht hobenë e hedhur mbi sup, duke relaksuar tërësisht armën e aksionit (në këtë rast vrasjes) e duke u përhumbur në atë çastin e përjetshëm të mendimit dhe meditimit. Këmbe e majtë, plotësisht e lirë nga barra e aksionit, qëndron e lirshme, pa mbajtur asnjë peshë të trupit.

Ky dyzim ishte edhe një pasqyrë e vetë natyrës së Michelangelo. Artisti ishte njeri i trazuar, i shëmtuar, i veshur dhe i ushqyer shumë keq. Michelangelo ushqehet vetëm me thërrime buke. Ai ndëshkonte veten përmes një jete më pak se modeste dhe e konsideronte veten si një qenie larg përsosmërisë dhe objekt i ndëshkimit hyjnor. Ndaj kjo vepër është edhe krijimi i një egoje tjetër. Egoja perfekte e një artisti plot të meta. Imazh bukurie prej një artisti të shëmtuar. Një zot i lindur nga dalta e një njeriu plot frikë nga Zoti.

Kështu do e kishte interpretuar edhe Sigmund Freud dualitetin e natyrës së

artistit. Davidi ka një vështrim therës, vetullat janë të ngrysur plot përqendrim dhe vështrimi tejet zhbirues, të njëjtin vështrim që Michelangelo krijoi me Moisiun, një skulpturë tjetër një vit më vonë. Dhe për atë vepër me të njëjtin vështrim si të Davidit, Freud bëri një vlerësim psiko-analitik.

Në ditën e katërt të vizitës së tij në Romë në shtator të vitit 1901, Freud shkoi për të parë statujën e Moisiut të Michelangelo në Kishën e San Pietro në Vincoli. Për Freud, imazhet e veprës së Michelangelo u bënë të pandashme. Në një letër të 12 prillit 1933 për Edoardo Weiss, pionier italian i psikoanalizës, ai shkroi: “Çdo ditë për tre javë të vetmuara të shtatorit 1913, qëndrova në kishë para statujës, duke e studiuar atë, duke e matur dhe duke e vizatuar.” Dhe ndër të tjera ai përqendrohet tek vështrimi i Moisiut, i cili, i ngjashëm me të Davidit, ishte “një vështrim i zemëruar.”

Michelangelo ishte njeri i vetmuar dhe grindavec. Një herë ai ofendoi artistin e ri Pietro Torrigiano, i cili po vizatonte bashkë me të në një kishë në Firence; Torrigiano tregon se “e mblodha grushtin dhe e godita aq fortë në hundë sa që ndjeva kockën dhe kërcin që të shkërmoqeshin si një biskotë në dorën time.” Që nga ajo ditë Michelangelo e pati hundën e shtrembëruar deri në fund të jetës. Ajo hundë, e shoqëruar me shpinën e përkulur dhe pamjen e tij të palarë e bënte të dallonte nga artistët e tjerë si Leonardo da Vinci, i cili ecte në rrugët e Firences i veshur plot hijeshi e bukuri.

Davidi ishte një deklaratë mbi sesi njeriu humanist e shihte veten në të nesërmen! Populli e shihte si vrasësin e tiranëve, dhe e gjithë Firence ecte plot vetëbesim drejt një të ardhme madhështore. Me të mbaruar statuja, Paria e Firences u has me dilemën se ku do e vendosnin atë kolos madhështor. Ajo çështje hapi aq shumë diskutime sa që pati edhe një incident me hedhje gurësh nga disa protestues. Duke qenë republikë, Firence ngriti një komitet. Rreth tridhjetë artistë dhe drejtues civilë u mblodhën për të diskutuar këtë çështje, përfshirë edhe Filippino Lippi, Perugino, Botticelli, dhe sigurisht Leonardo da Vinci. Ata u mblodhën në 25 janar të vitit 1504, në një sallë mbledhjesh pranë Katedrales, nga ku dukej statuja e mbaruar, dhe morën në konsideratë nëntë vende për vendosjen e statujës, dy prej të cilave u zgjodhën si finaliste. Michelangelo kishte shpresuar që statuja e tij do qëndronte jashtë hyrjes së katedrales tek *Piazza del Duomo*, por shpejtë kuptoi që do shërbente më mirë si një simbol civil e jo fetar i Firences dhe i shtyu të bindeshin që ta vendosnin tek sheshi përpara *Palazzo della Signoria*. Giuliano da Sangolla, një nga arkitektët më të mirë të Firences, sikurse edhe skulptor, preferonte një vend poshtë harkut të madh tek *Loggia della Signoria*, një ndërtesë në cep të sheshit. Ai, bashkë me mbështetësit e tij, argumentuan se duke e strehuar aty Davidin, skulptura do ruante elementet e saj, por ajo zgjidhje e bënte veprën të mos binte në sy, e të ishte më pak dominuese dhe e spikatur. “Do shkojmë ne që ta shohim atë, e jo të vijë figura të na shohë ne,” u shpreh një nga mbështetësit e idesë së vendndodhjes tek *Loggia*.

Leonardo da Vinci ishte një rival i



përbetuar i Michelangelo. Ose më saktë ishte e kundërta. Michelangelo ishte tejet xheloz për mjeshtrinë e madh da Vinci i cili me artin e tij kishte dëshmuar se ishte i papërsëritshëm. Por, kjo xhelozia u kthye në drejtim të kundërt kur da Vinci pa Davidin, ndaj nuk është për t'u habitur që Leonardo mbështeste grupin që kërkonte t'a strukë statujën poshtë portikut. Kur erdhi radha e tij për të folur, ai tha, “Pajtohem që duhet të vendoset tek *Loggia*, por të qëndrojë tek parapeti ku varen sixhatet.” Dukej qartë, që Leonardo preferonte që statuja e Michelangelo të vendosej në një vend ku nuk binte shumë në sy. Por, sikur të mos mjaftonte kaq, Leonardo

e vazhdoi fjalën e tij e tha diçka të habitshme. Ai u shpreh se statuja duhej të vishej “me një zbukurim të hijshëm [*chon ornamento decente*].” Ishte e qartë çfarë nënkuptonte. Michelangelo e kishte gdhendur Davidin në mënyrë të guximshme, tërësisht lakuriq, me detaje të spikatura të pubisit dhe organit gjenital. Leonardo sugjeroi që t'i shtohet një mbulesë e hijshme në mënyrë të atillë që të mos prishë ceremonitë zyrtare.

Michelangelo e fitoi betejën për vendin se ku do vendosej statuja. Davidi i tij u lëviz me rrota për katër ditë, në mënyrë shumë të kujdesshme nga punishtja e tij, dhe u vendos në hyrje të



Palazzo della Signoria. Qëndroi aty deri në vitin 1873, e më pas u vendos brenda *Galleria dell'Accademia*, dhe në vitin 1910 një kopje e statujës u vendos sërish aty kishte qenë, por kësaj here pallati kishte marrë emrin *Palazzo Vecchio*. Por Leonardo fitoi me argumentin e tij se “një mbulesë e hijshme” duhej shtuar tek statuja. Një kurorë e stolitur e bërë prej tunxhi, me njëzetë e tetë gjethe bakri, u var tek skulptura, duke mbuluar organin gjenital të Davidit. Qëndroi aty për të paktën dyzetë vjet.

Leonardo dhe Michelangelo ishin dy figurat më kryesore të Rilindjes e padyshim dy emrat më të shquar të epokave të artit dhe mendimit. Nën ethet e artit ata ndizeshin nga xhelozia ndaj njëri-tjetrit, por piketa e përbashkët e botëkuptimit të tyre ishte humanizmi. Në fillim të shekullit të 15-të, *umanisti* do të thoshte, profesorë apo studentë të letërsisë klasike. Fjala *umanisti* rrjedh nga *studia humanitatis*, një kurs i studimeve klasike i cili, në fillim të shekullit të 15-të, përbëhej nga gramatika, retorika, poezia, historia dhe filozofia morale. *Humanitas* është fjalë latine, dhe përfaqëson një ideal arsimor dhe politik. Humanizmi i Rilindjes, në të gjitha format e veta, u përqendrua drejtë këtij ideali.

Humanitas kishte si burim letërsinë klasike. Mendimi grek dhe romak, i vënë në dispozicion nga dorëshkrime të lashta të ri-zbuluara ose të përkthyer rishtazi, i siguroi Humanizmit strukturën dhe metodën themelore të tij. Për humanistët e Rilindjes, nuk kishte asgjë të vjetruar në shkrimet e Platonit, Ciceronit, ose Livit. Duke u krahasuar me prodhime tipike të krishterimit mesjetar, këto vepra pagane kishin një ton të freskët, radikal, dhe *avant garde*.

Rilindja synonte të rizgjonte kulturën dhe botëkuptimin e lashtë greko-romak. Por, grekët, e më vonë romakët, e ndërtuan shoqërinë e tyre mbi zotat. Por zotat e tyre nuk ishin edhe aq të mëdhenj, pasi ata ishin të kufizuar. Edhe të mbledhur të gjithë së bashku, zotat grekë e romakë nuk mund të bëheshin të pakufizuar. Ata ishin njësoj si burrat e gratë e zakonshëm, por me përmasa më të mëdha, kësaj nuk mund të ofronin zgjidhjen e njeriut drejt përjetësisë. Ndaj, Davidi ishte tre herë më i madh në përmasa sesa njeriu i zakonshëm, por ai shkoi përtej konceptit të rilindjes së diçkaje të shkuar, e solli një botëkuptim të ri, të njeriut zot, të njeriut si qenie e pakushtëzuar dhe e përjetshme, si qendër e mbarë universit.

Por, kjo gjendje e pakushtëzuar dhe hyjnore e njeriut, mbeti e përkohshme dhe u la pas kraheve nga vetë Michelangelo. Kryeveprat e tij të mëvonshme, të cilat sot konsiderohen si mrekullitë e botës, na shpalosin një fytyrë tjetër të artit të Michelangelo, një botë tjetër të brendshme të tij, një qasje të ndryshme ndaj humanizmit dhe natyrës njerëzore, e cila ndryshe nga madhështia dhe shkëlqimi suprem në statujën e Davidit, aty na shfaqet e errët, e plogësht, e humbur, dhe e rënë.

Dikur krenar për njeriun e përjetshëm, në kryeveprat e ardhshme, në afresket e Kapelës Sistine, Michelangelo përjetoi një transformim zemre, zbrazti veten dhe artin e tij për ta përjetësuar njeriun si vdekatar, e nën mëshirën e Perëndisë, krijuesit të tij.

VILIAM
KLIMÁČEK



ROMAN

VERA
E NXEHTË E
68-ËS

*Humanizëm dhe dëshmi reale të jetëve
që u ndikuan në mënyrë të pakthyeshme nga
“Pranvera e Pragës” dhe nga pushtimi sovjetik.*



OMBRA GVG

di. 1997